Gjithashtu për te njejten shkollë për zërin nr.4 “Shtresë betoni” C6/10 nuk ka ofertuar me njësinë matëse m<sup>3</sup>, por me njësinë matëse copë, si edhe për zërin nr.5 “Riparim çatie zëvendësim tjegullash” nuk ka ofertuar me njësinë matëse m<sup>2</sup>, por me njësinë matëse m<sup>3</sup>, duke paraqitur te pasakte formularin e ofertes pasi ka gabime dhe mungesa të zerave të punimeve, gabime të cilat përbëjnë shkak për skualifikim, sepse në DST përcaktohet serastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Preventivi i Ndërmarrjes së Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike

51.Shkolla 9 vjeçare “Neim Mucelli”, fshati Pretushë, Nj.Adm Cërravë”						
Nr.	Nr.Analize	Pershkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi pa tvsh	Vlera

1	2.399	Sherbetisje e bojatisje me gëlqere	m <sup>2</sup>	1700		
2	An+2.404	Lyerje me bojë hidromat	m <sup>2</sup>	1000		
3	An	Pastrim oxhaku + mbeturina	copë	10		
4	2.262	Shtresë betoni C6/10	m <sup>3</sup>	1.5		
5	An+2.218	Riparim çatie zëvendësim tjegullash	m <sup>2</sup>	70		
6	2.209/a	Ulluk shkarkimi vertikal me PVC φ 120mm	ml	50		
7	2.212/a	Ulluk shkarkimi horizontal me PVC φ 33 cm	ml	50		
8	2.331	Suva e zakonshme mur tulle	m <sup>2</sup>	30		
9	2.401	Lyerje me bojë vaji sip. metalike	m <sup>2</sup>	20		
10	2.404	Lyerje me bojë hidroplastike fasadë	m <sup>2</sup>	300		
11	2.395	F/V Derë d/alumini tek xham (1 copë, porta)	m <sup>2</sup>	5.5		
		Shuma 51				

Formulari i Ofertës së OE “2N” shpk.

51.Shkolla 9 vjeçare “Neim Mucelli”, fshati Pretushë, Nj.Adm Cërravë”				
Nr.	Nr.Analize	Pershkrimi	Njësia	Sasia
1	2.399	Sherbetisje e bojatisje me gëlqere	m <sup>2</sup>	1700
2	An+2.404	Lyerje me bojë hidromat	m <sup>2</sup>	1000
3	An	Pastrim oxhaku + mbeturina	copë	10
4	2.262	Shtresë betoni C6/10	copë	1.5
5	An+2.218	Riparim çatie zëvendësim tjegullash	m <sup>3</sup>	70
6	2.209/a	Ulluk shkarkimi vertikal me PVC φ 120mm	ml	50
7	2.212/a	Ulluk shkarkimi horizontal me PVC φ 33 cm	ml	50
8	2.331	Suva e zakonshme mur tulle	m <sup>2</sup>	30
10	2.404	Lyerje me bojë hidroplastike fasadë	m <sup>2</sup>	300
11	2.395	F/V Derë d/alumini tek xham (1 copë, porta)	m <sup>2</sup>	5.5
		Shuma 51		

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se oferta nuk përmban dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit, në mbështetje të pikës 2 të nenit 82 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me Nenin 92 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe Dokumentave Standarde të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e “2N” shpk nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar si ofertë të pavlefshme.

5. “REJ” shpk

J93711608Q

Emri i plotë i shoqërisë

Arsyet e mëposhtme:

Numri i NIPT-it

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se:



- I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim.
- Nuk i plotëson kriteret e vecanta të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar për kualifikim, të përcaktuara në DT.
- Nuk i plotëson kapacitetet teknike për kualifikim.

1. Sipas kriterëve të veçanta të kualifikimit pika 1/b në Dokumentet Standarte të Tenderit kërkohet që:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3 me vlerë: 411,373.94 (katërqind e njëmbëdhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e tre pjesë nëntëdhjetë e katër) lekë.*

Gjithashtu edhe Neni 30 pika 1 “Sigurimi i Ofertës” e Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” përcakton se

*1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, sikurse përcaktohet në nenin 83, të LPP-së.*

*Enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, sikurse përcaktohet në nenin 83, të LPP-së.*

*Enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, mund të kërkojë ose jo sigurim oferte për procedurat nën kufirin e lartë monetar.*

2. OE “REJ” shpk nuk e ka paraqitur Sigurimin e Ofertës.

Në pikën 2.3.5 a. të Kapacitetit teknik kërkohet që:

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjës minimumi:

- jo me pak se 1 (nje) teknik ndertimi
- jo me pak se 4 (kater) bojaxhi
- jo me pak se 4 (kater) muratore
- jo me pak se 1 (Nje) hidraulik
- jo me pak se 1 (Nje) elektrikist
- jo me pak se 1 (nje) marangoz
- jo me pak se 1 (Nje) karpentier
- jo me pak se 1 (nje) specialist per izolim
- jo me pak se 1 (nje) pllakashtrues

të vertetuar me diploma/certifikata të arsimit profesional të lëshuara nga institucione të akredituara/liçensuara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente, kontratë pune të vlefshme, deshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë të pakten për muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

b. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar

- Shofer 2 (dy)

Per shoferet leje drejtimi e vlefshme, deshmi të kualifikimit të sigurimit teknik nga ISHTI ose institucione ekuivalente dhe të figurojnë në listëpagesa të pakten për muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit dhe në vazhdim ose kur mjetet disponohen me qera drejtuesit e mjeteve mund të disponohen sëbashku me mjetet e mara me qera, pa pasur nevojë të jene të perfshire në listpagesat e operatorit ekonomik ofertues.

*Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285,*



datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

OE “REJ” shpk nuk ka paraqitur në Formularin e Vetëdeklarimit asnjë nga punonjësit e kërkuar në DST.

3. Në pikën 2.3.7 të Kapacitetit teknik kërkohet që:

Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet e mëposhtme:

NR	EMERTIMI I MAKINERIVE	NJESIA	SASIA	ME QERA/PRONESI
1	Kamioncinë, kapacitet mbajtes deri 3 ton	cope	2	Ne pronesi ose me qera
2	Komplet skelash 1.5 m deri 4 m	Komplet	2	Ne pronesi ose me qera
3	Betoniere	cope	1	Ne pronësi ose me qira
4	Pompe per lysterje	cope	2	Ne pronësi ose me qira

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton regjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), çertifikatën e kontrollit teknik (*të vlefshme*), siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), kurse për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet me kontrata përkatëse e qerasë/furnizimit dhe dokumentacionin që vërteton regjistrimin e tij (*leje qarkullimi*), çertifikatën e kontrollit teknik (*të vlefshme*), siguracionin e mjetit (*të vlefshme*).
- Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre si aktet e zhdoganimit/faturat tatimore të blerjes dhe kur ato janë të marra me qera të paraqitet kontrata e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj si edhe dokumentat që vërtetojnë pronësinë e qiradhënënsit si aktet e zhdoganimit/ faturat tatimore të blerjes.
- Mjetet, pajisjet teknike nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera gjatë afatit kohor të zbatimit të kontratës objekt të këtij prokurimi. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë brenda orarit të punës, në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës, mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr.8.

*Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

OE “REJ” shpk nuk ka paraqitur në Formularin e Vetëdeklarimit asnjë nga mjetet e kërkuar në DST. -Mungesat e dokumentacionit të mësipërm përbëjnë shkak për skualifikim, sepse në DST përcaktohet se në rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se oferta nuk përmban dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit, në mbështetje të pikës 2

të nenit 82 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me Nenin 92 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe Dokumentave Standarde të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e “REJ” shpk nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar si ofertë të pavlefshme.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [ADA-CO” shpk me nipt K64112603J me adresë Korce Pogradec, Pogradec, Zona Industriale, me administrator Z.Selvi Latifllari], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 18,772,586.1 (tetëmbëdhjetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë pike një) lekë pa tvsh është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

## **BASHKIA ROSKOVEC**

Drejtuar: ["SARK" SHPK, adresa: Fier Fier FIER Lagjja 8 Shkurti, Rruga Skenderbej, Fier, Rajoni nr 3, Perball supermarket Lalaj ]

Procedura e prokurimit/lotit: “E hapur e thjeshtuar”

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-72008-06-08-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: ["Rikonstruksion i shkarjes në rrugën Lamaj, fshati Mbërz, 1050 ml”]

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofertuara:

1. " SARK" SHPK

K52531415H

- Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

- Vlera 3 656 868 (tre milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e tëtëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa tvsh (me numra dhe fjalë).
2. " 2 Z KONSTRUKSION" SHPK J63229466K numri i NIPT-it
- Emri i plotë i shoqërisë
  - Vlera 3 749 200 (tre milion e shtatëqind e dyzetë e nëntë mijë e dyqind) lekë pa tvsh (me numra dhe fjalë).
3. BOE: "AR&ED" SHPK & "LIS KONSTRUKSION" SHPK L53518404A& K66613407H
- Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it
  - Vlera 3 857 300 (tre milion e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e treqind) lekë pa tvsh (me numra dhe fjalë).

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

BOE:" AR& ED" SHPK & LIS KONSTRUKSION SHPK

Në pikën 2 të DST , Kriteret e vecanta të kualifikimit është kërkuar sigurim oferte sipas shtojcës 3, nga këqyrja e dokumentacionit të ngarkuar në sistemin elektronik nga keta operator ekonomik AR&ED dhe LIS KONSTRUKSION:

Mungon kontrata e bashkëpunimit midis operatoreve ekonomik.

Rezulton se sigurimi i ofertës mungon, ky kriter nuk u përmbush, nisur nga kjo:

Komisioni i vlerësimit të ofertave vendosi:

Të skualifikoj këta operator ekonomik.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lart përmendur, informojmë: [" SARK" SHPK, adresa: Fier Fier FIER Lagjja 8 Shkurti, Rruga Skenderbej, Fier, Rajoni nr 3, Perball supermarket Lalaj ] se oferta e paraqitur me vlerë totale prej: 3 656 868 (tre milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e tëtëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa tvsh / totali i pikëve të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik.

**HEKURUDHA SHOIPTARE SH.A**

Drejtuar: Martini Konstruksion & Real Estate me nr. Nipt K81314023A,  
Adresa: TIRANE, Rruga e Durrësit, Hyrja Nr.3 ,Pasuri e Llojit Njesi Nr.4/12+3-B/1,Zona Kadastrale 8210,

Procedura e prokurimit/lotit: E hapur e thjeshtuar-pune

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Ref 73195-06-21-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: ” Rikonstruksion i tualeteve pranë zyrave të drejtorisë Hekurudha Shqiptare dhe riparim parapet godinës“

Fondi limit: 1,551,837 lekë, pa TVSH

Kohezgjatja e kontrates : 1 muaj

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.57 date 26.06.2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Martini Konstruksion & Real Estate me nr. Nipt K81314023A, me ofertë ekonomike 1,116,610 lekë
2. “Meni” shpk me nr.J61909018W, me ofertë ekonomike 1,312,890 lekë

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm: nuk ka

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Martini Konstruksion & Real Estate me nr. Nipt K81314023A dhe me adrese : TIRANE, Rruga e Durrësit, Hyrja Nr.3 ,Pasuri e Llojit Njesi Nr.4/12+3-B/1,Zona Kadastrale 8210, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 1,116,610 lekë [një milion e njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dhjetë ] / totali i pikëve të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si fitues (paraprak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”

**KUVENDI**

Kuvendi i Shqiperisë : Bulevardi : “Dëshmorët e Kombit” Nr. 4, Tiranë.

Drejtuar : Operatorit ekonomik “VALONA KONSTRUKSION”, Nipt K26330202E, adresa: Lagjja “Uji ftohte”, rrugess Vlore – Orikum, ne kufi me rezidencen qeveritare, Vlorë

Procedura e prokurimit/lotit: E hapur e thjeshtuar/pune

Numri i procedurës: REF-72923-06-19-2023

Objekti e kontratës: “Ndërtimi i vendqëndrimit të gazetarëve”

Kohezgjatja e kontrates : 42 (dyzete e dy) dite nga nënshkrimi i kontratës

Sasite: *Sipas tabelës se shtojces 5 te specifikimeve teknike*

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. OPERATORI EKONOMIK “VALONA KONSTRUKSION”, Nipt K26330202E me ofertë ekonomike me vlerë totale 2 124 108 (dy million e njeqind e njezete e kater mije e njeqind e tete) lekë pa TVSH.

Nga pjesërmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:  
*NUK KA*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se OPERATORI EKONOMIK “VALONA KONSTRUKSION”, Nipt K26330202E me ofertë ekonomike me vlerë totale 2 124 108 (dy million e njeqind e njezete e kater mije e njeqind e tete)lekë pa TVSH është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

## **DREJTORIA E SPITALIT RAJONAL DIBËR**

Drejtuar: Elvis Miri – Drejtues Ligjor i “ V.A.L.E. Recycling”, Lezhe Fushe Kuqe GUREZ Fshatin Gurez, afer ish-Kanalit te Acidit .

Procedura e prokurimit/lotit: Procedure e hapur e thjeshtuar Mareveshje kuader me nje operator ekonomik per 12 muaj, mbeshtetur ne Ligjin 162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”..

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF –73850-06-29-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: ” Evadim mbetje spitalor per nevoja te DSR Diber per vitin 2023 ” Mareveshje kuader me nje operator ekonomik per 12 muaj.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1.\_ V.A.L.E. Recycling

NIPT L28029301Q

Vlera 2.125.339 (Dy milione njeqind e njezete e pese mije e treqind e tridhjete e nente) leke pa TVSH

2. SILVER shpk

NIPT K88010301S

Vlera 2.400.000 (Dy milione e katerqind mije) leke pa tvsh.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

SILVER shpk pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin si vijon:

1. O.E. nuk ploteson piken 2.2.1 te kriterëve te vecanta te kualifikimit sipas DST.
2. O.E. nuk ploteson piken 2.2.2 te kriterëve te vecanta te kualifikimit sipas DST.
3. O.E. nuk ploteson piken 2.2.3 te kriterëve te vecanta te kualifikimit sipas DST.
4. O.E. nuk ploteson piken 2.3.1 te kriterëve te vecanta te kualifikimit sipas DST.
5. O.E. nuk ploteson piken 2.3.2 te kriterëve te vecanta te kualifikimit sipas DST.
6. O.E. nuk ploteson piken 2.3.3 te kriterëve te vecanta te kualifikimit sipas DST.
7. O.E. nuk ka paraqitur sigurimin e ofertes .
8. O.E. nuk ka paraqitur formularin permbledhes te vetedeklarimit.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Elvis Miri – Drejtues Ligjor i “ V.A.L.E. Recycling” , me NIPT L28029301Q me adrese Lezhe Fushe Kuqe GUREZ Fshatin Gurez, afer ish-Kanalit te Acidit , Tirane, se oferta e paraqitur me vlerë 2.125.339 (Dy milione njeqind e njezete e pese mije e treqind e tridhjete e nente) leke pa TVSH / totali i pikëve të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA" TIRANË**

Drejtuar: Operatori Ekonomik "Linear" sh.p.k. me nr. Nipt-i L01714002F , me adresë Rruga e Kavajës, Pallati "Speed", Kati përdhe, Nr 4, Tiranë 2

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar – Shërbime – Prokurim me Mjete Elektronike, Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë (me një OE fitues për secilin lot), ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-69563-05-17-2023

Nr. lotit	Emertimi Lotit	Referencë
2.	Loti 2 - Pajisje mjekësore prodhues Elekta /ose ekuivalent	REF-69568-05-17-2023

Objekti i kontratës "Mirëmbajtje e pajisjeve të mëdha mjekësore të prodhuesit GE Healthcare/ ose ekuivalent dhe Elekta/ ose ekuivalent", për periudhë 24 muaj".

Nr. lotit	Emertimi Lotit
2.	Loti 2 - Pajisje mjekësore prodhues Elekta /ose ekuivalent

Fondi limit: 75,223,473.96 (shtatëdhjetë e pesë milion e dyqind e njëzet e tre mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tre pike nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Nr. lotit	Emertimi Lotit	Fondi limit lekë pa TVSH për 24 muaj (730 ditë)
2.	Loti 2 - Pajisje mjekësore prodhues Elekta /ose ekuivalent	64,703,550

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratave për të gjitha lotet, i konvertuar ne euro sipas kursit zyrtar te Bankes se Shqiperise date (bazuar në kursin 113,43 euro, datë: 17/05/2023) pa TVSH për 24 muaj (730 ditë): 663,170.89 Euro pa TVSH,

Nr. lotit	Emertimi Lotit	Fondi limit EURO pa TVSH për 24 muaj (730 ditë)
2.	Loti 2 - Pajisje mjekësore prodhues Elekta /ose ekuivalent	570,427.1

- Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, shumatorja e çmimeve për njësi për lotin 2 është 88,635 (tetëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH.
- Shumatorja e çmimeve për njësi është e përlogaritur në euro është: 781.41 euro pa TVSH.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim



Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**PËR LOTIN 2 - PAJISJE MJEKËSORE PRODHUES ELEKTA /OSE EKUIVALENT**

“LINEAR” SH.P.K  
*Emri i plotë i shoqërisë*

L01714002F,  
*Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 64,701,360.00 (gjashtëdhjetë e katër milion e shtatëqind e një mijë e treqind e gjashtëdhjetë) Lekë pa TVSH.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik “Linear” sh.p.k. me nr. Nipt-i L01714002F , *me adresë* Rruga e Kavajës, Pallati “Speed”, Kati përdhe, Nr 4, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 64,701,360.00 (gjashtëdhjetë e katër milion e shtatëqind e një mijë e treqind e gjashtëdhjetë) Lekë pa TVSH, totali i pikëve të marra [*nuk është përdorur kjo metodë vlerësimi*] është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR**

Drejtuar: C.E.C GROUP  
TIRANE Njesia Bashkiake nr.7, Rruga Dritan Hoxha, Ndertesa nr.117, Shkalla nr.2, Apartamenti nr.5/3

Procedura e prokurimit/lotit: Shërbim Konsulence

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-69718-05-18-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Supervizion “Mirëmbajtje Tuneli i Krrabës (2023-2027)”

Fondi limit: 13,000,468.80 (trembëdhjetë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë presje tetëdhjetë) Lekë, pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 48 muaj  
Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*):



Buletini i Njoftimeve Publike: *Buletini i Njoftimeve Publike, data 22 Maj 2023, nr. 45*

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:

1. A & E ENGINEERING sh.p.k K72113010E

2. C.E.C GROUP L11807013M

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazat e tjera të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. C.E.C GROUP L11807013M

Vlera: 12 988 800 (dymbëdhjete milion e nentëqind e tetëdhjete e tete mijë e teteqind) Lekë pa TVSH.

2. A & E ENGINEERING sh.p.k K72113010E

Vlera: 12,525,216 (dymbëdhjetë milion e pesëqind e njëzet e pesë mijë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH.

Lista e operatorëve ekonomikë të skualifikuar: Nuk ka.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë OE C.E.C GROUP me adresë: TIRANE Njesia Bashkiake nr.7, Rruga Dritan Hoxha, Ndertesa nr.117, Shkalla nr.2, Apartamenti nr.5/3, me NUIS: L11807013M, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 12 988 800 (dymbëdhjete milion e nentëqind e tetëdhjete e tete mijë e teteqind) Lekë pa TVSH. / totali i pikëve të marra sipas sistemit [261.60], është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në *nenin 110 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik"*.

## **AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR**

Drejtuar: Operatorit Ekonomik "C.E.C GROUP" SHPK

Tirane Njesia Bashkiake nr.7, Rruga Dritan Hoxha, Ndertesa nr.117, Shkalla nr.2, Apartamenti nr.5/3

Procedura e prokurimit/lotit: Shërbim Konsulence

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-69722-05-18-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Supervizion Mirëmbajtja e rrugës Kardhiq-Delvinë, Loti-7 (Tuneli)”, me fond limit: 9,025,218.40 (nëntë milion e njëzet e pesë mijë e dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e dyzet) Lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 48 muaj.  
Publikimet e mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike, Datë 22 Maj 2023, Nr. 45

\* \* \*

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:

- |                               |            |
|-------------------------------|------------|
| 1. “A & E ENGINEERING” sh.p.k | K72113010E |
| 2. C.E.C GROUP SHPK           | L11807013M |
| 3. “SPHAERA” SHPK             | J81809003U |
| 4. “NOVATECH STUDIO” SHPK     | L01717030C |

\* \* \*

Njoftojmë se, ka qenë pjesëmarrës në fazat e tjera të procedurës së sipërcituar ofertuesi me vlerën përkatëse të ofruar:

1. “A & E ENGINEERING” sh.p.k K72113010E  
Vlera: 8,775,052 (tetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e pesëdhjetë e dy) Lekë pa TVSH.  
Totali i pikëve të marra: 259,20

2. “C.E.C GROUP” SHPK L11807013M  
Vlera: 9,011,750 (nëntë milion e njëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH.  
Totali i pikëve të marra: 262,20

Lista e operatorëve ekonomikë të skualifikuar: Nuk ka

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “C.E.C GROUP” SHPK me adresë: Tirane Njesia Bashkiake nr.7, Rruga Dritan Hoxha, Ndertesa nr.117, Shkalla nr.2, Apartamenti nr.5/3, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 9,011,750 (nëntë milion e njëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH totali i pikëve të marra 262,20 është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me marrjen/publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në *nenin 110 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”*.

**SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME DIBËR SH.A**

Drejtuar: Operatorit Ekonomik, Shoqëria “KUPA” sh.p.k me NIPT K51615512C, me adresë Tiranë, Kamëz, Rruga Berisha, Argjinatura me Nr.pasurie 482, Çerkezë.

Procedura e prokurimit: Procedurë e hapur me mjete elektronike / Punë

Numri i referencës së procedurës: Nr. REF 71439-06-02-2023

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 45000000-7 -- Punë ndërtimi

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Furnizimi me ujë të pijshëm për fshatrat Brezhdan dhe Ushtelencë, Njësia Administrative Qendër Tomin, Faza e dytë

Afati kohor për ekzekutimin: 6 (gjashtë) muaj

Fondi limit: 47,549,280 (dyzet e shtatë milion e pesëqind e dyzet e nënte mijë e dyqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH

Publikimet e mëparshme: Nuk ka

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto
- Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi, ju informojmë se në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik Shoqëria “LIQENI VII” sh.p.k NIPT K01730502W  
Vlera e Ofertës: 39,399,167.60 (tridhjetë e nëntë milion e treqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH.
2. Operatori Ekonomik Shoqëria “SELAMI” sh.p.k NIPT J77304706L  
Vlera e Ofertës: 47,027,603.70 (dyzet e shtatë milion e njëzet e shtatë mijë e gjashtëqind e tre pikë shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.
3. Operatori Ekonomik “KUPA” shpk NIPT K51615512C  
Vlera e Ofertës: 45,667,211.7 (dyzet e pesë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e njëmbëdhjetë pike shtatë) lekë pa TVSH.

Oferta të refuzuara:

1. Operatori Ekonomik Shoqëria “LIQENI VII” sh.p.k me NIPT K01730502W me vlerë të ofertës 39,399,167.60 (tridhjetë e nëntë milion e treqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH.

Për këto arsye:

Autoriteti Kontraktor gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur elektronikisht nga ky Operator Ekonomik, konstatoi se nuk plotëson kriteret si më poshtë:

1. Ky operator ekonomik nuk përmbush kriteret e përcaktuara në Shtojcën 7 të DST-së “Kriteret e veçanta” paragrafi 1 gërma b, pasi nuk ka paraqitur Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3 të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.
2. Nuk përmbush paragrafin 2.3.2 gërma c të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit të Shtojcës 7 të DST-së, Kapitulli “Kapaciteti teknik dhe profesional” ku është kërkuar:  
Në perputhje me kërkesat dhe dimensionet e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve si më poshtë:  
Materiale hidraulike dhe rakorderi ujësjellesi
  - ✓ Tuba dhe rakorderi ujësjellësi PE
  - ✓ Matës uji dhe aksesore

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- ✓ Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributor i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbësite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.
- ✓ Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.
- ✓ Të gjitha materialet e mësipërme duhet të jenë sipas Standarteve Europiane. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetëdeklarim që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit / ve është sipas standartit ISO 9001-2015 dhe ISO 14001-2015. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit gjatë procesit të vlerësimit të dokumentacionit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, rezulton se për artikujt matësja uji dhe aksesore mungon autorizimi i prodhuesit dhe gjithë dokumentacioni i kërkuar në këtë pikë, katalogët e prodhuesit dhe vetëdeklarim për standartet e menaxhimit të cilësisë së prodhuesit.

3. Operatori Ekonomik nuk përmbush paragrafin 2.3.3 të Shtojcës 7 të DST- së Kriteret e veçanta të Kualifikimit, Kapitulli “Kapaciteti teknik dhe profesional” gërmat “a”, “d” dhe “e” ku është kërkuar nga autoriteti kontraktor:

Operatori Ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës si dhe punonjësit specialiste me çertifikata si më poshtë:

2.3.3 Operatori Ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës si dhe punonjësit specialistë me çertifikimet përkatëse, si më poshtë:

- a) Operatori Ekonomik duhet të ketë punësuar mesatarisht të paktën 65 (gjashtëdhjetë e pesë) punonjës për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit.

Rezultoi nga shqyrtimi i dokumentacionit konkretisht Shtojcës 8 të DST-së, Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, se ky Operator Ekonomik ka të punësuar 59 (pesëdhjetë e nëntë) punonjës, nga 65 (gjashtëdhjetë e pesë) punonjës të kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Gjithashtu nga ky Operator Ekonomik nuk përmbushen kërkesat e pikës d të paragrafit 2.3.3 të Shtojcës 7 të DST- së, ku është kërkuar nga autoriteti kontraktor që Operatori Ekonomik të ketë të punësuar stafin teknik të përbërë nga të paktën 20 (njëzet) punonjës të specializuar dhe të çertifikuar sipas profesionit që kryejnë dhe të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për periudhën 3 muajt e fundit.

Rezulton se Operatori Ekonomik nga punonjësit e kërkuar disponon përkatësisht:

- ✓ Nga 4 (katër) hidraulikë të kërkuar disponon vetëm 2 (dy) hidraulikë
- ✓ Nga 2 (dy) saldatorë të kërkuar disponon vetëm 1(nje) saldator
- ✓ Nga 2 (dy) specialist hidroizolues disponon vetëm 1(nje) specialist hidroizolues
- ✓ Nga 5(pesë) shoferë të kërkuar disponon vetëm 1 (një) shofer.

Nga ana e Operatorit Ekonomik nuk përmbushen kërkesat e pikës “e” të paragrafit 2.3.3 të Shtojcës 7 të DST- së në të cilën është kërkuar nga autoriteti kontraktor që Operatori Ekonomik të disponojë të paktën 4 (kater) Manovratore / Eskavatoriste/Automakinist. Rezultoi se disponon vetem 1 (nje) manovrator nga 4 (katër) Manovratore / Eskavatoriste /Automakinist të kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Operatori Ekonomik Shoqëria “LIQENI VII” sh.p.k nuk përmbush kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në lidhje me kapacitetin e makineri pajisjeve të kërkuara nga ky autoritet në Kapitullin 2.3.5 të DST-së Makineri Pajisje, nga ku, ky operator ekonomik ka rezultuar me mangësi të rëndësishme në këto kapacitete përkatësisht:

Sipas Shtojcës 8 të DST-së, Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit të ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatohet se për plotësimin e këtij kriteri tek ky operator ekonomik mungojnë makineri pajisjet e mëposhtme:

- Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 15 deri 20 ton 2-copë
- Autobetoniere 2 copë
- Autopompë Betoni 1 copë
- Trencher për hapje kanali 1 copë
- Pajisje për testim tubash 1 copë
- Pajisje për inspektim tubash 1 copë
- Matës largësie/ Instrumente për Topogjeodezim

Së fundmi, nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave është bërë refuzimi i vlerës së ofertës së paraqitur nga ky operator ekonomik për këto arsye:

Janë konstatuar mospërputhje midis Shtojcës 1 dhe Shtojcës 2 të paraqitur ne SPE, respektivisht në çmimet e ofertuara ku rezultojnë vlera të ndryshme.

Konkretisht: Vlera e Ofertës së paraqitur në Shtojcën Nr.1 “Formulari i Ofertës” të ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik është 39,399,167.60 (tridhjetë e nëntë milion e treqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH dhe 49,642,951.18 (dyzet e nëntë milion e gjashtëqind e dyzet e dy mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e një pikë tetëmbëdhjetë) leke me TVSH.

Ndërkohë nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në Shtojcën Nr. 2 “Lista e cmimeve sipas zërave të preventivit”rezulton se vlera e paraqitur e çmimeve sipas zërave të preventivit në ofertën ekonomike të detajuar është 46,554,432.23 (dyzet e gjashtë milion e pesëqind e pesëdhjetë e katër mijë e katërqind e tridhjetë e dy pikë njëzet e tre) lekë pa TVSH dhe 55,865,318.67 (pesëdhjetë e

pesë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e treqind e tetëmbëdhjetë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë me TVSH.

Sa më lart, bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet: *“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”*, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor bëri s`kualifikimin e Operatorit Ekonomik Shoqërisë “LIQENI VII” sh.p.k.

2. Operatori Ekonomik Shoqëria “SELAMI” sh.p.k me NIPT J77304706L me vlerë të Ofertës: 47,027,603.70 (dyzet e shtatë milion e njëzet e shtatë mijë e gjashtëqind e tre pikë shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.

Për këto arsye:

Autoriteti Kontraktor gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur elektronikisht nga ky Operator Ekonomik, konstatoi se nuk përmbush paragrafin 2.3.4 të Kapitullit Kriteret e Veçanta të kualifikimit në Shtojcën 7 të DST-së, Kapitulli “Kapaciteti teknik dhe profesional” ku është kërkuar nga autoriteti kontraktor:

2.3.4. Operatori Ekonomik të ketë Licencë të lëshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim ruajtje dhe transport i mbetjeve inerte”.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në Sistemin e Prokurimit Elektronik, vlerësoi se ky operator ekonomik nuk disponon këtë licensë.

Sa më lart, bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet: *“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”*, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor bëri s`kualifikimin e Operatorit Ekonomik Shoqërisë “SELAMI” sh.p.k.

Operatori Ekonomik Shoqëria “KUPA” sh.p.k, me NIPT K51615512C me vlerë të ofertës: 45,667,211.7 (dyzet e pesë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e njëmbëdhjetë pikë shtatë) lekë pa TVSH.

Kualifikohet

Në lidhje me dokumentacionin e paraqitur nga Operatori Ekonomik Shoqëria “KUPA” sh.p.k, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik, konkludon se ky Bashkim Operatorësh Ekonomikë plotëson Kriteret e Përgjithshme të Pranimit / Kualifikimit.

Ky Operator Ekonomik dokumentacionin ligjor, administrativ dhe teknik e ka të rregullt konform kërkesave të Dokumentave Standarte të Tenderit.

Gjithashtu plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit në zbatim të Legjislacionit të Prokurimit Publik, VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar dhe Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.



Referuar nenit 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet: *“Autoriteti ose enti kontraktor në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”*, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor ka vendosur të pranojë ofertën e Operatorit Ekonomik Shoqëria “KUPA”sh.p.k, si dhe të kualifikojë si ofertë të vlefshme ofertën e paraqitur prej tij.

Autoriteti Kontraktor në përfundim konkludoi:

Oferta të refuzuara:

1. Operatori Ekonomik Shoqëria “LIQENI VII” sh.p.k, me vlerë të ofertës 39,399,167.60 (tridhjetë e nëntë milion e treqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH.
2. Operatori Ekonomik Shoqëria “SELAMI” sh.p.k, me vlerë të ofertës: 47,027,603.70 (dyzet e shtatë milion e njëzet e shtatë mijë e gjashtëqind e tre pikë shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.

Oferta të kualifikuara:

Oferta e Operatorit Ekonomik Shoqëria “KUPA” sh.p.k, me vlerë të ofruar prej 45,667,211.7 (dyzet e pesë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e njëmbëdhjetë pikë shtatë) lekë pa TVSH.

Duke u nisur nga renditja e operatoreve ekonomikë të kualifikuar, në bazë të kriterit të përzgjedhjes Çmimi më i ulët, konkludohet se Oferta fituese është Oferta e Operatorit Ekonomik Shoqëria “KUPA” sh.p.k, me NIPT K51615512C, me vlerë të ofruar 45,667,211.7 (dyzet e pesë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e njëmbëdhjetë pikë shtatë) lekë pa TVSH.

Pas paraqitjes nga Operatori Ekonomik Shoqëria “KUPA” sh.p.k, të dokumentacionit provues të parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të nenit 26 pika 2 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ky operator ekonomik rezultoi me dokumentacionin ligjor, administrativ dhe teknik të rregullt konform kërkesave të Dokumentave Standarte të Tenderit të publikuara nga Autoriteti Kontraktor.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik Shoqëria “KUPA” sh.p.k me NIPT K51615512C, me adresë Tiranë Kamëz, Rruga Berisha, Argjinatura me nr.pasurie 482, Çerkezë, me ofertë të paraqitur me një vlerë totale prej 45,667,211.7 (dyzet e pesë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e njëmbëdhjetë pikë shtatë) lekë pa TVSH / totali i pikëve të marra [\_\_\_\_\_]; se është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr.162/2020 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**DREJTORIA E UJITJES DHE KULLIMIT LEZHË**

Drejtuar: Bashkimit te Operatoreve Ekonomik “EUROKOS HOLDING SH.P.K. DEGA NE SHQIPERI” & “ABI CONS” SH.P.K & “2Z KONSTRUKSION” SH.P.K, perfaqesuar nga OE “EUROKOS HOLDING SH.P.K. DEGA NE SHQIPERI”, me adrese Njesia Bashkiake Nr. 9, Bulevardi Zogu i I, Godina Nr. 2, Ap.7, Shk. 1, kati 3-te, Tirane.

Procedura e prokurimit/lotit: E hapur/ Pune.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-73021-06-20-2023.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Mbrotjtja nga lumi Drin ne Juban”.

Kohëzgjatja e kontratës: 6 muaj nga nenshkrimi i kontrates.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- I. Operatori ekonomik “ALBAVIA” SH.P.K, me numer nipt J81527001Q dhe me oferte ekonomike 63,406,189.21 (gjashtedhjetë e tre milion e katerqind e gjashtë mijë e njeqind e tetedhjetë e nente pike njezet e nje) lek pa tvsh,
- II. Bashkimi i operatoreve ekonomik “B93 II” SH.P.K me nipt “L522090500” SH.P.K, & “B-93” SH.P.K me Nipt J62903508R & “Elmazaj Konstruksion” SH.P.K me nipt L33229401T dhe me oferte ekonomike 81,850,699.46 (tetedhjetë e nje milion e teteqind e pesedhjetë mijë e gjashtëqind e nentedhjetë e nente pike dyzet e gjashtë) lek pa tvsh,
- III. Operatori ekonomik “BE-IS” sh.p.k me nipt K71412003A dhe me oferte ekonomike 66,605,161 (gjashtedhjetë gjashtë milion e gjashtë qinde pese mijë njiqind gjashtedhjetë e nje) lek pa tvsh,
- IV. Bashkimi i operatoreve ekonomike “EUROKOS HOLDING SH.P.K. DEGA NE SHQIPERI”, me nipt K91727010A & “ABI CONS” SH.P.K, me nipt L41525007G & “2Z KONSTRUKSION” SH.P.K me nipt J63229466K dhe me oferte ekonomike 78,868,711.48 (shtatedhjetë e tete milion e teteqind e gjashtedhjetë e tete mijë e shtateqind e njembdhjetë pike dyzet e tete) lek pa tvsh,
- V. Operatori ekonomik “JUBICA.” SH.P.K, me nipt K26529001I dhe me oferte ekonomike 48,000,010 (dyzet e tete milion e dhjetë) lek pa tvsh,
- VI. Bashkimi i operatoreve ekonomik “LIS KONSTRUKSION” SH.P.K me nipt K66613407H & “VIANTE Konstruksion” SH.P.K me nipt K47103804L dhe me oferte ekonomike 61,676,643 (gjashtedhjetë e nje million e gjashtëqind e shtatedhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e dyzet e tre) lek pa tvsh,
- VII. Bashkimi i operatoreve ekonomike “LODI CONSTRUCTION” SH.P.K me nipt L77127002 & “ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCTION” me nipt K91326028I dhe me oferte



- ekonomike 74,025,452 (shtatedhjetë e kater milion e njezet e pese mij e katerqind e pesedhjetë e dy) lek pa tvsh,
- VIII. Bashkimi i operatoreve ekonomike “NDERTUESI 2014” SH.P.K me nipt L46827004L & “UDHA” SH.P.K me nipt K77524909Q dhe me oferte ekonomike 64,077,375 (gjashtedhjetë e kater milion e shtatedhjetë e shtate mije e treqind e shtatedhjetë e pese) lek pa tvsh,
- IX. Bashkimi i operatoreve ekonomike “Rroku GUEST” SH.P.K me nipt K87921701H & “SHPRESA – AL” SH.P.K me nipt K31321021N dhe me oferte ekonomike 47,451,574.76 (Dyzet e shtatë milion e katërqind e pesëdhjetë e një mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër pikë shtatëdhjetë e gjashtë) lek pa tvsh,
- X. Operatori ekonomik “SHENDELLI” SH.P.K me nipt K07924803N dhe me oferte ekonomike 75,332,504 (shtatedhjetë e pese milion e treqind e tridhjetë e dy mije e peseqind e kater) lek pa tvsh,
- XI. Bashkimi i operatoreve ekonomik “S.M.O.UNION” SH.P.K me nipt J66902042Q & “BLERIMI” SH.P.K me nipt J62903384G dhe me oferte ekonomike 48,875,243 (dyzet e tete milion e teteqind e shtatedhjetë e pese mije e dyqind e dyzet e tre) lek pa tvsh,
- XII. Bashkimi i operatoreve ekonomik “SMO VATAKSI” SH.P.K me nipt L47022001J & G.P.G. COMPANY me nipt J64324443V dhe me oferte ekonomike 55,338,717 (pesedhjetë e pese milion e treqind e tridhjetë e tete mije shtateqind e shtatembedhjetë) lek pa tvsh,
- XIII. Operatori ekonomik “ULZA” SH.P.K me nipt J67902928O dhe me oferte ekonomike 72,495,461 (shtatedhjetë e dy milion e katerqind e nentedhjetë e pese mije e katerqind e gjashtedhjetë e nje) lek pa tvsh,

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- I. Operatori ekonomik “ALBAVIA” SH.P.K, me numer nipti J81527001Q,

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE, rezulton se:

Se pari, nuk ploteson kriterin 2.3.12, te kushteve te veçanta te kualifikimit ku parashikohet se : *Operatori ekonomik ne rast se nuk eshte prodhues duhet te paraqese kontrat e furnizimit per materialet si me poshte:*

#### 2.3.12/1 Per Hekurin

*- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar”.*

Komisioni i Vleresimit te Ofertave veren se per permbushjen e ketij kriteri operatoret ekonomike ne rast se nuk jane prodhues duhet te paraqesin per “*hekurin*”, kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Nga verifikimi ne SPE rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur dokumentin “*AUTORIZIM DISTRIBUTORI*”, si dhe ka nenshkruar kontrate furnizimi per *hekurin*, me subjektin “LARTI” SHPK, me Nuis J94316024A.

Po ashtu nga verifikimi i dokumentit “AUTORIZIM DISTRIBUTORI”, te leshuar nga subjekti “LARTI” SHPK, verehet se nuk ka informacion se distributor i te cilit prodhues eshte subjekti “LARTI” SHPK.

Sa me siper, KVO veren se OE nuk ka paraqitur per furnizuesin, autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër qe provon lidhjen midis tij dhe prodhuesit.

KVO mban ne konsiderate se edhe Komisioni i Prokurimit Publik ne vendimin nr. 825/2021 nder te tjera ka theksuar se: per te permbushur qellimin e vendosjes se kriterit duhet te parashikohen forma apo dokumentacione alternative provuese te cilat vertetojne lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit te autorizuar nga prodhuesi.

Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik ka mbajtur te njejtin qendrim edhe ne vendimin nr. 604/2019 ne te cilin ka theksuar se : - “KPP gjykon se mungesa e dokumentit autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar nga prodhuesi nga kompanitë ADINNOL”, ”CHAMPION”, “RAVENOL”, “CASTROL”, “MOTUOL”, “CYCLO” dhe “CHIMITEX, për të cilat janë paraqitur katalogë teknike bën që dokumentacioni i paraqitur nga ankimuesi të mos jetë i plotë për përmbushjen e kriterëve kualifikuese të përcaktuara në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Në rastin konkret nuk krijohet bindja mbi origjinalitetin e disa prej produkteve objekt prokurimi pasi për to janë paraqitur vetëm katalogë të prodhuesve të ndryshëm nga të cilët ankimuesi nuk ka asnjë autorizim apo dokument që të provojë lidhjen mes tyre”

- “KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto rrethana, KPP gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga “Alstezo” sh.p.k. nuk është i plotë dhe i saktë dhe nuk krijon bindjen mbi origjinalitetin për një pjese të mallrave objekt prokurimi”.

Sa me siper duke qene se furnizuesi per hekurin nuk disponon QKL si prodhues, si dhe duke qene se nuk ka paraqitur per furnizuesin autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër qe provon lidhjen midis tij dhe prodhuesit ky kriter konsiderohet i papermbushur.

Se dyti, nuk ploteson kriterin 2.3.14, te kushteve te veçanta te kualifikimit ku parashikohet se: “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratën ku të shprehet se është dakort me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Paraqitja e kësaj deklarate është kërkuar, pasi financimi është parashikuar në buxhetin 2023-2024, por afati i realizimit është sipas grafikut të punimeve”.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave veren se per permbushjen e ketij kriteri operatori ekonomik duhet te paraqese deklaratën ku të shprehet se është dakort me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, pasi financimi eshte nga buxheti i shtetit dhe eshte percaktuar per vitin 2023-2024 dhe operatoret ekonomik me dorezimin e ofertes duhet te jene dakort me financimin ne menyre qe mos te kene pretendime ekstra lidhur me kostot apo per afatin e realizimit te punimeve.

Nga verifikimi ne Sistemin e Prokurimeve Elektronike, rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur deklaratën per kriterin 2.3.14 duke mospermshur ate.

Se treti, nuk ploteson kriterin 2.3.5, te kushteve te veçanta te kualifikimit ku parashikohet se: *“Krahas stafit teknik Operoret Ekonomike duhet te kene te punesuar staf mbeshtetes si me poshte:*

- Ing. Ndertimi	1 (nje)	Diplome Universitare
- Teknik ndertimi	2 (dy)	Diplome shkolles mesme
- Teknik Gjeometer	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
- Karpertier	2 (dy)	Deshmi Profesionale
- Hekurkthyes	2 (dy)	Deshmi Profesionale
- Perpunues Guri	2 (dy)	Deshmi Profesionale
- Shofer	6 (gjashte)	Leje Drejtimi
- Manovrator	4 (kater)	Certifikate e Aftesise Profesionale (CAP)

*Operatori ekonomik duhet te paraqes per stafin e mesiperm: Kontratat individuale te punës, Diplome Universitare/ Diplome e shkolles mesme/ Deshmitë profesionale/ Certifikate e Aftesise Profesionale (CAP)/ Leje Drejtimi sipas shenimeve per cdo kategori te mesiperme si dhe stafi i mesiperm te figuroje ne listepagesat e shoqerise per periudhen Mars 2023 - Maj 2023.*

*V.O- Dokumentacioni (Diplomat/deshmitë/certifikatat) qe nuk eshte leshuar sipas legjislacionit perkates te arsimimit profesional do te konsiderohen jo te sakta dhe behen shkak per veprime te metejshme sipas parashikimeve perkatese te ligjit te prokurimit publik.*

*Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimit.”*

Nga verifikimi ne SPE verehet se ky OE ka vetedeklaruar ne formularin permbledhes te vetedeklarimit disponimin teknikeve te *Ndertimit dhe gjeometer, si me poshte:*

- *Z. (A. M) me profesion Teknik Ndertimi i punesuar prane shoqerise sone ne rolin e Teknik Ndertimi, me kontrate individuale pune, i pajisur me Deshmi kualifikimi Profesional / Diplome dhe Deshmi kualifikimi te sigurimit teknik*
- *Z. (J. C) me profesion Teknik Ndertimi i punesuar prane shoqerise sone ne rolin e Teknik Ndertimi, me kontrate individuale pune, i pajisur me Deshmi kualifikimi Profesional / Diplome dhe Deshmi kualifikimi te sigurimit teknik*
- *Z. (G. C) me profesion Teknik Gjeometer i punesuar prane shoqerise sone ne rolin e Teknik Gjeometer, me kontrate individuale pune, i pajisur me Deshmi kualifikimi Profesional / Diplome dhe Deshmi kualifikimi te sigurimit teknik*

Bazuar ne kete vetedeklarim te paraqitur nga ana e OE verehet se per tekniket e *Ndertimit dhe gjeometer, ky Operator ka deklaruar se disponojne “Deshmi kualifikimi Profesional / Diplome dhe Deshmi kualifikimi te sigurimit teknik”* duke mos dhene informacion nese tekniket e mesiperm disponojne Diplome te shkolles se mesme, duke krijuar konfuzion per KVO-ne per plotesimin e ketij kriteri.

KVO me qellim realizimin e nje vleresimi sa me objektiv duke qene se eshte i paqarte kualifikimi arsimor per tekniket e ndertimit dhe gjeometrin te deklaruar ne Formularin Permbledhes te

Vetedeklarimit, si dhe per ti dhene mundesi operatorit ekonomik te sqarohet ne lidhje me disponimin e *diplomes te shkolles se mesme* per tekniket e *Ndertimit dhe Gjeometrit*, bazuar ne piken 7, te VKM-se nr. 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime”, vendosi ti kerkoje sqarim nepermjet SPE-se, operatorit ekonomik “ALBAVIA” SH.P.K, i cili nuk u pergjigj kerkeses per sqarim.

Sa me siper duke qene se OE nuk i ktheu pergjigje kerkeses per sqarim (moment ky procedural ne dispozicion te OE), konstatohet se ky operator ekonomik nuk disponon me *diplome te shkolles se mesme* asnje nga tekniket e kerkuar te *Ndertimit dhe Gjeometrit*, pasi bazuar ne formularin permeledhes te vetedeklarimit te paraqitur nga ana e OE verehet se per tekniket e *Ndertimit dhe gjeometer* ka deklaruar se disponojne *Deshmi kualifikimi Profesional / Diplome dhe Deshmi kualifikimi te sigurimit teknik* dhe jo diplome te shkolles se mesme sipas kerkesave te kriterit 2.3.5, te DST-se dhe per rrjedhoje ky kriter konsiderohet i papermbushur.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe ne në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi te refuzoje oferten e OE “ALBAVIA” SH.P.K, per mos permbushje te kriterëve te vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “ALBAVIA” SH.P.K, me Nuis K53002402C, *skualifikohet*.

II. Operatori ekonomik “BE-IS” sh.p.k me nipt K71412003A,

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE, rezulton se:

Se pari, nuk ploteson kriterin 2.3.12, te kushteve te veçanta te kualifikimit ku parashikohet se “Operatori ekonomik ne rast se nuk eshte prodhues duhet te paraqese kontrat e furnizimit per materialet si me poshte:

### 2.3.12/1 Per Hekurin

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar”.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave veren se per permbushjen e ketij kriteri operatorët ekonomike ne rast se nuk jane prodhues duhet te paraqesin per “hekurin” kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar

Nga verifikimi ne SPE rezulton se operatori ekonomik ka nenshkruar kontrate furnizimi per hekurin, me nje subjekt i cili nuk rezulton te jete prodhues.

KVO duke pasur ne konsiderate se te gjithë prodhuesit e kane detyrim ligjor pajisjen me leje mjedisore nga QKL, beri nje kerkim ne faqen zyrtare qkb.gov.al, ku rezultoi se furnizuesi per hekurin nuk disponon QKL si prodhues.

Po ashtu, KVO veren se OE nuk ka paraqitur per furnizuesin autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis tij dhe prodhuesit.

KVO mban ne konsiderate se edhe Komisioni i Prokurimit Publik ne vendimin nr. 825/2021 nder te tjera ka theksuar se per te permbushur qellimin e vendosjes se kriterit duhet te parashikohen forma apo dokumentacione alternative provuese te cilat vertetojne lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit te autorizuar nga prodhuesi.

Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik ka mbajtur te njejtin qendrim edhe ne vendimin nr. 604/2019 ne te cilinka theksuar se: -“KPP gjykon se mungesa e dokumentit autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar nga prodhuesi nga kompanitë ADINNOL”, ”CHAMPION”, “RAVENOL”, “CASTROL”, “MOTUOL”, “CYCLO” dhe “CHIMITEX, për të cilat janë paraqitur katalogë teknikë bën që dokumentacioni i paraqitur nga ankimuesi të mos jetë i plotë për përmbushjen e kriterëve kualifikuese të përcaktuara në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Në rastin konkret nuk krijohet bindja mbi origjinalitetin e disa prej produkteve objekt prokurimi pasi për to janë paraqitur vetëm katalogë të prodhuesve të ndryshëm nga të cilët ankimuesi nuk ka asnjë autorizim apo dokument që të provojë lidhjen mes tyre”

-“KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto rrethana, KPP gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga “Alstezo” sh.p.k. nuk është i plotë dhe i saktë dhe nuk krijon bindjen mbi origjinalitetin për një pjesë të mallrave objekt prokurimi”.



Sa me siper duke gene se furnizuesi per *hekurin* nuk disponon QKL si prodhues, si dhe duke gene se nuk ka paraqitur per furnizuesin autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër qe provon lidhjen midis tij dhe prodhuesit ky kriter konsiderohet i papermbushur.

Se dyti, nuk permbush kriterin 2.3.5, ku parashikohet se: “*Krahas stafit teknik Operatoret Ekonomike duhet te kene te punesuar staf mbeshtetes si me poshte:*

- Ing. Ndertimi	1 (nje)	Diplome Universitare
- Teknik ndertimi	2 (dy)	Diplome shkolles mesme
- Teknik Gjeometer	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
- Karpertier	2 (dy)	Deshmi Profesionale
- Hekurkthyes	2 (dy)	Deshmi Profesionale
- Perpunues Guri	2 (dy)	Deshmi Profesionale
- Shofer	6 (gjashte)	Leje Drejtimi
- Manovrator	4 (kater)	Certifikate e Aftesise Profesionale (CAP)

*Operatori ekonomik duhet te paraqes per stafin e mesiperm: Kontratat individuale te punës, Diplome Universitare/ Diplome e shkolles mesme/ Deshmitë profesionale/ Certifikate e Aftesise Profesionale (CAP)/ Leje Drejtimi sipas shenimeve per cdo kategori te mesiperme si dhe stafi i mesiperm te figuroje ne listepagesat e shoqerise per periudhen Mars 2023 - Maj 2023.*

*V.O- Dokumentacioni (Diplomat/deshmite/certifikatat) qe nuk eshte leshuar sipas legjislacionit perkates te arsimimit profesional do te konsiderohen jo te sakta dhe behen shkak per veprime te metejshme sipas parashikimeve perkatese te ligjit te prokurimit publik.*

*Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.*

KVO veren se bazuar ne piken 1, te nenit 26, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si prove paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, dhe per te permbushur kete kriter operatoret ekonomik pjesmarres duhet te vetedeklarojne ne formularin permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se, te dhenat e stafit teknik, mbeshtetes dhe te certifikuar qe disponon sipas percaktimeve te DST-se.*

Nga verifikimi ne SPE, rezulton se ky OE nuk ka deklaruar ne formularin permbledhes te vetedeklarimit disponimin e 2 (dy) punonjesve perpunues guri sipas kriterit 2.3.5 te DST-se.

KVO veren se ky operator ka paraqitur ne SPE informacion mbi subjektin, mbi kapacitetin e te cilit do te mbeshtetet per piken 2.3.5, per perpunuesit e gurit.

Ndersa nga verifikimi i DST-se, ne seksionin 2.16 parashikohet se:

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po X Jo

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që nuk lejohet mbështetja:

Nuk lejohet mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera për përbushjen e kritereve të veçanta të pikave 2.3.4; 2.3.5; 2.3.6 dhe 2.3.7

KVO konstaton se autoriteti kontraktor nuk lejon për këtë procedurë prokurimi mbështetje në kapacitetet e subjekteve të tjera për përbushjen e kritereve të veçanta të pikave 2.3.4; 2.3.5, 2.3.6 dhe 2.3.7.

Për sa më lart duke qenë se operatori ekonomik nuk ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetedeklarimit disponimin e 2 (dy) përpunuesve të gurit, si dhe duke qenë se në DST, nuk lejohet mbështetje në kapacitetet e subjekteve të tjera për përbushjen e kritereve të veçanta të pikave 2.3.4; 2.3.5, 2.3.6 dhe 2.3.7 ky kriter konsiderohet i papërbushur.

Se treti, nuk ka paraqitur shtojcën nr. 2 (Lista e çmimeve sipas zerave të preventivit) e cila është një shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik, të parashikuar në DST, sipas formatit të mëposhtem:

Shtojca 2.

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*  
LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT

Data: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): \_\_\_\_\_

Monedha: \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe të vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

#### Oferta ekonomike e detajuar

Nr	Nr. Analizë	Përshkrimi i Punëve	Njësi	Sasia	Çmimi/ Njësi	Cmimi total
1.						
2.						
3.						

Shuma						
Fondi Rezervë						
Shuma						
TVSH						
SHUMA TOTAL						

Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_

Vula

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën \_\_\_\_ ( e kërkuar në dokumentat e tenderit )

KVO mban ne konsiderate se ne nenin 14, te VKM-se 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, parashikohet se: *“APP-ja harton dhe miraton me vendim formatin e dokumenteve standarde të tenderit që do të përdoren gjatë procedurave të prokurimit, për çdo lloj procedure prokurimi sipas nenit 41, të LPP-së, dhe çdo tip kontrate”.*

Po ashtu KVO mban ne konsiderate se formati i shtojces nr. 2, per procedurat e prokurimit “E hapur / Pune” eshte miratuar me vendimin nr. 10, date 05.10.2022 *“Per miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve ne dokumentat standarte te tenderit per mallra, pune, sherbime per proceduren e prokurimit “Procedure e Hapur”, dhe ne vendimin nr. 02, date 09.06.2021 “Per miratimin e dokumentave standarte te tenderit per mallra, pune, sherbime per proceduren e prokurimit “Procedure e Hapur” dhe asnje autoritet kontraktor apo operator ekonomik nuk mund te modifikojë apo te ndryshojë formularët e miratuar ne DST.*

KVO konstaton se ne dokumentat standarte te tenderit te procedures se prokurimit me objekt “Mbrojtja nga lumi Drin ne Juban”, ne seksionin I, udhezime per Operatoret Ekonomike, ne piken A/2 b) percaktohet se: *“b) “Operatori Ekonomik duhet të konsultohet me të gjitha udhëzimet, formularët, termat dhe specifikimet në Dokumentet e Tenderit. Mosdhënia nga operatori ekonomik e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Dokumentet e Tenderit, do të çojë në refuzimin e Ofertës”.*

Ndersa ne dokumentat standarte te tenderit te procedures se prokurimit me objekt “Mbrojtja nga lumi Drin ne Juban”, ne seksionin I, udhezime per Operatoret Ekonomike, ne piken B/4 percaktohet se: *“Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar”.* Po ashtu ne dokumentat standarte te tenderit te procedures se prokurimit me objekt “Mbrojtja nga lumi Drin ne Juban”, ne seksionin I, udhezime per Operatoret Ekonomike, ne piken B/10 *“Formati dhe nenshkrimi i ofertes”, percaktohet se: “Në përgjigje të Njoftimit të Kontratës, cdo Operator Ekonomik paraqet ofertën sipas formularëve standard në këtë DT. Oferta nënshkruhet nga personi/personat përgjegjës të autorizuar për këtë qëllim”.*



Gjithashtu edhe ne vete formatin e shtojces nr. 2 (Lista e çmimeve sipas zerave te preventivit) eshte e percaktuar se: *“Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës”*

Nga verifikimi ne SPE, verehet se OE ka paraqitur nje preventiv oferte i cili nuk permban asnje nga elementet apo deklarimet e parashikuara ne Shtojcen nr. 2 te DST-se.

Po ashtu verehet se shtojca nr. 2 (Lista e çmimeve sipas zerave te preventivit) e paraqitur nga operatori ekonomik nuk permban asnje nga zerat e preventivit por vetem nje cmim total te ofertes, informacion ky i cili paraqitet ne shtojcen nr. 1.

KVO nenvizon se formulimi i shtojcave dhe deklaratave te miratuara nga ligjvensi ne DST-ne e kesaj procedure eshte bere per faktin se te gjithë operatorët ekonomike te deklarojne me pergjegjesi te plote sipas formatit te miratuar, duke mos lene asnje mundesi shmangie nga deklarimet apo pergjegjesite qe marrin operatorët me ane ate ketyre deklarimeve.

Per me teper edhe Komisioni i Prokurimit Publik ka mbajtur te njejtin qendrim ne lidhje me plotesimin e shtojcave ne vendimin nr. 210/2020, ku ka theksuar se: *“Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik., ka ndryshuar përmbajtjen e shtojcës 3 “Formulari i Sigurimit të Ofertës”, duke dorëzuar një “Formular” me përmbajtje të ndryshme nga ajo e përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi, duke shtuar rastin e mospërmbushjes së një kushti Ofertuesi ka dorëzuar një ofertë të pa përgjegjshme, i cili nuk është parashikuar në shtojcën e hartuar nga autoriteti kontraktor. Kjo bie në kundërshtim me kreun II “UDHËZIME PËR OPERATORËT EKONOMIKË”, seksioni 1 “Hartimi i ofertës”, pika 1.1 të dokumenteve të procedurës së prokurimit në të cilën është parashikuar se “Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.” Gjithashtu, vlen të theksojmë se, dokumentat standarte të tenderit, janë dokumenta, që autoriteti kontraktor ua vë në dispozicion kandidatëve dhe ofertuesve të mundshëm për përgatitjen e ofertave. Në hartimin e këtyre dokumenteve, autoriteti kontraktor duhet të përdorë dokumentat standarde të tenderit. Rrjedhimisht, që nga data kur ka hyrë në fuqi vendimi për miratimin e ndryshimeve të dokumentave të tenderit, të gjitha procedurat e prokurimit do të shpallen nga autoritetet kontraktore sipas setit te ri te dokumentave standarde te tenderit, të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, të cilat janë të detyrueshme për tu zbatuar si nga ana e autoritetit kontraktor ashtu edhe nga operatorët ekonomikë të cilët marrin pjesë në një procedurë prokurimi publik”.*

Nisur sa me lart, KVO duke marre ne konsiderate udhezimet per operatorët ekonomike ne DST-se dhe vendimin nr. 210/2020 te KPP-se, thekson se ne kete rast jemi përmballë mosplotësisimit në formën e duhur të një shtojce e cila është pjesë përbërëse e dokumentave të procedurës së prokurimit dhe është e detyrueshme që të plotësohet sipas formatit të miratuar nga organet ligjzbatuese, pasi mosdhënia nga operatori ekonomik i të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në Dokumentet e Tenderit, rrjedhimisht do të çojë në refuzimin e Ofertës.

Se katerti, nuk ploteson kriterin 2.3.13, te kushteve te veçanta te kualifikimit ku parashikohet se: *“Operatori Ekonomik duhet te kete nje kontrate bashkepunimi me nje laborator te testimit te betonit, i cili duhet te jete i akredituar nga organizma kombetare ose nderkombetare, sipas standarteve SSH*

*EN 12390-3:2009, SSH EN 12504-4:2008; SSH EN 12350-2: 2009 dhe SSH EN 12504-2:2012 ose ekuivalent.*”.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave veren se per permbushjen e ketij kriteri operatorët ekonomike duhet te paraqesin kontrate bashkepunimi me nje laborator te testimit te betonit.

Nga verifikimi ne SPE rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnje dokumentacion qe provon permbushjen e ketij kriteri.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe ne në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi te refuzoje oferten e OE “BE-IS” SH.P.K, per mos permbushje te kriterëve te vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “BE-IS” SH.P.K, me Nuis K71412003A, *skualifikohet*.

III. Operatori ekonomik “JUBICA.” SH.P.K, me nipt K26529001I,

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE, rezulton se:

Se pari, nuk ploteson kriterin 2.3.1, ku parashikohet se: “*Operatorët Ekonomike duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,*  
*ose*

*b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme”.

Theksojme se për te permbushur piken 2.3.1, ne lidhje me dëshmitë për pervojen e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë pese viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, OE duhet te paraqesin dokumentacion per realizimin e puneve te ngjashme me vlere jo me te vogel se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet per nje objekt te vetem ose pune te ngjashme ku vlera totale e puneve eshte jo me te vogel se dyfishi i vleres limit te kontrates qe prokurohet.

Dokumentacioni qe operatoret ekonomike duhet te paraqesin eshte si me poshte vijon:

- Për kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vlerësimit;
2. Kontratën/Kontratat;
3. Situacionin përfundimtar;
4. Akt Kolaudimi;
5. *Faturat tatimore*;

- Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kontratë siper marrje;
2. Situacionin përfundimtar;
3. Fatura tatimore;
4. Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim;

Ky dokumentacion duhet te pasqyroje punime te ngjashme te realizuar brenda pese viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës dhe vecanerisht situacionet dhe faturat tatimore duhet ti referohen punimeve te realizuara brenda pese viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, pasi fatura tatimore eshte detyrim ligjor te leshohet ne momentin e realizimit te punes.

Sa me siper verehet se per pambushjen e ketij kriteri OE ka paraqitur ne SPE nenkontraten me NR. R/208/055/16, me objekt: “Ndertimi i By Pass Fier”, lidhur ndermjet Operatorit Ekonomik “Serenissima Costruzioni” dhe “Jubica” Shpk, me vlere te nen kontrates prej 857,875 Euro, me date fillimi kontrate 01.07.2016 dhe date mbarimi kontrate 17.09.2018.

KVO sqaron se data e shpalljes se njoftimit te kontrates objekt prokurimi eshte data 21.06.2023 dhe per rrjedhoje 5 vite nga kjo date per efekt perlllogaritje te puneve te ngjashme eshte data 21.06.2018.

Nga verifikimi ne SPE, rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur formular vleresimi nga ARRS, me date fillimi punimesh 01.07.2016 dhe date mbarimi punimesh 17.09.2018, i shoqeruar me situacione dhe faturat taimore ku verehet si me poshte vijon:

1. Fatura nr. 86, date 19.09.2018, me vlere punimesh prej 8,744,548 lek pa tvsh,(brenda pese viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës),
2. Fatura nr. 67, date 08.05.2018, me vlere punimesh prej 10,055,341 lek pa tvsh, (jashte afatit prej pese viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës),
3. Fatura nr. 61, date 15.01.2018, me vlere punimesh prej 12, 167,428 lek pa tvsh, (jashte afatit prej pese viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës),
4. Fatura nr. 56, date 30.09.2017, me vlere punimesh prej 8,426,172 lek pa tvsh, (jashte afatit prej pese viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës),

5. Fatura nr. 55, date 15.05.2017, me vlere punimesh prej 11,364,732 lek pa tvsh, (jashte afatit prej pese viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës),
6. Fatura nr. 51, date 09.01.2017, me vlere punimesh prej 18,466,799 lek pa tvsh, (jashte afatit prej pese viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës),
7. Fatura nr. 44, date 15.09.2016, me vlere punimesh prej 8,497, 613 lek pa tvsh, (jashte afatit prej pese viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës),
8. Fatura nr. 37, date 29.07.2016, me vlere punimesh prej 8,517, 010 lek pa tvsh. (jashte afatit prej pese viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës).

Sa me siper konstatohet se vetem fatura nr. 86, date 19.09.2018, me vlere punimesh prej 8,744,548 lek pa tvsh eshte brenda afatit 5 vjecar nga shpallja e njoftimit te kontrates.

Sa konstatuam me siper, Komisioni i Vleresimit te Ofertave veren se per me teper edhe Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) ne vendimin nr. 670/2019, ka mbajtur te njejtin qendrim ku nder te tjera ka theksuar se: *“Në kriteret e veçanta të kualifikimit të hartuar nga autoriteti kontraktor, si edhe vetë parashikimeve të aktit nënligjor në zbatim të ligjit, KPP gjykon se operatorët ekonomikë, për të vërtetuar eksperiencën e mëparshme në kontratat për punë publike duhet të dorëzojnë kontrata të përfunduara, pra me anë të dokumentacionit duhet të dëshmojnë se kanë realizuar me sukses punime të përfunduara brenda 3 viteve të fundit (afati sipas parashikimive ligjore te kohes)”*.

Gjithashtu ne kete vendim Komisioni i Prokurimit Publik (KPP), ka arsyetuar se: *“Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Në këto kushte, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik, në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor për eksperiencat e mëparshme të ngjashme dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm”*.

Si perfundim operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat e parashikuara ne DST për eksperiencat e mëparshme të ngjashme dhe dokumentacioni i paraqitur nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Se dyti, nuk ka paraqitur shtojcen nr. 2 (Lista e çmimeve sipas zerave te preventivit) e cila eshte nje shtojce per tu praqitur nga operatori ekonomik, te parashikuar ne DST, sipas formatit te meposhtem:

Shtojca 2.

*(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)*  
LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT

Data: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): \_\_\_\_\_

Monedha: \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

#### Oferta ekonomike e detajuar

Nr	Nr. Analizë	Përshkrimi i Punëve	Njësi	Sasia	Çmimi/Njësi	Cmimi total
1.						
2.						
3.						
Shuma						
Fondi Rezervë						
Shuma						
TVSH						
SHUMA TOTAL						

Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_

Vula

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën \_\_\_\_ ( e kërkuar në dokumentat e tenderit )

KVO mban ne konsiderate se ne nenin 14, te VKM-se Nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, parashikohet se: “APP-ja harton dhe miraton me vendim formatin e dokumenteve standarde të tenderit që do të përdoren gjatë procedurave të prokurimit, për çdo lloj procedure prokurimi sipas nenit 41, të LPP-së, dhe çdo tip kontrate”.

Po ashtu KVO mban ne konsiderate se formati i i shtojce nr.2, per procedurat e prokurimit “E hapur / Pune” eshte miratuar me vendimin nr. 10, date 05.10.2022 “Per miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve ne dokumentat standarte te tenderit per mallra, pune, sherbime per proceduren e



prokurimit “Procedure e Hapur”, dhe ne vendimin nr. 02, date 09.06.2021 “Per miratimin e dokumentave standarte te tenderit per mallra, pune, sherbime per proceduren e prokurimit “Procedure e Hapur” dhe asnje autoritet kontraktor apo operator ekonomik nuk mund te modifikojë apo te ndryshojë formularët e miratuar ne DST.

KVO konstaton se ne dokumentat standarte te tenderit te procedures se prokurimit me objekt “Mbrotja nga lumi Drin ne Juban”, ne seksionin I, udhezime per Operatoret Ekonomike, ne piken A/2 b) percaktohet se “b) “Operatori Ekonomik duhet të konsultohet me të gjitha udhëzimet, formularët, termat dhe specifikimet në Dokumentet e Tenderit. Mosdhënia nga operatori ekonomik e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Dokumentet e Tenderit, do të çojë në refuzimin e Ofertës”.

Ndersa ne dokumentat standarte te tenderit te procedures se prokurimit me objekt “Mbrotja nga lumi Drin ne Juban”, ne seksionin I, udhezime per Operatoret Ekonomike, ne piken B/4 percaktohet se “Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar”.

Po ashtu ne dokumentat standarte te tenderit te procedures se prokurimit me objekt “Mbrotja nga lumi Drin ne Juban”, ne seksionin I, udhezime per Operatoret Ekonomike, ne piken B/10 “Formati dhe nenshkrimi i ofertes”, percaktohet se “Në përgjigje të Njoftimit të Kontratës, cdo Operator Ekonomik paraqet ofertën sipas formularëve standard në këtë DT. Oferta nënshkruhet nga personi/personat përgjegjës të autorizuar për këtë qëllim”.

Gjithashtu ne shtojcen nr. 2 (Lista e çmimeve sipas zerave te preventivit) eshte percaktuar se “Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës” Nga verifikimi ne SPE, verehet se OE ka paraqitur nje preventiv oferte i cili nuk permban asnje nga elementet apo deklarimet e parashikuara ne Shtojcen nr. 2, te DST-se.

KVO nenvizon se formulimi i shtojcave dhe deklaratave te miratuara nga ligjvendi ne DST-ne e kesaj procedure eshte bere per faktin se te gjithe operatoret ekonomike te deklarojne me pergjegjesi te plote sipas formatit te miratuar, duke mos lene asnje mundesi shmangie nga deklarimet apo pergjegjesite qe marrin operatoret me ane ate ketyre deklarimeve.

Per me teper edhe Komisioni i Prokurimit Publik ka mbajtur te njejtin qendrim ne lidhje me plotesimin e shtojcave ne vendimin nr. 210/2020, ku ka theksuar se: “Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik., ka ndryshuar përmbajtjen e shtojcës 3 “Formulari i Sigurimit të Ofertës”, duke dorëzuar një “Formular” me përmbajtje të ndryshme nga ajo e përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi, duke shtuar rastin e mospërmbushjes së një kushti Ofertuesi ka dorëzuar një ofertë të pa përgjegjshme, i cili nuk është parashikuar në shtojcën e hartuar nga autoriteti kontraktor. Kjo bie në kundërshtim me kreun II “UDHËZIME PËR OPERATORËT EKONOMIKË”, seksioni 1 “Hartimi i ofertës”, pika 1.1 të dokumenteve të procedurës së prokurimit në të cilën është parashikuar se “Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.” Gjithashtu, vlen të theksojmë se, dokumentat standarte të tenderit, janë dokumenta, që autoriteti kontraktor ua vë në

*dispozicion kandidatëve dhe ofertuesve të mundshëm për përgatitjen e ofertave. Në hartimin e këtyre dokumenteve, autoriteti kontraktor duhet të përdorë dokumentat standarde të tenderit. Rrjedhimisht, që nga data kur ka hyrë në fuqi vendimi për miratimin e ndryshimeve të dokumentave të tenderit, të gjitha procedurat e prokurimit do të shpallen nga autoritetet kontraktore sipas setit të ri të dokumentave standarde të tenderit, të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, të cilat janë të detyrueshme për tu zbatuar si nga ana e autoritetit kontraktor ashtu edhe nga operatorët ekonomikë të cilët marrin pjesë në një procedurë prokurimi publik”.*

Nisur sa më lart, KVO duke marrë në konsideratë udhëzimet për operatorët ekonomikë në DST-se dhe vendimin nr. 210/2020 të KPP-se, thekson se në këte rast jemi përmballë mosplotësisimit në formën e duhur të një shtojce e cila është pjesë përbërëse e dokumentave të procedurës së prokurimit dhe është e detyrueshme që të plotësohet sipas formatit të miratuar nga organet ligjzbatuese, pasi mosdhënia nga operatori ekonomik e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në Dokumentet e Tenderit, rrjedhimisht do të çojë në refuzimin e Ofertës. Se treti, nuk përmbush kriterin 2.3.5, ku parashikohet se: “Krahas stafit teknik Operatorët Ekonomike duhet të kenë të punësuar staf mbështetës si me poshte:

- Ing. Ndertimi	1 (nje)	Diplome Universitare
- Teknik ndertimi	2 (dy)	Diplome shkolles mesme
- Teknik Gjeometer	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
- Karpertier	2 (dy)	Deshmi Profesionale
- Hekurkthyes	2 (dy)	Deshmi Profesionale
- Perpunues Guri	2 (dy)	Deshmi Profesionale
- Shofer	6 (gjashte)	Leje Drejtimi
- Manovrator	4 (kater)	Certifikate e Aftesise Profesionale (CAP)

*Operatori ekonomik duhet të paraqes për stafin e mesiperm: Kontratat individuale të punës, Diplome Universitare/ Diplome e shkolles mesme/ Deshmitë profesionale/ Certifikate e Aftesise Profesionale (CAP)/ Leje Drejtimi sipas shenimeve për çdo kategori të mesiperme si dhe stafi i mesiperm të figurojë në listepagesat e shoqërisë për periudhën Mars 2023 - Maj 2023.*

*V.O- Dokumentacioni (Diplomat/deshmitë/certifikatat) që nuk është leshuar sipas legjislacionit përkatës të arsimimit profesional do të konsiderohen jo të sakta dhe behen shkak për veprime të metejshme sipas parashikimeve përkatëse të ligjit të prokurimit publik.*

*Shenim: Kjo kerkese përmbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimimit.*

KVO verën se bazuar në piken 1, të nenit 26, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si prove paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, dhe për të përmbushur këte kriter operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të vetedeklarojnë në formularin përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se, të dhenat e stafit teknik, mbështetës dhe të certifikuar që disponon sipas përcaktimeve të DST-se.*

Nga verifikimi në SPE vërehet se ky OE ka vetedeklaruar në formularin përmbledhës të

vetedeklarimit disponimin teknikut Gjeometer, por bazuar ne dokumentacionin e paraqitur nga ky Operator Ekonomik ne Sistemin e Prokurimeve Elektronike verehet se ky teknik ka kryer nje kurs dy vjecar per gjeometer dhe jo i diplomuar me shkolle te mesme dhe si rrjedhoje nuk permbush kete kriter pasi tekniku gjeometer nuk disponon diplome te shkolles se mesme.

Per me teper nga verifikimi i QKB rezulton se institucioni qe ka leshuar diplomen per kursin dy vjecar (Gjeometer), nuk eshte i licensuar si institucion i arsimit te mesem profesional dhe as per kurse profesionale per gjeometri, pasi disponon vetem licence per Kurs formimi profesional me objekt: *Sisteme e ftohjes dhe kondicionimit, Instalime elektrike civile, Riparues per pajisje elektro-shtepiake, Sistemet elektronike e elektrike te automjeteve dhe diagnostifikimi i tyre, Web development dhe design.*

Sa me lart, operatori ekonomik nuk disponon Teknik Gjeometer te pajisur me diplome te shkolles se mesme sic kerkohet ne kriterin 2.3.5 te dokumentave standarte te tenderit per kete procedure prokurimi.

KVO gjykon se megjithese ky OE ka deklaruar ne formularin permbledhes te vetedeklarimit disponimin e teknikut gjeometer, si dhe duke qene se ka bashkengjitur ne SPE kontraten e punes dhe Diplomen profesionale, verehet se OE nuk ka pasur si qellim per te bere deklarim te rreme me qellim kualifikimi.

Se katerti, Komisioni i Vleresimit te Ofertave veren se oferta e paraqitur nga OE eshte oferte anomalisht e ulet, pasi ky OE ka paraqitur oferte me te ulet se 41% e fondit limit dhe me te ulet se 75% e mesatares se te gjitha ofertave te paraqitura, si dhe per KVO-ne, kjo anomali verehet e dyshimte (e papergjegjshme) duke qene se çmimet e materialeve te ndertimit kane pesuar nje rritje te konsiderueshme ne treg.

KVO thekson se bazuar ne piken 4, te nenit 82, te VKM-se 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, parashikohet se;

*"Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:*

- *Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;*
- *Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.*

KVO veren se edhe Komisioni i Prokurimit Publik ka mbajtur te njetin qendrim me vendimin nr. 149/2021, ku ka theksuar se: *"K.P.P gjykon se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riksut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. K.P.P gjykon se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si:*

- *rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur;*
- *rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i linden autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara;*



*-humbjet që mund të pësojë në kohë nga mos kryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të mos zbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët”*

Megjithatë, duke qene se Operatori Ekonomik rezulton i skualifikuar per arsyet e mesiperme, KVO, vendosi te mos kerkoje sqarim nga ofertuesi meqensese pozitat e Operatorit Ekonomik nuk ndryshojne.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi te refuzoje oferten e OE “JUBICA.” SH.P.K, per mos permbushje te kriterëve te vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “JUBICA.” SH.P.K, me Nuis K26529001I, *skualifikohet.*

IV. “LIS KONSTRUKSION” SH.P.K, me nipt K66613407H & “VIANTE Konstruksion” SH.P.K me nipt K47103804L,

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE, rezulton se:

Se pari, nuk ploteson kriterin 2.3.12, te kushteve te vecanta te kualifikimit ku parashikohet se *“Operatori ekonomik ne rast se nuk eshte prodhues duhet te paraqese kontrat e furnizimit per materialet si me poshte:*

*2.3.12/2 Per rrjete teli Gabion.*

*- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë*

*autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar”.*

Komisioni i Vleresimit të Ofertave verën se për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomikë në rast se nuk janë prodhues duhet të paraqesin për *“rrjete teli Gabion”* kontrata paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar

Nga verifikimi në SPE rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur një autorizim për *rrjete teli gabion*, me një subjekt i cili nuk rezulton të jetë prodhues.

Po ashtu nga verifikimi në SPE rezulton se BOE nuk ka paraqitur Kontrata paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar duke mos përmbushur kriterin 2.3.12/2.

KVO duke pasur në konsideratë se të gjithë prodhuesit e kanë detyrim ligjor pajisjen me leje mjedisore nga QKL, bëri një kërkim në faqen zyrtare [qkb.gov.al](http://qkb.gov.al), ku rezultoi se leshuesi i autorizimit për *rrjete teli gabion* nuk disponon QKL si prodhues.

KVO verën se OE nuk ka paraqitur aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis tij dhe prodhuesit.

KVO mban në konsideratë se edhe Komisioni i Prokurimit Publik në vendimin nr. 825/2021 ndër të tjera ka theksuar se për të përmbushur qëllimin e vendosjes së kriterit duhet të parashikohen forma apo dokumentacione alternative provuese të cilat vërtetojnë lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit të autorizuar nga prodhuesi.

Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik, ka mbajtur të njëjtin qëndrim edhe në vendimin nr. 604/2019, në të cilin thekson se : -*“KPP gjykon se mungesa e dokumentit autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar nga prodhuesi nga kompanitë ADINNOL”, “CHAMPION”, “RAVENOL”, “CASTROL”, “MOTUOL”, “CYCLO” dhe “CHIMITEX, për të cilat janë paraqitur katalogë teknikë bën që dokumentacioni i paraqitur nga ankimuesi të mos jetë i plotë për përmbushjen e kriterëve kualifikuesë të përcaktuara në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Në rastin konkret nuk krijohet bindja mbi origjinalitetin e disa prej produkteve objekt prokurimi pasi për to janë paraqitur vetëm katalogë të prodhuesve të ndryshëm nga të cilët ankimuesi nuk ka asnjë autorizim apo dokument që të provojë lidhjen mes tyre”*

-*“KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto rrethana, KPP gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga “Alstezo” sh.p.k. nuk është i plotë dhe i saktë dhe nuk krijon bindjen mbi origjinalitetin për një pjesë të mallrave objekt prokurimi”.*

Sa me sipër duke qenë se furnizuesi për *rrjete teli gabion* nuk disponon QKL si prodhues, si dhe duke qenë se nuk ka paraqitur për furnizuesin autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis tij dhe prodhuesit ky kriter konsiderohet i përmbushur.

Se dyti, nuk ka paraqitur shtojcen nr. 2 (Lista e çmimeve sipas zerave te preventivit) e cila eshte nje shtojce per tu praqitur nga operatori ekonomik, te parashikuar ne DST, sipas formatit te meposhtem:

Shtojca 2.

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*  
LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT

Data: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): \_\_\_\_\_

Monedha: \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Oferta ekonomike e detajuar

Nr	Nr. Analizë	Përshkrimi i Punëve	Njësi	Sasia	Çmimi/Njësi	Cmimi total
1.						
2.						
3.						
Shuma						
Fondi Rezervë						
Shuma						
TVSH						
SHUMA TOTAL						

Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_

Vula

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën \_\_\_\_ ( e kërkuar në dokumentat e tenderit )

KVO mban ne konsiderate se ne nenin 14, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” parashikohet se: *“APP-ja harton dhe miraton me vendim formatin e dokumenteve standarde të tenderit që do të përdoren gjatë procedurave të prokurimit, për çdo lloj procedure prokurimi sipas nenit 41, të LPP-së, dhe çdo tip kontrate”*.

Po ashtu KVO mban ne konsiderate se formati i i shtojce nr.2, per procedurat e prokurimit “E hapur / Pune” eshte miratuar me vendimin nr. 10, date 05.10.2022 *“Per miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve ne dokumentat standarte te tenderit per mallra, pune, sherbime per proceduren e prokurimit “Procedure e Hapur”, dhe ne vendimin nr. 02, date 09.06.2021 “Per miratimin e dokumentave standarte te tenderit per mallra, pune, sherbime per proceduren e prokurimit “Procedure e Hapur” dhe asnje autoritet kontraktor apo operator ekonomik nuk mund te modifikojë apo te ndryshojë formularët e miratuar ne DST.*

KVO konstaton se ne dokumentat standarte te tenderit te procedures se prokurimit me objekt: “Mbrojtja nga lumi Drin ne Juban”, ne seksionin I, udhezime per Operatoret Ekonomike, ne piken A/2 b) percaktohet se: *“b) “Operatori Ekonomik duhet të konsultohet me të gjitha udhëzimet, formularët, termat dhe specifikimet në Dokumentet e Tenderit. Mosdhënia nga operatori ekonomik e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Dokumentet e Tenderit, do të cojë në refuzimin e Ofertës”*.

Ndersa ne dokumentat standarte te tenderit te procedures se prokurimit me objekt: “Mbrojtja nga lumi Drin ne Juban”, ne seksionin I, udhezime per Operatoret Ekonomike, ne piken B/4 percaktohet se: *“Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar”*.

Po ashtu ne dokumentat standarte te tenderit te procedures se prokurimit me objekt: “Mbrojtja nga lumi Drin ne Juban”, ne seksionin I, udhezime per Operatoret Ekonomike, ne piken B/10 *“Formati dhe nenshkrimi i ofertes”, percaktohet se: “Në përgjigje të Njoftimit të Kontratës, cdo Operator Ekonomik paraqet ofertën sipas formularëve standard në këtë DT. Oferta nënshkruhet nga personi/personat përgjegjës të autorizuar për këtë qëllim”*.

Gjithashtu ne shtojcen nr. 2 (Lista e çmimeve sipas zerave te preventivit) eshte percaktuar se *“Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertes”*

Nga verifikimi ne SPE, verehet se OE ka paraqitur nje preventiv oferte i cili nuk permban asnje nga elementet apo deklarimet e parashikuara ne Shtojcen nr. 2 te DST-se.

Po ashtu verehet se shtojca nr. 2 (Lista e çmimeve sipas zerave te preventivit) e paraqitur nga operatori ekonomik nuk permban asnje nga zerat e preventivit por vetem nje cmim total te ofertes informacion i cili paraqitet ne shtojcen nr. 1.

KVO nenvizon se formulimi i shtojcave dhe deklaratave te miratuara nga ligjvendi ne DST-ne e kesaj procedure eshte bere per faktin se te gjithë operatoret ekonomike te deklarojne me pergjegjesi te plote

sipas formatit të miratuar, duke mos lene asnje mundesi shmangie nga deklarimet apo pergjegjesite qe marrin operatorët me ane ate ketyre deklarimeve.

Per me teper verehet se edhe Komisioni i Prokurimit Publik ka mbajtur te njejtin qendrim ne lidhje me plotesimin e shtojcave, me vendimin nr. 210/2020, ku thekson se: *“Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik., ka ndryshuar përmbajtjen e shtojcës 3 “Formular i Sigurimit të Ofertës”, duke dorëzuar një “Formular” me përmbajtje të ndryshme nga ajo e përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi, duke shtuar rastin e mospërmbushjes së një kushti Ofertuesi ka dorëzuar një ofertë të pa përgjegjshme, i cili nuk është parashikuar në shtojcën e hartuar nga autoriteti kontraktor. Kjo bie në kundërshtim me kreun II “UDHËZIME PËR OPERATORËT EKONOMIKË”, seksioni 1 “Hartimi i ofertës”, pika 1.1 të dokumenteve të procedurës së prokurimit në të cilën është parashikuar se “Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.” Gjithashtu, vlen të theksojmë se, dokumentat standarte të tenderit, janë dokumenta, që autoriteti kontraktor ua vë në dispozicion kandidatëve dhe ofertuesve të mundshëm për përgatitjen e ofertave. Në hartimin e këtyre dokumenteve, autoriteti kontraktor duhet të përdorë dokumentat standarde të tenderit. Rrjedhimisht, që nga data kur ka hyrë në fuqi vendimi për miratimin e ndryshimeve të dokumentave të tenderit, të gjitha procedurat e prokurimit do të shpallen nga autoritetet kontraktore sipas setit të ri të dokumentave standarde të tenderit, të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, të cilat janë të detyrueshme për tu zbatuar si nga ana e autoritetit kontraktor ashtu edhe nga operatorët ekonomikë të cilët marrin pjesë në një procedurë prokurimi publik”.*

Nisur sa me lart, KVO duke marre ne konsiderate udhezimet per operatorët ekonomike ne DST-se dhe vendimin nr. 210/2020 te KPP-se, thekson se ne kete rast jemi përballë mosplotësimi në formën e duhur të një shtojce e cila është pjesë përbërëse e dokumentave të procedurës së prokurimit dhe është e detyrueshme që të plotësohet sipas formatit të miratuar nga organet ligjzbatuese, pasi mosdhënia nga operatori ekonomik e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në Dokumentet e Tenderit, rrjedhimisht do të çojë në refuzimin e Ofertës

Se treti, Bashkimi i operatoreve ekonomik ka paraqitur Kontraten e Bashkepunimit me date 06.07.2023, lidhur midis shoqerise “LIS KONSTRUKSION” Shpk dhe shoqerise “VIANTE KONSTRUKSION” Shpk, per krijimin e bashkimit te perkohshem te shoqerive me qellimin e pjesemarrjes ne proceduren e prokurimit me objekt: “Mbrojtja nga Lumi Drin ne Juban”.

Nga shqyrtimi i ketij dokumenti “Kontrate Bashkepunimi”, konstatohet se ne Nenin 4 te kesaj kontrate, palet kane rene dakort qe perqindja e pjesemarrjes per realizimin e Objektit te mesiperem te jete konkretisht:

-Shoqëria “LIS KONSTRUKSION” shpk do të kontribuojë në masën 68.3%, në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indekset perkatese, te gjitha zerat e punimeve.

-Shoqëria “VIANTE KONSTRUKSION” shpk, do të kontribuojë në masën 31.7 %, në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indekset perkatese, te gjitha zerat e punimeve.

Sa me siper KVO mori ne shqyrtim indekset perkatese bashkengjitur Kontrates se Bashkepunimit per verifikimin e ndarjes se zerave te punimeve midis anetareve te Bashkimit te Perkohshem ku verehet



se preventivi mbi ndarjen e punimeve rezulton i pa nenshkuar nga te dy drejtuesit ligjor te operatoreve ekonomik pjese te ketij bashkimi.

KVO, mban ne konsiderate se ne nenin 88, te VKM-se Nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se; “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve”.

Gjithashtu KVO thekson se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Nuk mund të lejohet kualifikimi i një operatori ekonomik në rast se ai ka mungesë fizike dokumentacioni dhe nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga vetë autoriteti kontraktor.

Sa me siper marreveshja e bashkepunimit duhet te nenshkuhet nga dy drejtuesit ligjor te anetareve pjese te ketij bashkimi edhe ndarja e punimeve e cila eshte pjese e pandashme e marreveshjes se bashkepunimit duhet te nenshkuhet nga te dy drejtuesit ligjor te ketyre anetareve pjese te bashkimit, pasi ne ndarjen e punimeve cdo operator merr persiper detyrime per realizimin e punimeve.

Në rastin konkret objekti i prokurimit përfshin punë publike, e cila ndarja e zërave të këtyre punimeve është tepër e rëndësishme, pasi ndarja e tyre për secilin anëtar të bashkimit të përkohshëm të shoqërive është një faktor i rëndësishëm mbi të cilin autoriteti kontraktor bën verifikimin dhe shqyrtimin e përmbushjes së secilit kriter të përcaktuar në dokumentat e tenderit, me dokumentacionin e paraqitur nga ana e operatorit ekonomik, gjithnjë në përputhje me përqindjen e marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.

KVO mban ne konsiderate se marreveshja e bashkepunimit dhe ndarja e punimeve per secilin anetar te ketij bashkimi percakton detyrime dhe pergjegjesi per secilin anetar prandaj eshte e detyrueshme te nenshkuhet nga secili anetar pasi ne te kundert eshte e pavlefshme.

Se katerti, Komisioni i Vleresimit te Ofertave veren se oferta e paraqitur nga OE nese nuk do te skualifikohet eshte anomalisht e ulet, pasi ky BOE ka paraqitur oferte me te ulet se 83.2 % e mesatares se ofertave (te kualifikuara), si dhe per KVO-ne, kjo anomali verehet e dyshimte (e papergjegjshme) duke qene se çmimet e materialeve te ndertimit kane pesuar nje rritje te konsiderueshme ne treg.

KVO thekson se bazuar ne piken 4, te nenit 82, te VKM-se Nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se;

- “Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:*
- *Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;*

- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

KVO verën se edhe Komisioni i Prokurimit Publik ka mbajtur te njetin qendrim në vendimin nr. 149/2021 ku ka theksuar se: “K.P.P gjykon se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riksut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. K.P.P gjykon se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si:

- rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur;
- rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i linden autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara;
- humbjet që mund të pësojë në kohë nga mos kryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të mos zbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët”

Megjithatë, duke qenë se Operatori Ekonomik rezultoi i skualifikuar për arsyet e mësipërme, KVO, vendosi të mos kerkojë sqarim nga ofertuesi meqenese pozitat e BOE-se nuk ndryshojne.

Sa me sipër Komisioni i Vleresimit të Ofertave mbështetur në nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e BOE “LIS KONSTRUKSION” SH.P.K & “VIANTE Konstruktion” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, BOE “LIS KONSTRUKSION” SH.P.K me nipt K66613407H & “VIANTE Konstruktion” SH.P.K me nipt K47103804L, skualifikohet.

V. Bashkimi i operatoreve ekonomike “LODI CONSTRUCTION” SH.P.K, me nipt L77127002 & “ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCTION” me nipt K91326028I,

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE, rezulton se:

Se pari, nuk ploteson kriterin 2.3.12, te kushteve te veçanta te kualifikimit ku parashikohet se: *“Operatori ekonomik ne rast se nuk eshte prodhues duhet te paraqese kontrat e furnizimit per materialet si me poshte:*

*2.3.12/2 Per rrjete teli Gabion.*

*- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar”.*

Komisioni i Vleresimit te Ofertave veren se per permbushjen e ketij kriteri operatoret ekonomike ne rast se nuk jane prodhues duhet te paraqesin per “*rrjete teli Gabion*” kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Nga verifikimi ne SPE rezulton se operatori ekonomik ka nenshkruar kontrate furnizimi per “*rrjete teli Gabion*”, me nje subjekt i cili nuk rezulton te jete prodhues, si dhe nuk ka paraqitur per furnizuesin autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis tij dhe prodhuesit

KVO duke pasur ne konsiderate se te gjithë prodhuesit e kane detyrim ligjor pajisjen me leje mjedisore nga QKL, beri nje kerkim ne faqen zyrtare qkb.gov.al, ku rezultoi se furnizuesi per *rrjete teli Gabion* nuk disponon QKL si prodhues.

Per me teper KVO gjithashtu thekson se nga verifikimi nje verifikim i thjeshte te ekstraktit te QKB-se, rezulton se furnizuesi ka si objekt te veprimtarise te tij: *“Tregetimi i materialeve te ndertimit, prodhim perpunim lende drusore, Grumbullim dhe shitje skrap, Transport per vete dhe te trete Brenda dhe jashte shtetit, blerje dhe shitje inertesh. Qymyr koks dhe Qymyr natyral. Tregtim me shumive dhe pakive te fruta perime, dhe atomjete import eksport te tyre. Ndertim i ndertesave rezidenciale dhe jo rezidenciale”.*

Sa me siper subjekti me te cilin operatori ekonomik ka nenshkruar kontrate furnizimi nuk ka si objekt veprimtarie prodhim rrjete teli Gabion por shitje materiale ndertimi, prodhimi lende drusore, transport, fruta perime etj.

KVO mban ne konsiderate se Komisioni i Prokurimit Publik ne vendimin nr. 825/2021 nder te tjera thekson se per te permbushur qellimin e vendosjes se kriterit duhet te parashikohen forma apo dokumentacione alternative provuese te cilat vertetojne lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit te autorizuar nga prodhuesi.

Gjithashtu KPP ka mbajtur te njejtin qendrim edhe ne vendimin nr. 604/2019 ne te cilin thekson se : *-“KPP gjykon se mungesa e dokumentit autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar nga prodhuesi nga kompanitë ADINNOL”, ”CHAMPION”, “RAVENOL”, “CASTROL”, “MOTUOL”,*



*“CYCLO” dhe “CHIMITEX, për të cilat janë paraqitur katalogë teknikë bën që dokumentacioni i paraqitur nga ankimuesi të mos jetë i plotë për përmbushjen e kriterëve kualifikuese të përcaktuara në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Në rastin konkret nuk krijohet bindja mbi origjinalitetin e disa prej produkteve objekt prokurimi pasi për to janë paraqitur vetëm katalogë të prodhuesve të ndryshëm nga të cilët ankimuesi nuk ka asnjë autorizim apo dokument që të provojë lidhjen mes tyre”*

*- “KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto rrethana, KPP gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga “Alstezo” sh.p.k. nuk është i plotë dhe i saktë dhe nuk krijon bindjen mbi origjinalitetin për një pjesë të mallrave objekt prokurimi”.*

Sa me sipër duke qenë se furnizuesi për rrjetë teli gabion nuk disponon QKL si prodhues, si dhe duke qenë se nuk ka paraqitur për furnizuesin autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis tij dhe prodhuesit ky kriter konsiderohet i papermbushur.

Se dyti, nuk plotëson kriterin 2.3.12, të kushteve të veçanta të kualifikimit ku parashikohet se: *“Operatori ekonomik në rast se nuk është prodhues duhet të paraqesë kontratë e furnizimit për materialet si më poshtë:*

#### *2.3.12/1 Per Hekurin*

*- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar”.*

Komisioni i Vleresimit të Ofertave vëren se për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomikë në rast se nuk janë prodhues duhet të paraqesin për *“hekurin”* kontratë paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar

Nga verifikimi në SPE rezulton se operatori ekonomik ka nënshkruar kontratë furnizimi për *hekurin*, me një subjekt i cili nuk rezulton të jetë prodhues, si dhe nuk ka paraqitur për furnizuesin autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis tij dhe prodhuesit

KVO duke pasur në konsideratë se të gjithë prodhuesit e kanë detyrim ligjor pajisjen me leje mjedisore nga QKL, bëri një kërkim në faqen zyrtare [qkb.gov.al](http://qkb.gov.al), ku rezultoi se furnizuesi për *hekurin* nuk disponon QKL si prodhues.

Për më tepër KVO, gjithashtu thekson se nga një verifikim i thjeshtë të ekstraktit të QKB-se rezulton e furnizuesi ka si objekt veprimtarie si: *“Tregtimi i materialeve të ndertimit, prodhim perpunim lende drusore, Grumbullim dhe shitje skrap, Transport për vete dhe të tjerë Brenda dhe jashtë shtetit, blerje dhe shitje inertesh, Qymyr koks dhe Qymyr natyral. Tregtim me shumicë dhe pakicë të fruta perime, dhe atomjete import eksport të tyre. Ndertim i ndertesave rezidenciale dhe jo rezidenciale”.*

Sa me sipër subjekti me të cilin operatori ekonomik ka nënshkruar kontratë furnizimi nuk ka si objekt veprimtarie prodhim hekuri por shitje materiale ndertimi, prodhimi lende drusore, transport, fruta perime etj.

KVO mban në konsideratë se Komisioni i Prokurimit Publik në vendimin nr. 825/2021 ndër të tjera thekson se për të përmbushur qëllimin e vendosjes së kriterit duhet të parashikohen forma apo dokumentacione alternative provuese të cilat vertetojnë lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit të autorizuar nga prodhuesi.

Gjithashtu KPP ka mbajtur të njëjtin qëndrim edhe në vendimin nr. 604/2019 në të cilin thekson se :  
-“KPP gjykon se mungesa e dokumentit autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar nga prodhuesi nga kompanitë ADINNOL”, ”CHAMPION”, “RAVENOL”, “CASTROL”, “MOTUOL”, “CYCLO” dhe “CHIMITEX, për të cilat janë paraqitur katalogë teknikë bën që dokumentacioni i paraqitur nga ankimuesi të mos jetë i plotë për përmbushjen e kriterëve kualifikuese të përcaktuara në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Në rastin konkret nuk krijohet bindja mbi origjinalitetin e disa prej produkteve objekt prokurimi pasi për to janë paraqitur vetëm katalogë të prodhuesve të ndryshëm nga të cilët ankimuesi nuk ka asnjë autorizim apo dokument që të provojë lidhjen mes tyre”

-“KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto rrethana, KPP gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga “Alstezo” sh.p.k. nuk është i plotë dhe i saktë dhe nuk krijon bindjen mbi origjinalitetin për një pjesë të mallrave objekt prokurimi”.

Sa me sipër duke qenë se furnizuesi për hekurin nuk disponon QKL si prodhues, si dhe duke qenë se nuk ka paraqitur për furnizuesin autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose çdo dokument tjetër që provon lidhjen midis tij dhe prodhuesit ky kriter konsiderohet i papërmbushur.

Se treti, nuk ka paraqitur shtojcën nr. 2 (Lista e çmimeve sipas zerave të preventivit) e cila është një shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik, të parashikuar në DST, sipas formatit të mëposhtem:

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)  
LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT

Data: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): \_\_\_\_\_

Monedha: \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

#### Oferta ekonomike e detajuar

Nr	Nr. Analizë	Përshkrimi i Punëve	Njësi	Sasia	Çmimi/Njësi	Cmimi total
1.						
2.						
3.						
Shuma						
Fondi Rezervë						
Shuma						
TVSH						
SHUMA TOTAL						

Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_

Vula

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën \_\_\_\_ ( e kërkuar në dokumentat e tenderit )

KVO mban ne konsiderate se ne nenin 14, te VKM-se Nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, parashikohet se: “APP-ja harton dhe miraton me vendim formatin e dokumenteve standarde të tenderit që do të përdoren gjatë procedurave të prokurimit, për çdo lloj procedure prokurimi sipas nenit 41, të LPP-së, dhe çdo tip kontrate”.

Po ashtu KVO mban ne konsiderate se formati i i shtojce nr.2, per procedurat e prokurimit “E hapur / Pune” eshte miratuar me vendimin nr. 10, date 05.10.2022 “Per miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve ne dokumentat standarte te tenderit per mallra, pune, sherbime per proceduren e

prokurimit “Procedure e Hapur”, dhe ne vendimin nr. 02, date 09.06.2021 “Per miratimin e dokumentave standarte te tenderit per mallra, pune, sherbime per proceduren e prokurimit “Procedure e Hapur” dhe asnje autoritet kontraktor apo operator ekonomik nuk mund te modifikojë apo te ndryshojë formularët e miratuar ne DST.

KVO konstaton se ne dokumentat standarte te tenderit te procedures se prokurimit me objekt “Mbrotjtja nga lumi Drin ne Juban”, ne seksionin I, udhezime per Operatoret Ekonomike, ne piken A/2 b) percaktohet se “b) “Operatori Ekonomik duhet të konsultohet me të gjitha udhëzimet, formularët, termat dhe specifikimet në Dokumentet e Tenderit. Mosdhënia nga operatori ekonomik e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Dokumentet e Tenderit, do të çojë në refuzimin e Ofertës”.

Ndersa ne dokumentat standarte te tenderit te procedures se prokurimit me objekt “Mbrotjtja nga lumi Drin ne Juban”, ne seksionin I, udhezime per Operatoret Ekonomike, ne piken B/4 percaktohet se “Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar”. Po ashtu ne dokumentat standarte te tenderit te procedures se prokurimit me objekt “Mbrotjtja nga lumi Drin ne Juban”, ne seksionin I, udhezime per Operatoret Ekonomike, ne piken B/10 “Formati dhe nenshkrimi i ofertes”, percaktohet se “Në përgjigje të Njoftimit të Kontratës, cdo Operator Ekonomik paraqet ofertën sipas formularëve standard në këtë DT. Oferta nënshkruhet nga personi/personat përgjegjës të autorizuar për këtë qëllim”.

Gjithashtu ne shtojcen nr. 2 (Lista e çmimeve sipas zerave te preventivit) eshte percaktuar se “Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës”

Nga verifikimi ne SPE, verehet se OE ka paraqitur nje preventiv oferte i cili nuk permban asnje nga elementet apo deklarimet e parashikuara ne Shtojcen nr. 2 te DST-se.

Po ashtu verehet se shtojca nr. 2 (Lista e çmimeve sipas zerave te preventivit) e paraqitur nga operatori ekonomik nuk permban asnje nga zerat e preventivit por vetem nje cmim total te ofertes informacion i cili paraqitet ne shtojcen nr. 1.

KVO nenvizon se formulimi i shtojcave dhe deklaratave te miratuara nga ligjvensi ne DST-ne e kesaj procedure eshte bere per faktin se te gjithë operatoret ekonomike te deklarojne me pergjegjesi te plote sipas formatit te miratuar, duke mos lene asnje mundesi shmangie nga deklarimet apo pergjegjesite qe marrin operatoret me ane ate ketyre deklarimeve.

Per me teper verehet se Komisioni i Prokurimit Publik ka mbajtur te njejtin qendrim ne lidhje me plotesimin e shtojcave ne vendimin nr. 210/2020 ku thekson se: “Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik., ka ndryshuar përmbajtjen e shtojcës 3 “Formular i Sigurimit të Ofertës”, duke dorëzuar një “Formular” me përmbajtje të ndryshme nga ajo e përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi, duke shtuar rastin e mospërmbushjes së një kushti Ofertuesi ka dorëzuar një ofertë të pa përgjegjshme, i cili nuk është parashikuar në shtojcën e hartuar nga autoriteti kontraktor. Kjo bie në kundërshtim me kreun II “UDHËZIME PËR OPERATORËT EKONOMIKË”, seksioni 1 “Hartimi i ofertës”, pika 1.1 të dokumenteve të

*procedurës së prokurimit në të cilën është parashikuar se “Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.” Gjithashtu, vlen të theksojmë se, dokumentat standarte të tenderit, janë dokumenta, që autoriteti kontraktor ua vë në dispozicion kandidatëve dhe ofertuesve të mundshëm për përgatitjen e ofertave. Në hartimin e këtyre dokumenteve, autoriteti kontraktor duhet të përdorë dokumentat standarde të tenderit. Rrjedhimisht, që nga data kur ka hyrë në fuqi vendimi për miratimin e ndryshimeve të dokumentave të tenderit, të gjitha procedurat e prokurimit do të shpallen nga autoritetet kontraktore sipas setit të ri të dokumentave standarde të tenderit, të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, të cilat janë të detyrueshme për tu zbatuar si nga ana e autoritetit kontraktor ashtu edhe nga operatorët ekonomikë të cilët marrin pjesë në një procedurë prokurimi publik”.*

Nisur sa me lart, KVO duke marre ne konsiderate udhezimet per operatoret ekonomike ne DST-se dhe vendimin nr. 210/2020 te KPP-se, thekson se ne kete rast jemi permballë mosplotësisimit në formën e duhur të një shtojce e cila është pjesë përbërëse e dokumentave të procedurës së prokurimit dhe është e detyrueshme që të plotësohet sipas formatit të miratuar nga organet ligjzbatuese, pasi mosdhënia nga operatori ekonomik e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në Dokumentet e Tenderit, rrjedhimisht do të çojë në refuzimin e Ofertës.

Se katerti, KVO veren se per te permbushur kriterin 2.3.1 anetari i bashkimit “LODI CONSTRUCTION” SH.P.K ka paraqitur kontrate fotokopje per objektin: “Rehabilitim i Kanalit KU-13, Shelqet, Vau Dejes”.

KVO thekson se ne dokumentat standarte te tenderit per kete procedure prokurimi eshte kerkuar qe “Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim”.

Sa me siper puna e ngjashme e me objekt: “Rehabilitim i Kanalit KU-13, Shelqet, Vau Dejes” e paraqitur nga OE “LODI CONSTRUCTION” SH.P.K nuk eshte ne perputhje me kriteret e vecanta te kualifikimit, ndersa puna tjeter e ngjashme e paraqitur nga ky OE me objekt “Ndertim ure B/A ne fshatin Troshan Lezhe” me vlere punimesh 7,818,720 leke me TVSH, nuk permbushin plotesimin e kriterit per pervojen e meparshme te ngjashme.

Se pesti, Bashkimi i operatoreve ekonomik ka paraqitur preventivin mbi ndarjen e punimeve te pa nenshkruar nga dy drejtuesit ligjor te operatoreve ekonomik pjese te ketij bashkimi.

KVO, mban ne konsiderate se ne nenin 88 te VKM-se 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se; “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve”.

Sa me siper marreveshja e bashkepunimit duhet te nenshkruhet nga dy drejtuesit ligjor te anetareve pjese te ketij bashkimi edhe ndarja e punimeve e cila eshte pjese e pandashme e marreveshjes se bashkepunimit duhet te nenshkruhet nga te dy drejtuesit ligjor ketyre anetareve pjese te bashkimit, pasi ne ndarjen e punimeve cdo operator merr persiper detyrime per realizimin e punimeve.



KVO mban ne konsiderate se marreveshja e bashkepunimit dhe ndarja e punimeve per secilin anetar te ketij bashkimi percakton detyrime dhe pergjegjesi per secilin anetar prandaj eshte e detyrueshme te nenshkruhet nga secili anetar pasi ne te kundert eshte e pavlefshme.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, te ligjit nr. 162/2020 "Per prokurimin publik", ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore percaktojne kerkesat per kualifikim per operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore percaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe ne në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", ku parashikohet: "Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji", vendosi te refuzoje oferten e BOE "LODI CONSTRUCTION" SH.P.K & "ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCTION", per mos permbushje te kriterëve te vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", BOE "LODI CONSTRUCTION" SH.P.K me nipt L77127002 & "ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCTION" me nipt K91326028I, *skualifikohet*.

VI. Bashkimi i Operatoreve Ekonomik "NDERTUESI 2014" SH.P.K, me nipt L46827004L & "UDHA" SH.P.K, me nipt K77524909Q,

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE, rezulton se:

Se pari, Bashkimi i Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur ndarjen e punimeve sipas zerave te preventivit, pasi në marrëveshjen e bashkëpunimit te paraqitur ne SPE nga ky BOE nuk rezulton ndarja e zërave dhe elementëve konkretë të punimeve që do të realizojë secili prej tyre.

KVO sqaron se per te permbushur kete kriter Bashkimi i Operatoreve Ekonomik duhet te paraqese kontraten e bashkepunimit te shoqeruar me preventivin me ndarje konkrete te zërave të punimeve objekt prokurimi per secilin OE.

KVO mban ne konsiderate parashikimet ligjore te nenit 88, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar ku parashikohet se: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve”*.

Po ashtu KVO, mban ne konsiderate se edhe Komisioni i Prokurimit Publik ne vendimin nr. 477/2020, ka theksuar se: *“Komisioni sqaron se ndarja e zërave konkretë është një kërkesë e parashikuar në aktin normativ si më sipërcituar dhe është një faktor i rëndësishëm mbi të cilin autoriteti kontraktor bën verifikimin dhe shqyrtimin e përmbushjes së secilit kriter të përcaktuar në dokumentat e tenderit, me dokumentacionin e paraqitur nga ana e operatorit ekonomik, gjithnjë në përputhje me përqindjen e marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit. Në rastin konkret është përcaktuar vetëm përqindja e pjesmarrjes në bashkëpunim për secilin nga anëtarët e bashkimit, por në marrëveshjen e bashkëpunimit nuk rezulton ndarja e zërave dhe elementëve konkretë të punimeve që do të realizojë secili prej tyre. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, për vërtetimin e krijimit të bashkimit dhe konkretisht kontrata e bashkëpunimit në të cilën nuk është bërë ndarja konkrete e zërave të punimeve objekt prokurimi, nuk është hartuar në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, duke bërë të pamundur verifikimin e plotësisht të dokumentacionit të paraqitur nga secili anëtar i këtij bashkimi në përputhje me përqindjen e marrë përsipër.*

*Per KPP-ne vlen të theksohet se, forma e pjesmarrjes në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi është e përcaktuar shprehimisht në ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të saj dhe nuk lë vend për konfuzion. Në këtë kuptim KPP gjykon se BOE ankimues ka pasur detyrimin ligjor të paraqesë kontratën e bashkëpunimit, preventivin në përputhje me përcaktimet ligjore duke përcaktuar në të pjesën e punës që do të realizojë secili prej tyre në përputhje me përqindjen e përcaktuar në kontratë, dhe që më pas referuar këtyre elementëve dhe zërave konkretë të marrë përsipër nga secili, të bëhej shqyrtimi dhe vlerësimi i kapaciteteve ekonomiko financiare dhe teknike”*.

Se dyti, nuk ploteson kriterin 2.3.12, te kushteve te veçanta te kualifikimit ku parashikohet se: *“Operatori ekonomik ne rast se nuk eshte prodhues duhet te paraqese kontrat e furnizimit per materialet si me poshte:*

*2.3.12/2 Per rrjete teli Gabion.*

*- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar”*.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave veren se per permbushjen e ketij kriteri operatoret ekonomike ne rast se nuk jane prodhues duhet te paraqesin per *“rrjete teli Gabion”*, kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar

Nga verifikimi ne SPE rezulton se operatori ekonomik ka nenshkuar kontrate furnizimi per *rrjete teli gabion*, me nje subjekt i cili nuk rezulton te jete prodhues, pasi KVO duke pasur ne konsiderate se te gjithë prodhuesit e kane detyrim ligjor pajisjen me leje mjedisore nga QKL, beri nje kerkim ne faqen zyrtare qkb.gov.al, ku rezultoi se furnizuesi per *rrjete teli gabion*, nuk disponon QKL si prodhues.

Po ashtu duke se furnizuesi nuk rezulton te jete prodhues, KVO veren se OE nuk ka paraqitur per furnizuesin autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër qe provon lidhjen midis tij dhe prodhuesit.

KVO mban ne konsiderate se Komisioni i Prokurimit Publik ne vendimin nr. 825/2021 nder te tjera thekson se per te permbushur qellimin e vendosjes se kriterit duhet te parashikohen forma apo dokumentacione alternative provuese te cilat vertetojne lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit te autorizuar nga prodhuesi.

Gjithashtu KPP ka mbajtur te njejtin qendrim edhe ne vendimin nr. 604/2019 ne te cilin ka theksuar se : - *“KPP gjykon se mungesa e dokumentit autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar nga prodhuesi nga kompanitë ADINNOL”, ”CHAMPION”, “RAVENOL”, “CASTROL”, “MOTUOL”, “CYCLO” dhe “CHIMITEX, për të cilat janë paraqitur katalogë teknikë bën që dokumentacioni i paraqitur nga ankimuesi të mos jetë i plotë për përmbushjen e kriterëve kualifikuese të përcaktuara në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Në rastin konkret nuk krijohet bindja mbi origjinalitetin e disa prej produkteve objekt prokurimi pasi për to janë paraqitur vetëm katalogë të prodhuesve të ndryshëm nga të cilët ankimuesi nuk ka asnjë autorizim apo dokument që të provojë lidhjen mes tyre”*

- *“KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto rrethana, KPP gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga “Alstezo” sh.p.k. nuk është i plotë dhe i saktë dhe nuk krijon bindjen mbi origjinalitetin për një pjesë të mallrave objekt prokurimi”.*

Sa me siper duke qene se furnizuesi per *rrjete teli gabion* nuk disponon QKL si prodhues, si dhe duke qene se nuk ka paraqitur per furnizuesin autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër qe provon lidhjen midis tij dhe prodhuesit ky kriter konsiderohet i papermbushur.

Se treti, nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE, rezulton se oferten e Bashkimit te Operatoreve Ekonomike “NDERTUESI 2014” SH.P.K & “UDHA” SH.P.K, ka nderhyrje ne oferte sipas percaktimeve te nenit 81/2 dhe 90/7, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar.

KVO mban ne kosiderate se ne nenin 90/7, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar parashkiohet se:

*“Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit. Subjekti mbështetës nuk mund të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi”.*



Po ashtu KVO mban ne konsiderate se ne nenin 81/2, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

*“1. Pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një ofertë, tek e tek ose me një ofertues tjetër, do të rezultojë në përjashtimin nga procesi të të gjitha ofertave, në të cilat është përfshirë ofertuesi.*

*2. Ndërhyrje në ofertë do të konsiderohet edhe pjesëmarrja e dy ose më shumë ofertuesve me të njëjtin ortak dhe/ose administrator në të njëjtën procedurë prokurimi.*

*3. Autoriteti/enti kontraktor vlerëson rast pas rasti nëse konstaton të dhëna të tilla, që mund të shërbejnë si tregues për ndërhyrje në oferta nga ana e operatorëve ekonomikë ofertues.*

Sa parashtruar me siper nga verifikimi i Formulareve Permbledhes te Vetedeklarimit te paraqitur ne SPE, KVO konstaton se OE “GPG COMPANY” SH.P.K eshte subjekt mbeshtetes per BOE “NDERTUESI 2014 SH.P.K” & “UDHA” SH.P.K, dhe ka paraqitur formularin permbledhes te vetedeklarimit ne te cilin deklaron se: *“Ofroj mbeshtetje per kategoria e punimeve qe perfshin kategoria NS-18 – PUNIME TOPOGRAFIKE duke perfshire kapacitetet qe jane te nevojshme per kete kategori punimesh”.*

Po ashtu KVO konstaton se OE “GPG COMPANY” SH.P.K eshte nje nga anetaret e Bashkimit te Operatoreve Ekonomike “SMO VATAKSI” SH.P.K & “GPG COMPANY” SH.P.K, i cili ka ofertuar ne kete procedure prokurimi dhe per rrjedhoje jane ne kushtet shkeljes se nenit 81/2 dhe 90/7, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar.

Per sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave bazuar nenin 81/2 dhe 90/7, te VKM-se nr.285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar, vendosi te mos marre ne shqyrtimi oferten e paraqitur nga BOE “NDERTUESI 2014 SH.P.K” & “UDHA” SH.P.K, si dhe vendosi *përjashtimin nga procesi* per nderhyrje ne oferte pasi Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit.

*- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar”.*

Komisioni i Vleresimit te Ofertave veren se per permbushjen e ketij kriteri operatoret ekonomike ne rast se nuk jane prodhues duhet te paraqesin per *“rrjete teli Gabion”* kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar

Nga verifikimi ne SPE rezulton se operatori ekonomik ka nenshkruar kontrate furnizimi per *rrjete teli gabion*, me nje subjekt i cili nuk rezulton te jete prodhues.

KVO duke pasur ne konsiderate se te gjithë prodhuesit e kane detyrim ligjor pajisjen me leje mjedisore nga QKL, beri nje kerkim ne faqen zyrtare qkb.gov.al, ku rezultoi se furnizuesi per *rrjete teli gabion* nuk disponon QKL si prodhues.

Po ashtu, KVO veren se OE nuk ka paraqitur per furnizuesin autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis tij dhe prodhuesit.

KVO mban ne konsiderate se Komisioni i Prokurimit Publik ne vendimin nr. 825/2021 nder te tjera thekson se per te permbushur qellimin e vendosjes se kriterit duhet te parashikohen forma apo dokumentacione alternative provuese te cilat vertetojne lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit te autorizuar nga prodhuesi.

Gjithashtu KPP ka mbajtur te njejtin qendrim edhe ne vendimin nr. 604/2019 ne te cilin thekson se :  
*-“KPP gjykon se mungesa e dokumentit autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar nga prodhuesi nga kompanitë ADINNOL”, ”CHAMPION”, “RAVENOL”, “CASTROL”, “MOTUOL”, “CYCLO” dhe “CHIMITEX, për të cilat janë paraqitur katalogë teknikë bën që dokumentacioni i paraqitur nga ankimuesi të mos jetë i plotë për përmbushjen e kriterëve kualifikuese të përcaktuara në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Në rastin konkret nuk krijohet bindja mbi origjinalitetin e disa prej produkteve objekt prokurimi pasi për to janë paraqitur vetëm katalogë të prodhuesve të ndryshëm nga të cilët ankimuesi nuk ka asnjë autorizim apo dokument që të provojë lidhjen mes tyre”*

*-“KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto rrethana, KPP gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga “Alstezo” sh.p.k. nuk është i plotë dhe i saktë dhe nuk krijon bindjen mbi origjinalitetin për një pjesë të mallrave objekt prokurimi”.*



Sa me siper duke qene se furnizuesi per rrjete teli gabion nuk disponon QKL si prodhues, si dhe duke qene se nuk ka paraqitur per furnizuesin autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis tij dhe prodhuesit ky kriter konsiderohet i papermbushur.

Se dyti, nuk ka paraqitur shtojcen nr. 2 (Lista e çmimeve sipas zerave te preventivit) e cila eshte nje shtojce per tu praqitur nga operatori ekonomik, te parashikuar ne DST, sipas formatit te meposhtem:

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)  
LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT

Data: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): \_\_\_\_\_

Monedha: \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Oferta ekonomike e detajuar

Nr	Nr. Analizë	Përshkrimi i Punëve	Njësi	Sasia	Çmimi/ Njësi	Cmimi total
1.						
2.						
3.						
Shuma						
Fondi Rezervë						
Shuma						
TVSH						
SHUMA TOTAL						

Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_

Vula

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën \_\_\_\_ ( e kërkuar në dokumentat e tenderit )

KVO mban ne konsiderate se ne nenin 14, te VKM-se Nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” parashikohet se “APP-ja harton dhe miraton me vendim formatin e dokumenteve standarde të tenderit që do të përdoren gjatë procedurave të prokurimit, për çdo lloj procedure prokurimi sipas nenit 41, të LPP-së, dhe çdo tip kontrate”.

Po ashtu KVO mban ne konsiderate se formati i shtojce nr. 2, per procedurat e prokurimit “E hapur / Pune” eshte miratuar me vendimin nr. 10, date 05.10.2022 “Per miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve ne dokumentat standarte te tenderit per mallra, pune, sherbime per proceduren e prokurimit “Procedure e Hapur”, dhe ne vendimin nr. 02, date 09.06.2021 “Per miratimin e dokumentave standarte te tenderit per mallra, pune, sherbime per proceduren e prokurimit “Procedure e Hapur” dhe asnje autoritet kontraktor apo operator ekonomik nuk mund te modifikojë apo te ndryshojë formularët e miratuar ne DST.

KVO konstaton se ne dokumentat standarte te tenderit te procedures se prokurimit me objekt “Mbrojtja nga lumi Drin ne Juban”, ne seksionin I, udhezime per Operatoret Ekonomike, ne piken A/2 b) percaktohet se “b) “Operatori Ekonomik duhet të konsultohet me të gjitha udhëzimet, formularët, termat dhe specifikimet në Dokumentet e Tenderit. Mosdhënia nga operatori ekonomik e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Dokumentet e Tenderit, do të çojë në refuzimin e Ofertës”.

Ndersa ne dokumentat standarte te tenderit te procedures se prokurimit me objekt “Mbrojtja nga lumi Drin ne Juban”, ne seksionin I, udhezime per Operatoret Ekonomike, ne piken B/4 percaktohet se “Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar”. Po ashtu ne dokumentat standarte te tenderit te procedures se prokurimit me objekt “Mbrojtja nga lumi Drin ne Juban”, ne seksionin I, udhezime per Operatoret Ekonomike, ne piken B/10 “Formati dhe nenshkrimi i ofertes”, percaktohet se “Në përgjigje të Njoftimit të Kontratës, cdo Operator Ekonomik paraqet ofertën sipas formularëve standard në këtë DT. Oferta nënshkruhet nga personi/personat përgjegjës të autorizuar për këtë qëllim”.

Gjithashtu ne shtojcen nr. 2 (Lista e çmimeve sipas zerave te preventivit) eshte percaktuar se “Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës”

Nga verifikimi ne SPE, verehet se OE ka paraqitur nje preventiv oferte i cili nuk permban asnje nga elementet apo deklarimet e parashikuara ne Shtojcen nr. 2 te DST-se.

Po ashtu verehet se shtojca nr. 2 (Lista e çmimeve sipas zerave te preventivit) e paraqitur nga operatori ekonomik nuk permban asnje nga zerat e preventivit por vetem nje cmim total te ofertes informacion i cili paraqitet ne shtojcen nr. 1.

KVO nenvizon se formulimi i shtojcave dhe deklaratave të miratuara nga ligjvendi në DST-ne e kesaj procedure është bere për faktin se të gjithë operatorët ekonomikë të deklarohen me përgjegjësi të plote sipas formatit të miratuar, duke mos lene asnjë mundësi shmangie nga deklaratimet apo përgjegjësitë që marrin operatorët me ane të këtyre deklaratimeve.

Per me teper verehet se Komisioni i Prokurimit Publik ka mbajtur të njëjtin qëndrim në lidhje me plotësimin e shtojcave në vendimin nr. 210/2020 ku thekson se: *“Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik, ka ndryshuar përmbajtjen e shtojcës 3 “Formular i Sigurimit të Ofertës”, duke dorëzuar një “Formular” me përmbajtje të ndryshme nga ajo e përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi, duke shtuar rastin e mospërmbushjes së një kushti Ofertuesi ka dorëzuar një ofertë të pa përgjegjshme, i cili nuk është parashikuar në shtojcën e hartuar nga autoriteti kontraktor. Kjo bie në kundërshtim me kreun II “UDHËZIME PËR OPERATORËT EKONOMIKË”, seksioni 1 “Hartimi i ofertës”, pika 1.1 të dokumenteve të procedurës së prokurimit në të cilën është parashikuar se “Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.” Gjithashtu, vlen të theksojmë se, dokumentat standarte të tenderit, janë dokumenta, që autoriteti kontraktor ua vë në dispozicion kandidatëve dhe ofertuesve të mundshëm për përgatitjen e ofertave. Në hartimin e këtyre dokumenteve, autoriteti kontraktor duhet të përdorë dokumentat standarde të tenderit. Rrjedhimisht, që nga data kur ka hyrë në fuqi vendimi për miratimin e ndryshimeve të dokumentave të tenderit, të gjitha procedurat e prokurimit do të shpallen nga autoritetet kontraktore sipas setit të ri të dokumentave standarde të tenderit, të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, të cilat janë të detyrueshme për tu zbatuar si nga ana e autoritetit kontraktor ashtu edhe nga operatorët ekonomikë të cilët marrin pjesë në një procedurë prokurimi publik”.*

Nisur sa me lart, KVO duke marrë në konsideratë udhëzimet për operatorët ekonomikë në DST-se dhe vendimin nr. 210/2020 të KPP-se, thekson se në këto rast jemi përballë mosplotësisimit në formën e duhur të një shtojce e cila është pjesë përbërëse e dokumentave të procedurës së prokurimit dhe është e detyrueshme që të plotësohet sipas formatit të miratuar nga organet ligjzbatuese, pasi mosdhënia nga operatori ekonomik e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në Dokumentet e Tenderit, rrjedhimisht do të çojë në refuzimin e Ofertës

Se treti, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verën se oferta e paraqitur nga OE nese nuk do të skualifikohej është anomalisht e ulët, pasi ky BOE ka paraqitur oferte me të ulët se 77 % e mesatares së ofertave (të kualifikuara), si dhe për KVO-ne, kjo anomali verehet e dyshimte (e papërgjegjshme) duke qene se çmimet e materialeve të ndertimit kanë pesuar një rritje të konsiderueshme në treg.

KVO thekson se bazuar në pikën 4, të nenit 82, të VKM-se 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se;

- “Pas korigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:*
- *Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;*
  - *Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.*

KVO veren se edhe Komisioni i Prokurimit Publik ka mbajtur te njetin qendrim ne vendimin nr. 149/2021 ku ka theksuar se: *“K.P.P gjykon se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riksut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. K.P.P gjykon se rrishtu që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si:*

*- rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur;*  
*- rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i linden autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara;*  
*- humbjet që mund të pësojë në kohë nga mos kryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të mos zbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët”*

Megjithate, duke qene se Operatori Ekonomik rezulton i skualifikuar per arsyet e mesiperme, KVO, vendosi te mos kerkoje sqarim nga ofertuesi meqenese pozitat e BOE-se nuk ndryshojne.

Se katerti, nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE, rezulton se Bashkimi i operatoreve ekonomike “SMO VATAKSI” SH.P.K & “GPG COMPANY” SH.P.K ka nderhyre ne oferte sipas percaktimeve te nenit 81/2 dhe 90/7, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar.

KVO mban ne kosiderate se ne nenin 90/7, te VKM-se nr.285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se: *“Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit.*

*Subjekti mbështetës nuk mund të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi”.*

Po ashtu KVO mban ne konsiderate se ne nenin 81/2, te VKM-se nr.285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“1.Pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një ofertë, tek e tek ose me një ofertues tjetër, do të rezultojë në përjashtimin nga procesi të të gjitha ofertave, në të cilat është përfshirë ofertuesi.*

*2. Ndërhyrje në ofertë do të konsiderohet edhe pjesëmarrja e dy ose më shumë ofertuesve me të njëjtin ortak dhe/ose administrator në të njëjtën procedurë prokurimi.*

*3. Autoriteti/enti kontraktor vlerëson rast pas rasti nëse konstaton të dhëna të tilla, që mund të shërbejnë si tregues për ndërhyrje në oferta nga ana e operatorëve ekonomikë ofertues.*

Nga verifikimi i Formulareve Permeledhes te Vetedeklarimit te paraqitur ne SPE, KVO konstaton se njeri nga anetaret e BOE konkretisht OE “GPG COMPANY” SH.P.K krahas paraqitjes se ofertes si bashkim operatoresh ekonomik eshte paraqitur edhe ne rolin e subjektit mbeshtetes per BOE “NDERTUESI 2014 SH.P.K” & “UDHA” SH.P.K, duke dorezuar formularin permeledhes te vetedeklarimit ne te cilin deklararon se: *“Ofroj mbeshtetje per kategoria e punimeve qe perfshin kategoria NS18 – PUNIME TOPOGRAFIKE duke perfshire kapacitetet qe jane te nevojshme per kete kategori punimesh”* per BOE “NDERTUESI 2014 SH.P.K” & “UDHA” SH.P.K dhe per rrjedhoje jane ne kushtet shkeljes se nenin 81/2 dhe 90/7, te VKM-se nr.285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar.

Per sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave bazuar nenin 81/2 dhe 90/7, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" i ndryshuar, vendosi te mos marre ne shqyrtimi oferten e paraqitur nga ky BOE, si dhe vendosi *perjashtimin nga procesi te Bashkimit te operatoreve ekonomik* "SMO VATAKSI" SH.P.K & "GPG COMPANY" SH.P.K per nderhyrje ne oferte pasi Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatoreve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", ku parashikohet: "Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji", vendosi te refuzoje oferten e BOE "SMO VATAKSI" SH.P.K & G.P.G. COMPANY, per mos përmbushje te kriterëve te vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", BOE "SMO VATAKSI" SH.P.K me nipt L47022001J & G.P.G. COMPANY me nipt J64324443V, *skualifikohet*.

XI. Operatori ekonomik "ULZA" SH.P.K me nipt J67902928O

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE, rezulton se:

Se pari, nuk ploteson kriterin 2.3.12, te kushteve te veçanta te kualifikimit ku parashikohet se *"Operatori ekonomik ne rast se nuk eshte prodhues duhet te paraqese kontrat e furnizimit per materialet si me poshte:*

*2.3.12/2 Per rrjete teli Gabion.*

*- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar".*



Komisioni i Vleresimit te Ofertave veren se per permbushjen e ketij kriteri operatoret ekonomike ne rast se nuk jane prodhues duhet te paraqesin per *“rrjete teli Gabion”* kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar

Nga verifikimi ne SPE rezulton se operatori ekonomik ka nenshkruar kontrate furnizimi per *rrjete teli gabion*, me nje subjekt i cili nuk rezulton te jete prodhues.

KVO duke pasur ne konsiderate se te gjithë prodhuesit e kane detyrim ligjor pajisjen me leje mjedisore nga QKL, beri nje kerkim ne faqen zyrtare qkb.gov.al, ku rezultoi se furnizuesi per *rrjete teli gabion* nuk disponon QKL si prodhues.

Po ashtu, KVO veren se OE nuk ka paraqitur per furnizuesin autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis tij dhe prodhuesit.

KVO mban ne konsiderate se edhe Komisioni i Prokurimit Publik ne vendimin nr. 825/2021 gjykon se per te permbushur qellimin e vendosjes se kriterit duhet te parashikohen forma apo dokumentacione alternative provuese te cilat vertetojne lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit te autorizuar nga prodhuesi.

Gjithashtu KPP ka mbajtur te njejtin qendrim edhe ne vendimin nr. 604/2019 ne te cilin thekson se :  
*-“KPP gjykon se mungesa e dokumentit autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar nga prodhuesi nga kompanitë ADINNOL”, “CHAMPION”, “RAVENOL”, “CASTROL”, “MOTUOL”, “CYCLO” dhe “CHIMITEX, për të cilat janë paraqitur katalogë teknikë bën që dokumentacioni i paraqitur nga ankimuesi të mos jetë i plotë për përmbushjen e kriterëve kualifikuese të përcaktuara në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Në rastin konkret nuk krijohet bindja mbi origjinalitetin e disa prej produkteve objekt prokurimi pasi për to janë paraqitur vetëm katalogë të prodhuesve të ndryshëm nga të cilët ankimuesi nuk ka asnjë autorizim apo dokument që të provojë lidhjen mes tyre”*

*-“KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto rrethana, KPP gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga “Alstezo” sh.p.k. nuk është i plotë dhe i saktë dhe nuk krijon bindjen mbi origjinalitetin për një pjesë të mallrave objekt prokurimi”.*

Sa me siper duke qene se furnizuesi per *rrjete teli gabion* nuk disponon QKL si prodhues, si dhe duke qene se nuk ka paraqitur per furnizuesin autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis tij dhe prodhuesit ky kriter konsiderohet i papermbushur.

Se dyti, nuk ploteson kriterin 2.3.12/1, te kushteve te veçanta te kualifikimit ku parashikohet se:  
*“Operatori ekonomik ne rast se nuk eshte prodhues duhet te paraqese kontrat e furnizimit per materialet si me poshte:*

### *2.3.12/1 Per Hekurin*

*- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë*

*autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar”.*

Komisioni i Vleresimit të Ofertave verën se për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomike në rast se nuk janë prodhues duhet të paraqesin për “*hekurin*” kontratë paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontratë furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar

Nga verifikimi në SPE rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur një autorizim nga prodhuesi në të cilin autorizohet të furnizohet me materiale në procedurat që mund të fitojë nga prokurimet publike që merr pjesë, por nuk ka paraqitur Kontratë paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar.

KVO thekson se në rastin konkret për të përmbushur këto kriter operatorët ekonomik duhet të paraqesë Kontratë paraprake furnizimi me prodhuesin dhe jo autorizim.

Sa me sipër Komisioni i Vleresimit të Ofertave mbështetur në nenin 77, pikë 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pikë 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “ULZA” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “ULZA” SH.P.K me nipt J67902928O, *skualifikohet*.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatoreve Ekonomik “EUROKOS HOLDING SH.P.K. DEGA NE SHQIPERI” & “ABI CONS” SH.P.K & “2Z KONSTRUKSION” SH.P.K, perfaqesuar nga OE “EUROKOS HOLDING SH.P.K. DEGA NE SHQIPERI”, me adrese Njesia Bashkiake Nr. 9, Bulevardi Zogu i I, Godina Nr. 2, Ap.7, Shk. 1, kati 3-te, Tirane, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 78,868,711.48 (shtatedhjete e tete milion e teteqind e gjashtedhjete e tete mije e shtateqind e njembdhjete pike dyzet e tete) lek pa tvsh është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

## **BASHKIA MALIQ**

Për : OPERATORIN EKONOMIK “ARTYKA II” shpk

-Adresa: Korçë, Bilisht, Rruga e Mirasit, Km.i.I, Pranë Ish Nyjes së Inerteve, Bilisht

-NIPT-I : K26625603U

Procedura e prokurimit: : Proçedure e Hapur /Punë/Sistem elektornik

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-72269-06-13-2023

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “ *Zhbllokimi i shkarkuesve dhe kanal ujëmbledhës*”

Afati i kontratës: 9 muaj

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.55 datë 19.06.2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik“INA” shpk + Mbeshtetes “2N” shpk

Operatori ekonomik“INA” shpk

-Adresa: Tirane,RrugaBesimImami, MyslymShyri,MbrapaKarburantit

- NIPTI: J61814009W

-Vlera e ofertës: 33,867,425(*tridhjetë e tre milion mije e teteqind e gjashtedhjete e shtate mije ë katerqind e njezet e pese ) leke pa tvsh*

Operatori Ekonomik “2N” shpk

-Adresa: Tirane Paskuqan Lagjja "PaskuqanFushe",Rruga "Demokracia", Pallati Nr.2, Kati i Pare

-NIPT-I :L31615017L



## 2. Operatori Ekonomik "NIKA" shpk

-Adresa: Shkodër, Lagjia Vasil Shanto, Bulevardi Skënderbeu, godina 8-katëshe, Kati I-rë, Zona kadastrale 8593, Nrpsaurie 5/587

-NIPT-I : J76705047U

-Vlera e ofertës: 36,899,530 (tridhjetë e gjashtë milion e teteqind e nentëdhjetë e nente mijë e pesëqind e tridhjetë) lekë pa tvsh

## 3. Operatori Ekonomik "ARTYKA II" shpk

-Adresa: Korce -Bilisht Rruga e Mirasit, Km.i I, Prane IshNyjes se Inerteve, Bilisht.

-NIPT-I : K26625603U

-Vlera e ofertës: 41,991,837 (dyzet e një milion e nentëqind e nentëdhjetë e një mijë e teteqind e tridhjetë e shtatë) leke pa tvsh

## 4. Bashkim Operatorësh Ekonomik "COLOMBO" shpk + "Rroku Guest" shpk

*"COLOMBO" shpk*

-Adresa: FIER Lagjia Kryengritja e Fierit, rruga Vangjel Rrushku, godina nr.67

-NIPT-I : J82916489E

*"Rroku Guest" shpk*

-Adresa: Shkoder, Rruga Nazmi Kryeziu, ndertesa 1/1, hyrja 2, Ap. 8, nrpsaurie 1/532+3-9, zona kadastrale 8592, Kodipostar 4001

-NIPT-I : K87921701H

-Vlera e ofertës : 44,356,509 (dyzet e katër milion e treqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e nente) leke pa tvsh

## 5. Operatori Ekonomik "ED KONSTRUKSION" shpk + Mbështetës

*"O.B Konstruksion" shpk*

*"ED KONSTRUKSION" shpk*

-Adresa: Tirane, Rruga "Abdi Toptani", Qendra "Torre Drin", apartamenti 112, kati 11

-NIPT-I : K61625001I

-Vlera e ofertës : 45,903,929.59 (dyzet e pesë milion e nentëqind e tremijë e nentëqind e njëzet e nente pike pesëdhjetë e nente) leke pa tvsh

*"O.B. KONSTRUKSION" shpk*

-Adresa: Tirane, Rruga "Abdi Toptani", Qendra "Torre Drin", apartamenti 112, kati 11

-NIPT-I : Durrës, Kryjë , Qëndër Krujë, Lagja Nr. 1

Operatorët ekonomike të skualifikuar :

## 1. Operatori ekonomik "INA" shpk me vlerë të ofertës: 33,867,425 (tridhjetë e tre milion mijë e teteqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e njëzet e pesë ) leke pa tvsh

-Nuk plotëson kriteret përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të kërkuara në DST me objekt: "Zhbllokim i shkarkuesve dhe kanal ujëmbledhës"

Konkretisht :

-Nuk plotëson piken 2.3 për punë të ngjashme , pasi zërat e preventivit në procedurën e realizuar nga operatori "Rikonstruksion i rruges Shen Mehill" nuk përputhen me zërat në preventivin e procedurës "Zhbllokim i shkarkuesve dhe kanal ujëmbledhës"

-Nuk plotëson piken 2.3.4, mungon nje inxhinier ndertimi si staf mbeshtetes per realizimin e punimeve te kesaj procedure.

-Ing Ferdinand Çausi i paraqitur si inxhinier Gjeolog ,i pajisur me certificate trajnimi për "Pergjegjes per sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne Pune", nuk eshte pjese e stafit mbeshtetes te kerkuar ne DST.

2. Operatori ekonomik "NIKA" shpkme vlerë të ofertës: 36,899,530 (tridhjetë e gjashtëmilion e teteqind e nentëdhjetë e nente mijë e peseqind e tridhjetë ) lekë pa tvsh

-nuk plotëson kriteret përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të kërkuara në DST me objekt: "Zhbllokim i shkarkuesve dhe kanal ujëmbledhës"

Konkretisht :

Nga Operatori ekonomik është paraqitur stafi mbështetës me inxhinierët si më poshtë

- InxhinierNdertimiZ.ArdrianKalamishi
- InxhinierHidroteknikZnj.ElsaThano
- InxhinierGjeodetZ.ArbenKruja

Në formularin e shtojcës 8 operatori ekonomik nuk ka deklaruar se njeri nga inxhinierët e përcaktuar mësipër nëstafin mbështetës disponon certificate trajnimi për "Pergjegjes per sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne Pune"

3. Bashkim Operatorësh Ekonomik "COLOMBO" shpk + "Rroku Guest" shpk me vlerë të ofertës: 44,356,509 (dyzet e katërmilion e treqind e pesëdhjetë e gjashtëmijë e peseqind e nente) leke pa tvsh

-Nuk plotëson kriteret përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të kërkuara në DST me objekt: "Zhbllokim i shkarkuesve dhe kanal ujëmbledhës"

Konkretisht:

-Mungon mjeti Tokmak elektrik i nevojshem per realizimin e kesaj procedure prokurimi.

4. Operatori Ekonomik "ED KONSTRUKSION " shpk + Mbështetës "O.B Konstruksion" shpkme vlerë të ofertës: 45,903,929.59 (dyzet e pesëmilion e nenteqind e tremijë e nenteqind e njetzet e nente pike pesëdhjetë e nente) leke pa tvsh

-Plotëson kriteret përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të kërkuara në DST me objekt: "Zhbllokim i shkarkuesve dhe kanal ujëmbledhës"

Konkretisht :

-Nuk plotëson piken 2.3 per pune te ngjashme , pasi zerat e preventivit ne proceduren e realizuar nga operatori "Rikonstruksion i rruges "Koli Marku" nuk perputhen me zerat ne preventivin e procedures "Zhbllokim i shkarkuesve dhe kanal ujëmbledhës"

-Nuk plotëson piken 2.3.4, mungon nje inxhinier ndertimi si staf mbeshtetes per realizimin e punimeve te kesaj procedure.

Oferta e kualifikuar :

1. Operatori Ekonomik "ARTYKA II " shpk

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik "ARTYKA II" shpk ,me adresë: Korçë, Bilisht, Rruga e Mirasit, Km.i.I, Pranë Ish Nyjes së Inerteve, Bilisht se oferta e paraqitur ,me një vlerë të përgjithshme 41,991,837(dyzet e njëmilion e nenteqind e

nentedhjete e njemije e teteqind e tridhjete e shtate)leke pa tvsh pikët totale të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik".

## **AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR**

Drejtuar: Operatorit Ekonomik "SALILLARI" SHPK  
Tirane Vore Lagjja" Vore", Rruga e Vjetër , VoreMarikaj, Km 1, Godina katër  
katëshe, Kati i tretë, Nr.5.

Procedura e prokurimit/lotit: "Procedurë e Hapur - Shërbim - Mbi kufirin e lartë monetar - Marrëveshje Kuadër - prokurim publik me mjete elektronike"

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-69560-05-17-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "Mirëmbajtja e rrugës Kardhiq-Delvinë, Loti-7 (Tuneli)"

Fondi limit: 86,870,520 (tetëdhjetë e gjashtë milion e tetëqind e shtatëdhjetë mijë e pesëqind e njëzet) Lekë, pa TVSH.

Në Euro: 773,006.94 (shtatëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e gjashtë pikë nëntëdhjetë e katër) Euro pa TVSH (kursi i këmbimit zyrtar: 1 Euro këmbëhet me 112.38 Lekë).

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 48 muaj

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti):

Buletini i Njoftimeve Publike: *Buletini i Njoftimeve Publike, data 22 Maj 2023, nr. 45*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. "ALKO IMPEX CONSTRUCTION" SHPK K91628013D

Vlera: 82,508,000 (tetëdhjetë e dy milion e pesëqind e tetë mijë) Lekë pa TVSH.

2. "HTM" SHPK K97006004D

Vlera: 74,715,100 (shtatëdhjetë e katër milion e shtatëqind e pesëmbëdhjetë mijë e njëqind) Lekë pa TVSH.

3. "ILIRIADA" SHPK J61828125L

Vlera: 85,205,000 (tetëdhjetë e pesë milion e dyqind e pesë mijë) Lekë pa TVSH.

4. "SALILLARI" SHPK J62903125G

Vlera: 80,709,000 (tetëdhjetë milion e shtatëqind e nëntë mijë) Lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. "HTM" SHPK K97006004D

2. "ILIRIADA" SHPK J61828125L

Arsyet e skualifikimit si më poshtë:

I. Operatori Ekonomik "HTM" SHPK nuk kualifikohet, pasi nuk nuk plotëson pikën 2.3.1 të DST, në të cilën thuhet:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit të kësaj kontrate.

II. Operatori Ekonomik "ILIRIADA" SHPK nuk kualifikohet, pasi nuk nuk plotëson pikën 2.3.1 të DST, në të cilën thuhet:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit të kësaj kontrate.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik "SALILLARI" SHPK, me adresë: Tirane Vore Lagjja" Vore", Rruga e Vjetër , Vore-Marikaj, Km 1, Godina katër katëshe, Kati i tretë, Nr.5, me NUIS: J62903125G, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 80,709,000 (tetëdhjetë milion e shtatëqind e nëntë mijë) Lekë pa TVSH është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në *nenin 110 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik"*.

## **SPITALI RAJONAL "MEMORIAL" FIER**

Drejtuar: OE: "Montal" sh.p.k me adresë : Rr. Dervish Hima, 3 Kullat, K3 A9/2, Tirana, Albania

Procedura e prokurimit/lotit: “E hapur e thjeshtuar”

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-74214-07-04-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Riparim gjenerator per CT skaner”

Fondi limit: 3 550 000 ( tre milion e pesëqind e pesëdhjetë mijë ) leke pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: 5 ditë nga data e nënshkrimit të Kontrates.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike nr.61 datë 10.07.2023.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

“Montal” sh.p.k

J62009007F

- Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera : 3 250 000 (tre milion e dyqind e pesëdhjet mijë ) leke pa TVSH

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm: Nuk ka

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se OE: “Montal” sh.p.k me adresë : Rr. Dervish Hima, 3 Kullat, K3 A9/2, Tirana, Albania , dhe ofertën e paraqitur me vlerë totale prej) 3 250 000 (tre milion e dyqind e pesëdhjet mijë ) leke pa TVSH , totali i pikëve të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik’.

## **SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME DIBËR SH.A**

Drejtuar: Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, Shoqëria “ELITE STUDIO” sh.p.k & Shoqëria “HYDRO-ENG CONSULTING” sh.p.k, me të dhëna si më poshtë:

Shoqëria “ELITE STUDIO” sh.p.k & Shoqëria HYDRO-ENG CONSULTING sh.p.k

Shoqëria “ELITE STUDIO” sh.p.k me NIPT L91721507E me seli në Durrës, Lagja Nr 3 Rruga Egnatia, Zona Kadastrale 8514, Nr. pasurie 3/65.

Shoqëria “HYDRO-ENG CONSULTING” sh.p.k me NIPT M11417503F, me seli në Durrës, Rruga Ahmet Ramzoti, Lagja Nr.18, Rajoni Nr.5, nr. Pasure 29/70+1-211, Zona Kadastrale 8511.

Procedura e prokurimit: E hapur e thjeshtuar shërbime / Prokurim publik me mjete elektronike

Numri i referencës së procedurës: REF 73119-06-20-2023

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit(FPP): 71247000-1 - Mbikqyrje e Punës së ndërtimit

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Supervizion punimesh për objektin Ndërtim i Linjës kryesore të Ujësjellësit dhe Rrjetit Shpërndarës për fshatrat e njësisë administrative Xibër, Bashkia Klos

Afati kohor për ekzekutimin: 12 (dymbëdhjetë) muaj

Fondi limit: 2,823,364.9 (dy milion e tetëqind e njëzet e tre mijë e treqind e gjashtëdhjetë e katër pikë nëntë) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit.

Publikimet e mëparshme: Ka patur

Numri i Referencës: Nr. REF 68144-05-03-2023

Procedurë e anuluar, pa ankim.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto
- Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi, ju informojmë se në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik Shoqëria “DERBI-E” sh.p.k NIPT K77916947A

Vlera e Ofertës: 2,493,746.8 (dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e dyzet e gjashtë pikë tetë) lekë pa TVSH.

2. Operatori Ekonomik Shoqëria “HYDROWATER – ALBANIA” sh.p.k NIPT L12414005A

Vlera e Ofertës: 2,494,187.989 (dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e katër mijë e njëqind e tetëdhjetë e shtatë pikë nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

3. Operatori Ekonomik Shoqëria “MAGNA CHARTA”sh.p.k NIPT L92318021H

Vlera e Ofertës: 2,494,187.98 (dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e katër mijë e njëqind e tetëdhjetë e shtatë pikë nëntëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

4. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “MIKI CONSULTING” sh.p.k & Shoqëria “BN PROJEKT” sh.p.k me të dhënat si më poshtë:

Shoqëria “MIKI CONSULTING” sh.p.k NIPT K87628701K  
 Shoqëria “BN PROJECT” sh.p.k NIPT L21305035S  
 Vlera e Ofertës: 2,494,188 lekë (dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e katër mijë e njëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

5. Operatori Ekonomik Shoqëria “ERSI / M” sh.p.k NIPT J98624803O

Vlera e Ofertës: 2,494,187.98 (dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e katër mijë e njëqind e tetëdhjetë e shtatë pikë nëntëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

6. Operatori Ekonomik Shoqëria “2ED” sh.p.k NIPT M02027010U

Vlera e Ofertës: 2,495,536.4 (dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e tridhjetë e gjashtë pikë katër) lekë pa TVSH.

7. Operatori Ekonomik Shoqëria “NOVATECH STUDIO” sh.p.k NIPT L01717030C

Vlera e Ofertës: 2,494,187.98 (dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e katër mijë e njëqind e tetëdhjetë e shtatë pikë nëntëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

8. Bashkimi Operatorëve Ekonomikë, Shoqëria “ELITE STUDIO” sh.p.k & Shoqëria “HYDRO-ENG CONSULTING” sh.p.k me të dhëna si më poshtë:

Shoqëria “ELITE STUDIO” sh.p.k NIPT L91721507E

Shoqëria “HYDRO-ENG CONSULTING” sh.p.k NIPT M11417503F

Vlera e Ofertës: 2,494,198.15 (dy milion e katërqind e nëntëdhjetë katër mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tetë pikë pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

- I. Nga Vlerësimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik rezultoi se ofertat e s`kualifikuara nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor janë:

1. Operatori Ekonomik Shoqëria “DERBI-E” sh.p.k me NIPT K77916947A me vlerë të ofertës: 2,493,746.8 (dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e dyzet e gjashtë pikë tetë) lekë pa TVSH.

Për këto arsye:

- Autoriteti Kontraktor gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur elektronikisht nga ky Operator Ekonomik konstatoi se nuk plotëson kriteret e DST-së. Konkretisht Shtojca 1 Formulari i Ofertës nuk është plotësuar sipas formatit të DST-së së publikuar nga autoriteti kontraktor.
- Autoriteti Kontraktor gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur elektronikisht nga ky Operator Ekonomik konstatoi gjithashtu se nuk plotësohen kërkesat e Shtojcës 8 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” / Kapaciteti teknik, Kapitulli 2.3.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim, Paragrafi Shenim, pasi vlera e ofertës ekonomike të paraqitur është nën vlerën minimale të përlogaritur nga Autoriteti Kontraktor. Kjo përlogaritje është bërë bazuar në VKM



Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”, Udhëzimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.5585 Prot date 25.07.2017 “Rekomandim mbi mënyren e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”.

- Sa më lart, vlera e ofertuar është nën vlerën minimale të shërbimit të përlogaritur nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me DST-në e publikuar nga ky autoritet, Shtojca 8 Kapitulli 2.3.4 paragrafi Shenim ku është kërkuar :
  - Oferta ekonomike e paraqitur nga Operatori Ekonomik duhet të jetë në përputhje me VKM Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim” si dhe duhet të jetë brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të kesaj VKM. Kjo kërkesë bazohet dhe në Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.5585 Prot datë 25.07.2017 “Mbi mënyren e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016. Të gjitha ofertat që do të jenë me vlerë më të ulët se vlera minimale ose më të lartë se vlera maksimale e përcaktuar në VKM Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”, do të refuzohen.
  - Në këto kushte, bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet: *“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”*, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor bëri s`kualifikimin e Operatorit Ekonomik Shoqërisë “DERBI-E” sh.p.k.
2. Operatori Ekonomik Shoqëria “HYDROWATER - ALBANIA” sh.p.k me NIPT L12414005A me vlerë të ofertës: 2,494,187.989 (dy milion e katërqind e nentëdhjetë e katër mijë e njëqind e tetëdhjetë e shtatë pikë nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

Për këto arsye:

- Autoriteti Kontraktor gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur elektronikisht nga ky Operator Ekonomik konstatoi se nuk plotësohen kërkesat e Shtojcës 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” / Kapaciteti teknik, Kapitulli 2.3.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim, Paragrafi Shenim, pasi vlera e ofertës ekonomike të paraqitur është nën vlerën minimale të përlogaritur nga Autoriteti Kontraktor. Kjo përlogaritje është bërë bazuar në VKM Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”, Udhëzimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.5585 Prot date 25.07.2017 “Rekomandim mbi mënyren e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”.

- Sa më lart, vlera e ofertuar është nën vlerën minimale të shërbimit të përlogaritur nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me DST-në e publikuar nga ky autoritet, Shtojca 8 Kapitulli 2.3.4 paragrafi Shënim ku është kërkuar:
  - Oferta ekonomike e paraqitur nga Operatori Ekonomik duhet të jetë në përputhje me VKM Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim” si dhe duhet të jetë brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të kësaj VKM. Kjo kërkesë bazohet dhe në Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.5585 Prot datë 25.07.2017 “Mbi mënyren e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016. Të gjitha ofertat që do të jenë me vlerë më të ulët se vlera minimale ose më të lartë se vlera maksimale e përcaktuar në VKM Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”, do të refuzohen.
  - Në këto kushte, bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet: *“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”*, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor bëri s`kualifikimin e Operatorit Ekonomik Shoqërisë “HYDROWATER – ALBANIA” sh.p.k.
- 3. Operatori Ekonomik Shoqëria “MAGNA CHARTA” sh.p.k me NIPT L92318021H me vlerë të ofertës: 2,494,187.98 (dy milion e katërqind e nentëdhjetë e katër mijë e njëqind e tetëdhjetë e shtatë pikë nentëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.**
- Autoriteti Kontraktor gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur elektronikisht nga ky Operator Ekonomik konstatoi se nuk plotësohen kërkesat e Shtojcës 8 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” / Kapaciteti teknik, Kapitulli 2.3.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim, Paragrafi Shënim, pasi vlera e ofertës ekonomike të paraqitur është nën vlerën minimale të përlogaritur nga Autoriteti Kontraktor. Kjo përlogaritje është bërë bazuar në VKM Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”, Udhëzimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.5585 Prot date 25.07.2017 “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”.
  - Sa më lart, vlera e ofertuar është nën vlerën minimale të shërbimit të përlogaritur nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me DST-në e publikuar nga ky autoritet, Shtojca 8 Kapitulli 2.3.4 paragrafi Shënim ku është kërkuar :
  - Oferta ekonomike e paraqitur nga Operatori Ekonomik duhet të jetë në përputhje me VKM Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim” si dhe duhet të jetë brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të kësaj VKM. Kjo kërkesë bazohet dhe në Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.5585 Prot datë 25.07.2017 “Mbi mënyren e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354

datë 11.05.2016. Të gjitha ofertat që do të jenë me vlerë më të ulët se vlera minimale ose më të lartë se vlera maksimale e përcaktuar në VKM Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”, do të refuzohen.

  - Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat e pikës 1 Seksioni 2.1 “Kapaciteti profesional të operatorëve ekonomikë”, pasi nuk ka paraqitur licencën e kërkuar kategoria II.8.B të lëshuar nga QKB. Për këtë pikë operatori ka paraqitur dy licenca të cilat nuk lidhen me objektin e prokurimit dhe kërkesën e autoriteti kontraktor.
  - Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat sipas pika 2 germa a) të Seksionit 2.3 “Kapaciteti Teknik”, e ndryshuar, pasi nuk ka paraqitur te plote deklaratën e kontributeve te sigurimeve shoqërore individuale për drejtuesin teknik. Për këtë pike ka paraqitur deklarate te kontributeve te sigurimeve shoqërore për drejtuesin teknik vetëm për 12 muaj ndërkohe qe duhet të vërtetonte me dokumentacion nga sigurimet shoqërore të të gjithë eksperiencën e punonjësit për qëllime kualifikimi.
  - Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat e pika 4 të Seksionit 2.3 “Kapaciteti Teknik”, e ndryshuar, pasi nuk paraqiti deklaratën me anë të cilës të merr përsipër se secila produkt duhet të shoqërohet me etiketën dhe elementet përkatës sipas legjislacionit në fuqi.
  - Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat e pika 8 të Seksionit 2.3 “Kapaciteti Teknik”, e ndryshuar, pasi nuk paraqiti deklaratën me anë të cilës të merr përsipër kryerjen e shërbimit , nga punonjës të pajisur me uniformën e punës, me materiale /pajisje mbrojtëse personale për shëndetin dhe sigurinë teknike në punë.
- “LOERMA” SHPK S’kualifikohet për arsye:

- Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat sipas pikës b) pika 2 Seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik”, pasi nuk ka paraqitur certifikata/dëshmi trajnimi të vlefshme për operimin e pajisjeve, për dy punonjësit e deklaruar në deklaratën e punonjësve.
- Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat sipas pikës b) pika 2 Seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik”, paragrafi i fundit pasi nuk ka paraqitur deklaratën “se punonjësit do të jenë të pajisur me Certifikatë për kryerjen e trajnimeve në fushën DDD (pra, të jenë të siguruar sipas kërkesave ligjore në fuqi)”.
- Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat sipas pikës pika 3 Seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik”, pasi nuk ka paraqitur tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjinës si dhe Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent.
  - “METANI GREEN” SHPK S’kualifikohet për arsye:
- Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesën sipas pikës 1 Seksioni 2.3 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, pasi nuk vërteton vlerën e kërkuar për xhiro vjetore prej 40% të fondit limit në të paktë 1(një)vit. Për këtë pikë OE ka paraqitur një vërtetim xhiro vjetore e cila nuk përmban vlerë ekonomike sipas kërkesës .
- Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesën sipas pikës 2 Seksioni 2.3 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, pasi nuk ka paraqitur dhe nuk disponon pasqyra financiare për një nga vitet e kërkuara sipas kërkesës. Për këtë pikë OE ka paraqitur një deklaratë ku pretendon se “është një subjekt i ri i regjistruar dhe ka pamundësi për të dorëzuar bilancin në datën e hapjes të ofertave pasi bilanci/pasqyra financiare te vitit 2022 miratohen deri më 30 Mars të viti 2023”.
- “ALPEST” SHPK S’kualifikohet për arsye:
- Operatori ekonomik nuk ka paraqitur oferte dhe asnjë dokumente kualifikues për këtë procedure.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

1) “EGIAN MED” SHPK

L71715003C

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: 2,192,104 (dy milion e njëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e njëqind e katër) Lekë (pa TVSH)

\* \* \*

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqisni tek, organi qendror blerës, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara, me adresë: Ministria e Brendshme, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nd.1, 1001, Tiranë, Tel: 042247865, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak): PO

Kanë marrë përgjigje nga KPP: Vendimi Nr. 317/2023 datë 28.04.2023

# **NJOFTIME FITUESI ME PROKURIM ELEKTRONIK TË PËRFUNDUAR**

## **BASHKIA SARANDË**

Drejtuar: [ “ARTI” SHPK me NIPT(NUIS): J64103808P . Adresa: Lagjja nr.1,Rruga Onhezmi. , Sarande, Sarande.]

Procedura e prokurimit/lotit: ““Procedurë e hapur e thjeshtuar, Punë””

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-73445-06-22-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Rikonstruksion i varrezave publike Sarande, Gjashte ,Shelegar, Metoq”, Fondi limit 5 000 000 (Pese milion ) leke, pa TVSH, Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 15 ( Pesemedhjetë) ditë]

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [2023] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. ”ARTI ”SHPK

NIPT:J64103808P

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 3 501 960 (Tre milion e peseqind e nje mije e nenteqind e gjashtedhjetë )lek pa T.V.SH  
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. ”JODY-KOMPANY ”SHPK

NIPT:J94824803M

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 4 034 800 (Kater milion e tridhjetë e kater mije e teteqind )lek pa T.V.SH  
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

3. ”SARK ”SHPK

NIPT:K52531415H

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 4 620 000 (Kater milion e gjashteqind e njezete mije )lek pa T.V.SH  
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [ “ARTI” SHPK me NIPT(NUIS): J64103808P . Adresa: Lagjja nr.1,Rruga Onhezmi. , Sarande, Sarande., se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 3 501 960 (Tre milion e peseqind e nje mije e nenteqind e gjashtedhjetë ) lek pa T.V.SH]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Bashkia Sarandë, Rruga Abedin Dino, lagjia Nr. 2 email bashkiasarande@yahoo.com ] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5(pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO  JOx

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)\_\_\_\_\_

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)\_\_\_\_\_

## **MINISTRIA E MBROJTJES**

Drejtuar : Bashkimit të operatorëve ekonomikë si vijon :

- “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k., me NUIS K66613407H me adresë: “Diber Bulqize Lagjia Minatori, Rruga e Spitalit, Pallati nr.12, Shk.1, Kati 5, Ap.15.” dhe
- “S I R E TA 2F” sh.p.k., me NUIS K51501008J me adresë: “Paskuqan Lagjia Babrru Fushe, Komuna Paskuqan, Tiranë”,  
krijuar me Kontratën e Bashkëpunimit datë 02.06.2023 dhe përfaqësuar nga shoqëria “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k.

\* \* \*

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur”, prokurim publik me mjete elektronike.

Numri i referencës së procedurës: REF-68727-05-09-2023.

Numri i referencës së Lotit nr. I: REF-68732-05-09-2023.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Loti nr. I, me objekt “Ndërtim grup depo për administrimin e pajisjeve dhe akomodimin e kompanisë së II-të, të kërkim - shpëtimit, në pronën nr. 86, Ferraj,

*Tiranë*”, me fond limit 78,695,257 (shtatëdhjetë e tetë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e dyqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur” (prokurim publik me mjete elektronike), me objekt “Ndërtime dhe rikonstruksione objektsh”, për nevoja të Komandës Mbështetëse.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: Duke filluar nga data e fillimit të punimeve me përfundim brenda 9 (nëntë) muajve.

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): nuk ka patur.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto   
oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X.

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara :

1. Operatori ekonomik “BE - IS” sh.p.k., me NUIS K71412003A, me ofertë ekonomike me vlerë 67,773,537 (gjashtëdhjetë e shtatë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e pesëqind e tridhjetë e shtatë) lekë pa TVSH;
2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “COLOMBO” sh.p.k., me NUIS J82916489E dhe “IMPACT” sh.p.k., me NUIS K81325001B, me ofertë ekonomike me vlerë 60,542,298 (gjashtëdhjetë milionë e pesëqind e dyzet e dy mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH;
3. Operatori ekonomik “EUROVIA” shpknj., me NUIS L91426009G, me ofertë ekonomike me vlerë 61,397,536 (gjashtëdhjetë e një milion e treqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH;
4. Operatori ekonomik “INA” sh.p.k., me NUIS J61814009W, me ofertë ekonomike me vlerë 69,537,841 (gjashtëdhjetë e nëntë milionë e pesëqind e tridhjetë e shtatë mijë e tetëqind e dyzet e një) lekë pa TVSH;
5. Operatori ekonomik “KEVIN KONSTRUKSION” sh.p.k., me NUIS K71401004W, me ofertë ekonomike me vlerë 62,032,108 (gjashtëdhjetë e dy milionë e tridhjetë e dy mijë e njëqind e tetë) lekë pa TVSH;
6. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k., me NUIS K66613407H dhe “S I R E TA 2F” sh.p.k., me NUIS K51501008J, me ofertë ekonomike me vlerë 66,676,584 (gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH;
7. Operatori ekonomik “RAFIN COMPANY” sh.p.k., me NUIS L52125110A, me ofertë ekonomike me vlerë 66,974,788 (gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

**I.** Operatori ekonomik “BE - IS” sh.p.k., me NUIS K71412003A.

Për arsyet e mëposhtme:

Oferta ekonomike e paraqitur nga operatori ekonomik “BE - IS” sh.p.k., me NUIS K71412003A, me vlerë 67,773,537 (gjashtëdhjetë e shtatë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e pesëqind e tridhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, kishte gabime në sasi të e volumeve të punës të përcaktuara në preventivin e punimeve objekt prokurimi, konkretisht në Seksionin A të preventivit me emërtesë “Punime ndërtimi”, nëseksioni 1 “Punime gërmimi e transport dheu”, në zërat me nr. rendor 1 dhe 2, konkretisht me të dhënat si më poshtë:

A. PUNIME NDERTIMI				
Nr	Shenja e manualit	Emërtimi i punimeve	Njësia	Sasia
		1. Punime gërmimi e transport dheu		
1	2.28/a	Gërmim themele e plinta b~2m, ekskavator me zinxhir 0.25m <sup>3</sup> ,shkarkimi ne auto	m <sup>3</sup>	2,287.50
2	2.19/a	Mbushje dhe ngjeshje dheu	m <sup>3</sup>	1,372.50

Referuar sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se ashtu si kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit pjesëmarrës në një procedurë prokurimi edhe sasi të e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në preventivin e punimeve objekt kontrate, janë të detyrueshme dhe nuk mund të ndryshohen nga ofertuesit.

Në vijim të këtij arsyetimi, të gjithë ofertuesit duhet të paraqesin ofertën e tyre në përputhje me këto dokumente. Theksojmë se, për sa kohë autoriteti kontraktor ka kërkuar dhe përcaktuar shprehimisht në formularin e ofertës sipas shtojcës përkatëse ofertimin për një sasi të përcaktuar atëherë, në këtë rast, operatori ekonomik duhet të plotësojë të gjithë dokumentacionin në përputhje me këtë përcaktim, pasi sasia është një element i rëndësishëm i preventivit të ofertës ekonomike për procedurën e prokurimit objekt kontrate. Theksojmë se sasia është një element i detyrueshëm i përcaktuar në DST nga autoriteti kontraktor, modifikimi i tij duke ulur/rritur sasinë e kërkuar përbën mospërgatitjen e ofertës sipas përcaktimeve të dhëna në dokumentet e tenderit, duke e kthyer ofertën ekonomike në një ofertë të pavlefshme. Gjithashtu, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se, operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, nuk jemi në kushtet e mospërputhjes të çmimit për njësi me çmimin total, apo mospërputhjes ndërmjet fjalëve dhe shifrave, të parashikuara në nenin 82, pika 3 e VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, por jemi në kushtet e ndërhyrjes në sasi të e preventivit. Neni 91 i ligjit të prokurimit publik, nuk e lejon modifikimin e ofertës, duke ndryshuar sasi të e zërave të preventivit.

Në rastin konkret, oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “BE - IS” sh.p.k., me NUIS K71412003A, nuk përmbush kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, ndaj konsiderohet e pavlefshme.

Arsyetimi si më sipër bazohet edhe në vendimin e KPP 550/2020 dhe vendimin e KPP 241/2018.

**II.** Bashkimi i operatorëve ekonomikë “COLOMBO” sh.p.k., me NUIS J82916489E dhe “IMPACT” sh.p.k., me NUIS K81325001B.

Për arsyet e mëposhtme:



Bashkimi i operatorëve ekonomikë “COLOMBO” sh.p.k., me NUIS J82916489E dhe “IMPACT” sh.p.k., me NUIS K81325001B, nuk arrin të plotësojë të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DT, pasi referuar dokumentacionit të paraqitur (Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DT dhe deklaratës për stafin), nuk vërteton se plotëson :

- Anëtari i BOE “IMPACT” sh.p.k., me NUIS K81325001B, nuk arrin të vërtetojë plotësimin e kërkesës për kualifikim për përvojë të suksesshme në kontrata të mëparshme, për të cilat në pikën 2.3.1., të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, është përcaktuar se vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat dhe dokumentet e mëposhtme :

Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore për këtë situacion,
- Aktin e kolaudimit;
- Certifikaten e marrjes në dorezim të përkohshëm/përfundimtar.

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm :

- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore për këtë situacion,
- Akt kolaudimi objekti.

Kontratat e paraqitura nga shoqëria “IMPACT” sh.p.k., me NUIS K81325001B, nuk kanë dokumentacionin e plotë të kërkuar për plotësimin e këtij kriteri, pasi nuk janë kontrata pune por mallrash dhe/ose shërbimesh.

Për sa më sipër, KVO vlerëson se asnjë nga përvojat e mëparshme të paraqitura nga shoqëria “IMPACT”, sh.p.k., nuk plotëson kërkesën për kualifikim sipas pikës 2.3.1, të KVK të DT, pasi nuk janë kontrata punësh të realizuara nga subjekte të licencuara sipas përcaktimeve të akteve ligjore në fuqi për zbatimin e punimeve të ndërtimit, por kontrata furnizimi mallrash apo shërbimi.

- Anëtari i BOE “COLOMBO” sh.p.k., me NUIS J82916489E, nuk plotëson kërkesën e pikës 2.3.3/b të KVK lidhur me disponimin e personelit punonjës të specializuar/të kualifikuar Hidroizolues.

Për plotësimin e këtij kriteri shoqëria ka deklaruar punonjësit z. K. B. dhe z. A. L. të pajisur me dëshmi profesionale nga subjekti Qendra e Trajnimeve të Avancuara, me NUIS L61325037A. Përsa i përket kësaj shoqërie (QTA), rezulton se ky subjekt nuk ka licencë aktive për kurse të formimit profesional për “Hidroizolues” dhe për rrjedhojë nuk përmbushet kërkesa për kualifikim që dëshmitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, të jenë të lëshuara nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”.

Këtë qëndrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin nr. 441/2020 në lidhje me dëshmitë të lëshuara nga subjekte të palicensuara.

Ekstrakt i vendimit 441/2022:



*Pra rezulton se dokumentet e paraqitura për dy punonjësit pllakashtrues, në zbatim të pikës 8 si më sipër cituar nuk përmbushin kërkesën e autoritetit kontraktor për “Diplomë nga institucionet e arsimit të mesëm profesional të akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”, pasi shoqëria ASQCERT, e cila ka lëshuar Certifikatat e Trajnimit për “Kurs Trajnimi për pllakashtrues”, nuk është licensuar nga ana Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe nuk disponon asnjë license për të ofruar kurse trajnimit për formimin profesional në përputhje me ligjin nr.15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë.”*

*Formimi profesional i personelit përbën domosdoshmëri dhe garanton autoritetin kontraktor për kapacitetet profesionale të ofertuesve për përmbushjen me sukses të kontratës, gjë e cila vërtetohet vetëm me Certifikatë/dëshmi/diplomë që është dokument zyrtar dhe i lëshuar një organ certifikues, sipas procedurave standarde ligjore dhe që regjistrojnë arritjet e një individi pas vlerësimit të caktuar.*

### **III.** Operatori ekonomik “EUROVIA” shpknj., me NUIS L91426009G.

Për arsyet e mëposhtme:

Operatori ekonomik “EUROVIA” shpknj., me NUIS L91426009G, me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, nuk arrin të plotësojë të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DT, për shkak se nuk plotëson kërkesën e pikës 2.3.1, të KVK lidhur me përvojën e suksesshme në kontrata të mëparshme, pasi kontrata e paraqitur nuk është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

### **IV.** Operatori ekonomik “KEVIN KONSTRUKSION” sh.p.k., me NUIS K71401004W.

Për arsyet e mëposhtme:

Operatori ekonomik “KEVIN KONSTRUKSION” sh.p.k., me NUIS K71401004W me dokumentacionin e paraqitur nuk arrin të vërtetojë plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Konkretisht:

- nuk arrin të vërtetojë plotësimin e kërkesës për kualifikim sipas pikës 2.3.3/b të KVK lidhur me disponimin e personelit punonjës të specializuar/të kualifikuar Hidroizolues.

Për plotësimin e këtij kriteri shoqëria ka deklaruar punonjësit z. S. K. dhe z. A. F. të pajisur me dëshmi profesionale nga subjekti Qendra e Trajnimeve të Avancuara, me NUIS L61325037A. Përsa i përket kësaj shoqërie (QTA), rezulton se ky subjekt nuk ka licencë aktive për kurse të formimit profesional për “Hidroizolues” dhe për rrjedhojë nuk përmbushet kërkesa për kualifikim që dëshmitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, të jenë të lëshuara nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”.

Këtë qëndrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin nr. 441/2020 në lidhje me dëshmitë e lëshuara nga subjekte të palicencuara.

- oferta/preventivi i punimeve e/i paraqitur nga operatori ekonomik “KEVIN KONSTRUKSION” sh.p.k., ka mangësi në zërat e punimeve të përcaktuara në preventivin e punimeve objekt prokurimi, konkretisht në Seksionin A të preventivit me emërtesë “Punime ndërtimi”, nënseksioni 1 “Punime gërmimi e transport dheu”, mungojnë zërat si vijon:

2	2.19/a	Mbushje dhe ngjeshje dheu	m <sup>3</sup>	1,372.50
3	2.37/5b	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10 km	m <sup>3</sup>	915.00
4	An.1	Depozitim materiali ne landfill	ton	1,921.50

Referuar sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se ashtu si kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi edhe sasi të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në preventivin e punimeve objekt kontrate, janë të detyrueshme dhe nuk mund të ndryshohen nga ofertuesit.

Në vijim të këtij arsytimi, të gjithë ofertuesit duhet të paraqesin ofertën e tyre në përputhje me këto dokumenta. Theksojmë se, përsa kohë autoriteti kontraktor ka kërkuar dhe përcaktuar shprehimisht në formularin e ofertës sipas shtojcës përkatëse ofertimin për një sasi të përcaktuar atëherë, në këtë rast, operatori ekonomik duhet të plotësojë të gjithë dokumentacionin në përputhje me këtë përcaktim, pasi sasia është një element i rëndësishëm i preventivit të ofertës ekonomike për procedurën e prokurimit objekt kontrate. Theksojmë se sasia është një element i detyrueshëm i përcaktuar në DST nga autoriteti kontraktor, modifikimi i tij duke ulur/rritur sasinë e kërkuar përbën mospërgatitjen e ofertës sipas përcaktimeve të dhëna në dokumentet e tenderit, duke e kthyer ofertën në një ofertë të pavlefshme. Gjithashtu, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se, operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente refuzohen si të papranueshme. Neni 91 i ligjit të prokurimit publik, nuk e lejon modifikimin e ofertës, duke ndryshuar sasi të zërave të preventivit.

Në rastin konkret, oferta e paraqitur nga operatori ekonomik "KEVIN KONSTRUKSION" sh.p.k., nuk përmbush kërkesat e vendosura në dokumentat e tenderit, ndaj konsiderohet e pavlefshme.

Arsytimi si më sipër bazohet edhe në vendimin e KPP 550/2020 dhe vendimin e KPP 241/2018.

**V.** Operatori ekonomik RAFIN COMPANY" sh.p.k., me NUIS L52125110A.

Për arsytet e mëposhtme:

Oferta e ekonomike e paraqitur nga operatori ekonomik "RAFIN COMPANY" sh.p.k., me NUIS L52125110A, me vlerë 66,974,788 (gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, kishte gabime aritmetike. Konkretisht në ofertën pa TVSH, të paraqitur nga ofertuesi, nuk është përfshirë vlera e pajisjeve (ndërtimore, elektrike, elektronike dhe mekanike) në shumën 13,822,114 lekë.

Bazuar në sa më sipër, vlera e ofertës duhet të ishte 80,796,902 (tetëdhjetë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e dy) lekë pa TVSH dhe jo 66,974,788 (gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH. Për rrjedhojë diferenca e gabimeve aritmetike në vlerë është 13,822,114 lekë, vlerë kjo më e lartë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.

Për sa më sipër, bazuar në parashikimet e nenit 82, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar cituar:

Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur:

- *shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar,*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi të refuzojë ofertën ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik "RAFIN COMPANY" sh.p.k., me NUIS L52125110A.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë bashkimin e operatorëve ekonomikë :

- “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k., me NUIS K66613407H me adresë: “Diber Bulqize Lagjia Minatori, Rruga e Spitalit, Pallati nr.12, Shk.1, Kati 5, Ap.15.” dhe
- “S I R E TA 2F” sh.p.k., me NUIS K51501008J me adresë: “Paskuqan Lagjia Babrru Fushe, Komuna Paskuqan, Tiranë”,

*krijuar me Kontratën e Bashkëpunimit datë 02.06.2023 dhe përfaqësuar nga shoqëria “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k.,*

se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 66,676,584 (gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ministrisë së Mbrojtjes, me adresë: Rruga e Dibrës (ish shkolla e Bashkuar), Tiranë, me numër kontakti 042 226 601/2/3, 1320, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak) :

PO  JO

## **MINISTRIA E MBROJTJES**

Drejtuar : Bashkimit të operatorëve ekonomikë si vijon :

- “NDREGJONI” sh.p.k., me NUIS K31329048I, me adresë “Njesia Bashkiake Nr. 8, Rruga Sule Bega, Ndertesa Nr. 32, Hyrja 8, Tiranë dhe
- “UDHA” sh.p.k., me NUIS K77524909Q, me adresë “Lagjia Pjeter Budi, Burrel”,  
*krijuar me Marrëveshjen e Bashkëpunimit datë 25.05.2023 dhe përfaqësuar nga shoqëria “NDREGJONI” sh.p.k., me NUIS K31329048I, sipas prokurës datë 25.05.2023.*

\* \* \*

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur”, prokurim publik me mjete elektronike.

Numri i referencës së procedurës : REF-68727-05-09-2023;

Numri i referencës së Lotit nr. II : REF-68735-05-09-2023.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Loti nr. II, me objekt “Ndërtim ofiçine, në pronën nr. 149, Pezë - Helmës, Tiranë”, me fond limit 41,190,106 (dyzet e një milion e njëqind e nëntëdhjetë mijë e njëqind e gjashtë) lekë pa TVSH, të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur” (prokurim publik me mjete elektronike), me objekt “Ndërtime dhe rikonstruksione objektesh”, për nevoja të Komandës Mbështetëse.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: Duke filluar nga data e fillimit të punimeve me përfundim brenda 8 (tetë) muajve.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Nuk ka pasur.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto   
oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim X.

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Ante-Group” sh.p.k., me NUIS J62904100D, me ofertë ekonomike me vlerë 38,113,010 (tridhjetë e tetë milionë e njëqind e trembëdhjetë mijë e dhjetë) lekë pa TVSH;
2. Operatori ekonomik “ASAB” sh.p.k., me NUIS L21317019E, me ofertë ekonomike me vlerë 35,205,566 (tridhjetë e pesë milionë e dyqind e pesë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH;
3. Operatori ekonomik “BE - IS” sh.p.k., me NUIS K71412003A, me ofertë ekonomike me vlerë 32,876,020 (tridhjetë e dy milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëzet) lekë pa TVSH;
4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “COLOMBO” sh.p.k., me NUIS J82916489E dhe “IMPACT” sh.p.k., me NUIS K81325001B, me ofertë ekonomike me vlerë 29,468,488 (njëzet e nëntë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e katërqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH;
5. Operatori ekonomik “EUROVIA” sh.p.k., me NUIS L91426009G, me ofertë ekonomike me vlerë 35,870,914 (tridhjetë e pesë milionë e tetëqind e shtatëdhjetë mijë e nëntëqind e katërbëdhjetë) lekë pa TVSH;
6. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “FLED” sh.p.k., me NUIS K17621104C dhe “DESARET COMPANY” sh.p.k., me NUIS K01816001J, me ofertë ekonomike me vlerë 29,010,030 (njëzet e nëntë milionë e dhjetë mijë e tridhjetë) lekë pa TVSH;
7. Operatori ekonomik “INA” sh.p.k., me NUIS J61814009W, me ofertë ekonomike me vlerë 38,829,894 (tridhjetë e tetë milionë e tetëqind e njëzet e nëntë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e katër) lekë pa TVSH;
8. Operatori ekonomik “LEON KONSTRUKSION” sh.p.k., me NUIS K718200009I, me ofertë ekonomike me vlerë 37,068,221 (tridhjetë e shtatë milionë e gjashtëdhjetë e tetë mijë e dyqind e njëzet e një) lekë pa TVSH;

9. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “NDREGJONI” sh.p.k., me NUIS K31329048I dhe “UDHA” sh.p.k., me NUIS K77524909Q, me ofertë ekonomike me vlerë 36,186,580 (tridhjetë e gjashtë milionë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH;
10. Operatori ekonomik “PEPA GROUP GROUP” sh.p.k., me NUIS L42215009L, me ofertë ekonomike me vlerë 36,574,601 (tridhjetë e gjashtë milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e një) lekë pa TVSH;
11. Operatori ekonomik “RAFIN COMPANY” sh.p.k., me NUIS L52125110A, me ofertë ekonomike me vlerë 36,094,327 (tridhjetë e gjashtë milionë e nëntëdhjetë e katër mijë e treqind e njëzet e shtatë) lekë pa TVSH;
12. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “XHAŠT” sh.p.k., me NUIS K12512837I dhe “MELA.” sh.p.k., me NUIS K62320011G, me ofertë ekonomike me vlerë 31,008,934 (tridhjetë e një milion e tetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e katër) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “Ante-Group” sh.p.k., me NUIS J62904100D.

Për arsyet e mëposhtme:

Operatori ekonomik “Ante-Group” sh.p.k., me NUIS J62904100D, me dokumentacionin e paraqitur nuk arrin të vërtetojë plotësimin e të gjitha kërkesave për kualifikim të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe konkretisht:

- Nuk plotëson kërkesën për kualifikim sipas shkronjës a) të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta të kualifikimit, lidhur me disponimin e personelit kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë. Konkretisht, z. L. K., i deklaruar i punësuar në rolin e inxhinierit Gjeodet (drejtues teknik) në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8, nuk rezulton si drejtues teknik në Licencën NZ.2568/22 të paraqitur nga kjo shoqëri.

2. Operatori ekonomik “ASAB” sh.p.k., me NUIS L21317019E.

Për arsyet e mëposhtme:

Operatori ekonomik “ASAB” sh.p.k., me NUIS L21317019E, me dokumentacionin e paraqitur nuk arrin të vërtetojë plotësimin e të gjitha kërkesave për kualifikim të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Konkretisht:

- Nuk plotëson kërkesën e pikës 1, shkronja b, të kriterëve të veçanta të kualifikimit, pasi ofertuesi nuk ka paraqitur Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- Nuk plotëson kërkesën e pikës 1, shkronja a, të kriterëve të veçanta të kualifikimit, pasi ofertuesi nuk ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 dhe për rrjedhojë nuk plotësohen kërkesat e përgjithshme për kualifikim dhe as kërkesat e veçanta për kualifikim, përmbushja e të cilave bëhet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

3. Operatori ekonomik “BE - IS” sh.p.k., me NUIS K71412003A.

Për arsytet e mëposhtme:

Oferta ekonomike e paraqitur nga operatori ekonomik “BE - IS” sh.p.k., me NUIS K71412003A, me vlerë 32,876,020 lekë pa TVSH, kishte gabime aritmetike. Konkretisht, gabimet rezultojnë në shumat e seksioneve të preventivit të punimeve si më poshtë:

- Seksioni 3. Kanalizim i ujerave atmosferike (shuma e deklaruar për zërin nr. 6, me sasi 3456 dhe me çmim 280 lekë është 968 lekë, ndërkohë që nga kontrolli rezulton të jetë 967680 lekë);
- Seksioni 2. Sistemi i fuqisë dhe ndriçimit (shuma e deklaruar për zërin nr. 1, me sasi 1600 dhe me çmim 25 lekë është 40 lekë, ndërkohë që nga kontrolli rezulton të jetë 40000 lekë);
- Seksioni 2. Sistemi i fuqisë dhe ndriçimit (shuma e deklaruar për zërin nr. 2, me sasi 1400 dhe me çmim 35 lekë është 49 lekë, ndërkohë që nga kontrolli rezulton të jetë 49000 lekë),

për pasojë këto gabime janë reflektuar edhe në shumatoren e ofertës totale.

Nga kontrolli aritmetik rezulton se çmimi total pa TVSH, duhet të jetë 33,984,424 (tridhjetë e tre milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë e katërqind e njëzet e katër) lekë.

Diferenca mes vlerës së ofruar dhe vlerës së korrigjuar është:  $33,984,424 - 32,876,020 = 1,108,404$  lekë  $> 2\%$  e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar ( $32,876,020 * 2\% = 657,520.40$ ).

Për sa më sipër, bazuar në parashikimet e nenit 82, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar cituar:

*Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur:*

- *shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar,*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi të refuzojë ofertën ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik “BE - IS” sh.p.k., me NUIS K71412003A.

4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “COLOMBO” sh.p.k., me NUIS J82916489E dhe “IMPACT” sh.p.k., me NUIS K81325001B.

Për arsytet e mëposhtme:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “COLOMBO” sh.p.k., me NUIS J82916489E dhe “IMPACT” sh.p.k., me NUIS K81325001B, me dokumentacionin e paraqitur nuk arrin të vërtetojë plotësimin e të gjitha kërkesave për kualifikim të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Konkretisht:

- Shoqëria “IMPACT” sh.p.k., me NUIS K81325001B, në cilësinë e anëtarit të BOE nuk arrin të vërtetojë plotësimin e kërkesës për kualifikim për përvojë të suksesshme në kontrata të mëparshme, për të cilat në pikën 2.3.1., të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, është përcaktuar se vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentet e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore për këtë situacion,



- Aktin e kolaudimit;
- Certifikaten e marrjes ne dorezim të përkohshëm/përfundimtar.

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore për këtë situacion,
- Akt kolaudimi objekti.

Kontratat e paraqitura nga “IMPACT” sh.p.k., me NUIS K81325001B, nuk ka dokumentacionin e plotë të kërkuar për plotësimin e këtij kriteri, pasi nuk janë kontrata pune por mallrash dhe/ose shërbimesh.

Për sa më sipër, KVO vlerëson se asnjë nga përvojat e mëparshme të paraqitura nga shoqëria “IMPACT”, sh.p.k., nuk plotëson kërkesën për kualifikim sipas pikës 2.3.1 të KVK të DT, pasi nuk janë kontrata punësh të realizuara nga subjekte të licencuara sipas përcaktimeve të akteve ligjore në fuqi për zbatimin e punimeve të ndërtimit, por kontrata furnizimi mallrash apo shërbimi.

- Shoqëria “COLOMBO” sh.p.k., me NUIS J82916489E, në cilësinë e anëtarit të BOE nuk plotëson kërkesën e pikës 2.3.3/b të KVK lidhur me disponimin e personelit punonjës të specializuar/të kualifikuar Hidroizolues.

Për plotësimin e këtij kriteri shoqëria ka deklaruar punonjësit z. I. M. dhe z. E. H. të pajisur me dëshmi profesionale nga subjekti Qendra e Trajnimeve te Avancuara, me NUIS L61325037A. Për sa i përket kësaj shoqërie (QTA), rezulton se ky subjekt nuk ka licencë aktive për kurse të formimit profesional për “Hidroizolues” dhe për rrjedhojë nuk përmbushet kërkesa për kualifikim që dëshmitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, të jenë të lëshuara nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”.

Këtë qëndrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin nr. 441/2020 në lidhje me dëshmitë e lëshuara nga subjekte të palicensuara.

#### 5. Operatori ekonomik “EUROVIA” shpknj., me NUIS L91426009G.

Për arsyet e mëposhtme:

Operatori ekonomik “EUROVIA” shpknj., me NUIS L91426009G, me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, nuk arrin të plotësojë të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DT, për shkak se nuk plotëson kërkesën e pikës 2.3.1 të KVK lidhur me përvojën e suksesshme në kontrata të mëparshme, pasi kontrata e paraqitur nuk është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

6. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “FLED” sh.p.k., me NUIS K17621104C dhe “DESARET COMPANY” sh.p.k., me NUIS K01816001.

Për arsyet e mëposhtme:



Bashkimi i operatorëve ekonomikë “FLED” sh.p.k., me NUIS K17621104C dhe “DESARET COMPANY” sh.p.k., me NUIS K01816001, me dokumentacionin e paraqitur nuk arrin të vërtetojë plotësimin e të gjitha kërkesave për kualifikim të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Konkretisht, oferta është paraqitur si BOE midis dy shoqërive (“FLED” sh.p.k. & “DESARET COMPANY” sh.p.k.) dhe krahas kësaj referuar parashikimeve ligjore, BOE është mbështetur në kapacitetet e një shoqërie tjetër, “ZEQILLARI” sh.p.k., me NUIS L61912024O. Për shoqërinë mbështetëse janë përmbushur kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, pasi është paraqitur deklarata e angazhimit nga shoqëria “ZEQILLARI” sh.p.k. si dhe Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit të lidhur më datë 25.05.2023 midis dy shoqërive rezulton se ndarja e punimeve është bërë si vijon;

- shoqëria “FLED” sh.p.k., do të realizojë 55% të zërave dhe volumeve të preventivit dhe
- shoqëria “DESARET COMPANY” sh.p.k., do të realizojë 45 të zërave dhe volumeve të preventivit.

Vlerësimi/verifikimi i plotësimit të kërkesave për kualifikim për këtë ofertë është bërë duke patur parasysh përcaktimet e ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, konkretisht të nenit 88 të Rregullave të Prokurimit Publik, miratuar me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Në rastin e paraqitjes së ofertave si BOE, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

- Së pari, referuar sa më sipër, rezulton se BOE “FLED” sh.p.k., me NUIS K17621104C dhe “DESARET COMPANY” sh.p.k., me NUIS K01816001J, nuk plotëson kërkesat për kualifikim sipas pikës 2.3.3 / a, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit (Kapaciteti teknik), lidhur me disponimin e personelit kryesor drejtues teknik në licencën e shoqërisë. Vetëm një nga anëtarët e BOE ka deklaruar se disponon inxhinier elektronik (“DESARET COMPANY” sh.p.k.), i cili rezulton edhe si drejtues teknik në licencën e shoqërisë, ndërsa shoqëria tjetër anëtare e BOE (“FLED” sh.p.k.) edhe pse ka marrë përsipër të realizojë 55% të zërave dhe volumeve të preventivit ku përfshihen edhe punimet elektronike (sistemi LAN, CCTV) nuk ka vërtetuar se disponon inxhinierin elektronik drejtues teknik në licencën e shoqërisë Licencë NZ.2383/23, specialist ky që referuar proces verbalit të mbajtur nga NJP për argumentimin e kërkesave për kualifikim, është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektivit që do të ndërtohet për secilin nga zërat e punimeve elektronike të përfshira në projektin dhe preventivin objekt prokurimi.

- Së dyti, rezulton se BOE “FLED” sh.p.k., me NUIS K17621104C dhe “DESARET COMPANY” sh.p.k., me NUIS K01816001J, nuk plotëson kërkesat për kualifikim sipas pikës 2.3.3 / b, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit (Kapaciteti teknik), lidhur me disponimin e punonjësve të specializuar/kualifikuar, pasi asnjë nga anëtarët e BOE nuk ka paraqitur dokumente për të vërtetuar se disponon punonjës duro-alumini.

- Së treti rezulton se BOE “FLED” sh.p.k., me NUIS K17621104C dhe “DESARET COMPANY” sh.p.k., me NUIS K01816001J, nuk plotëson kërkesën për kualifikim sipas pikës 2.3.3 / f, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit (Kapaciteti teknik), për të patur të punësuar në stafin e tyre 1 (një) “Auditues energjie”, i cili duhet të jetë i pajisur me “Çertifikatë për Auditues Energjistik në ndërtesa”, lëshuar nga Agjencia për Eficencën e Energjisë.

Për plotësimin e këtij kriteri BOE është mbështetur në kapacitetet e shoqërisë “ZEQILLARI” sh.p.k., me NUIS L61912024O dhe konkretisht është deklaruar z. E. H, me profesion Inxhinier elektrik, si specialisti i pajisur me certifikatë “Auditim energjie në ndërtesa”, por nga kontrolli në faqen zyrtare

të Agjencisë për Efiçencën e Energjisë (<http://eficenca.gov.al/audituesit-e-energji-se-ne-ndetesa/>), nuk rezulton në listën e personave të pajisur me “Çertifikatë për Auditues Energjistik në ndertesa”, lëshuar nga kjo Agjenci.

- Së katërti rezulton se BOE “FLED” sh.p.k., me NUIS K17621104C dhe “DESARET COMPANY” sh.p.k., me NUIS K01816001J, nuk plotëson kërkesat për kualifikim sipas pikës 2.3.2/b, për disponimin e licencës së lëshuar nga QKL, “Kodi III.2.B” (*Për grumbullim, ruajtje dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta*), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, pasi licenca me Kod III.2.B e lëshuar në emër “DESARET COMPANY”, nuk është shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar, si më sipër.

#### 7. Operatori ekonomik “LEON KONSTRUKSION” sh.p.k., me NUIS K718200009I.

Për arsyet e mëposhtme:

Operatori ekonomik “LEON KONSTRUKSION” sh.p.k., me NUIS K718200009I, me dokumentacionin e paraqitur nuk arrin të vërtetojë plotësimin e të gjitha kërkesave për kualifikim të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Konkretisht:

- Operatori ekonomik “LEON KONSTRUKSION” sh.p.k., me NUIS K718200009I, dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, nuk arrin të plotësojë të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DT, pasi referuar dokumentacionit të paraqitur (Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DT dhe deklaratës për stafin), nuk vërteton se plotëson kërkesën e pikës 2.3.3/b të KVK lidhur me disponimin e punonjësve të specializuar/të kualifikuar Hidroizolues. Për plotësimin e këtij kriteri shoqëria ka deklaruar punonjësit z. A. L. dhe z. Z. K., të pajisur me dëshmi profesionale nga subjekti Agjencia Shqiptare e Punësimit, me NUIS L21410066G. Për sa i përket kësaj shoqërie (ASHP), rezulton se ky subjekt nuk ka licencë aktive për kurse të formimit profesional për “Hidroizolues” dhe për rrjedhojë nuk përmbushet kërkesa për kualifikim që dëshmitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, të jenë të lëshuara nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”. Këtë qëndrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin nr. 745/2022 në lidhje me dëshmitë e lëshuara nga subjekte të palicensuara.
- Nuk plotëson kërkesën e pikës pikës 2.3.3/f, të kriterëve të veçanta për kualifikim, të dokumenteve të tenderit, lidhur me disponimin e një punonjësi “Auditues energjie”, i cili duhet të jetë i pajisur me “Çertifikatë për Auditues Energjistik në ndertesa”, lëshuar nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë. Operatori ekonomik “LEON KONSTRUKSION” sh.p.k., në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit ka deklaruar znj. R. H., si auditues energjite, nga kontrolli në faqen zyrtare të Agjencisë për Efiçencën e Energjisë (<http://eficenca.gov.al/audituesit-e-energji-se-ne-ndetesa/>), znj. R. H., nuk rezulton në listën e personave të pajisur me “Çertifikatë për Auditues Energjistik në ndertesa”, lëshuar nga kjo Agjenci.

#### 8. Operatori ekonomik “PEPA GROUP GROUP” sh.p.k., me NUIS L42215009L.

Për arsyet e mëposhtme:

Operatori ekonomik "PEPA GROUP GROUP" sh.p.k., me NUIS L42215009L, me dokumentacionin e paraqitur nuk arrin të vërtetojë plotësimin e të gjitha kërkesave për kualifikim të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Konkretisht:

- Operatori ekonomik "PEPA GROUP GROUP" sh.p.k., me NUIS K718200009I, dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, nuk arrin të plotësojë të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DT, pasi referuar dokumentacionit të paraqitur (Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DT dhe deklaratës për stafin), nuk vërtetohet se plotëson kërkesën e pikës 2.3.3/b të KVK lidhur me disponimin e punonjësve të specializuar/të kualifikuar Hidroizolues. Për plotësimin e këtij kriteri shoqëria ka deklaruar punonjësit z. A. M. dhe z. R. K., të pajisur me dëshmi profesionale nga subjekti Agjencia Shqiptare e Punësimit, me NUIS L21410066G. Për sa i përket kësaj shoqërie (ASHP), rezulton se ky subjekt nuk ka licencë aktive për kurse të formimit profesional për "Hidroizolues" dhe për rrjedhojë nuk përmbushet kërkesa për kualifikim që dëshmitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, të jenë të lëshuara nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.". Këtë qëndrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin nr. 745/2022 në lidhje me dëshmitë e lëshuara nga subjekte të palicensuara.

Gjithashtu, referuar dokumentacionit të paraqitur (Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DT dhe deklaratës për stafin), të O.E "PEPA GROUP GROUP" sh.p.k., rezulton se punonjësit e specializuar :

- Bojaxhi (2 punonjës)
- Suvatues (2 punonjës)
- Pllakashtrues (1 punonjës)

janë të pajisur me dëshmi profesionale nga subjekti "Career Cert Institute (CCI)", me NUIS L61918028H.

Lidhur me këto certifikata, KVO verifikoi në QKB dhe rezulton se kjo shoqëri nuk ka asnjë licencë aktive dhe për rrjedhojë nuk përmbushet kërkesa për kualifikim që dëshmitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, të jenë të lëshuara nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 "*Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.*".

Këtë qëndrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin Nr. 441/2020 dhe nr. 745/2022 në lidhje me dëshmitë e lëshuara nga subjekte të palicensuara.

**9.** Operatori ekonomik "RAFIN COMPANY" sh.p.k., me NUIS L52125110A.

Për arsyet e mëposhtme:

Oferta e ekonomike e paraqitur nga operatori ekonomik "RAFIN COMPANY" sh.p.k., me NUIS L52125110A, me vlerë 36,094,327 lekë pa TVSH, kishte gabime aritmetike. Konkretisht në ofertën pa TVSH, të paraqitur nga ofertuesi, nuk është përfshirë vlera e pajisjeve (hidraulike, elektrike dhe elektronike) në shumën 3,256,300 lekë.

Bazuar në sa më sipër, vlera e ofertës duhet të ishte 39,350,627.5 (tridhjetë e nëntë milionë e treqind e pesëdhjetë mijë e gjashtëqind e njëzet e shtatë pikë pesë) lekë pa TVSH dhe jo 36,094,327 (tridhjetë e gjashtë milionë e nëntëdhjetë e katër mijë e treqind e njëzet e shtatë) lekë pa TVSH, për rrjedhojë diferenca e gabimeve aritmetike në vlerë është 3,256,300.5 (tre milionë e dyqind e pesëdhjetë e

gjashtë mijë e treqind pikë pesë) lekë pa TVSH, vlerë kjo më e lartë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.

Për sa më sipër, bazuar në parashikimet e nenit 82, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar cituar:

Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur:

- *shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar,*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi të refuzojë ofertën ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik “RAFIN COMPANY” sh.p.k., me NUIS L52125110A.

- 10.** Bashkimi i operatorëve ekonomikë “XHAŠT” sh.p.k., me NUIS K12512837I dhe “MELA.” sh.p.k., me NUIS K62320011G.

Për arsyet e mëposhtme:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “XHAŠT” sh.p.k., me NUIS K12512837I dhe “MELA.” sh.p.k., me NUIS K62320011G, me dokumentacionin e paraqitur nuk arrin të vërtetojë plotësimin e të gjitha kërkesave për kualifikim të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

- Konkretisht, nuk plotëson kërkesën e pikës 1, shkronja b, të kriterëve të veçanta të kualifikimit, pasi ofertuesi nuk ka paraqitur Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë bashkimin e operatorëve ekonomikë:

- “NDREGJONI” sh.p.k., me NUIS K31329048I, me adresë “Njesia Bashkiake Nr. 8, Rruga Sule Bega, Nderresa Nr. 32, Hyrja 8, Tiranë dhe
- “UDHA” sh.p.k., me NUIS K77524909Q, me adresë “Lagjia Pjeter Budi, Burrel”,  
*krijuar me Marrëveshjen e Bashkëpunimit datë 25.05.2023 dhe përfaqësuar nga shoqëria “NDREGJONI” sh.p.k., me NUIS K31329048I, sipas prokurës datë 25.05.2023,*

se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 36,186,580 (tridhjetë e gjashtë milionë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ministrisë së Mbrojtjes, me adresë: Rruga e Dibrës (ish shkolla e Bashkuar), Tiranë, me numër kontakti 042 226 601/2/3, 1320, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak) :

PO  JO

**MINISTRIA E MBROJTJES**

Drejtuar : Operatorit ekonomik “INA” sh.p.k., me NUIS J61814009W, me adresë “Rruga Besim Imami, Myslym Shyri, Mbrapa Karburantit, Tiranë”.

\* \* \*

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur”, prokurim publik me mjete elektronike.

Numri i referencës së procedurës : REF-68727-05-09-2023;

Numri i referencës së Lotit nr. IV : REF-68740-05-09-2023.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Loti nr. IV, me objekt “Rikonstruksion i objektit të truprojes dhe rrethim i jashtëm, në pronën nr. 122, Marikaj, Vorë”, me fond limit 19,364,287 (nëntëmbëdhjetë milionë e treqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e dyqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH., të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur” (prokurim publik me mjete elektronike), me objekt “Ndërtime dhe rikonstruksione objektsh”, për nevoja të Komandës Mbështetëse.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: Duke filluar nga data e fillimit të punimeve me përfundim brenda 12 (dymbëdhjetë) javëve.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Nuk ka pasur.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X.

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “BE - IS” sh.p.k., me NUIS K71412003A, me ofertë ekonomike me vlerë 17,464,866 (shtatëmbëdhjetë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH;
2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “FLED” sh.p.k., me NUIS K17621104C dhe “DESARET COMPANY” sh.p.k., me NUIS K01816001J, me ofertë ekonomike me vlerë 13,850,899 (trembëdhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH;
3. Operatori ekonomik “INA” sh.p.k., me NUIS J61814009W, me ofertë ekonomike me vlerë 18,339,233 (tetëmbëdhjetë milionë e treqind e tridhjetë e nëntë mijë e dyqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH;
4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “LIQENI VII” sh.p.k., me NUIS K01730502W dhe “ONI” sh.p.k., me NUIS J66902008N, me ofertë ekonomike me vlerë 18,276,616 (tetëmbëdhjetë milionë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:



**1. Operatori ekonomik "BE - IS" sh.p.k., me NUIS K71412003A.**

Për arsyet e mëposhtme:

Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik "BE - IS" sh.p.k., me NUIS K71412003A, me ofertë ekonomike me vlerë 17,464,866 (shtatëmbëdhjetë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, kishte gabime në sasinë e volumeve të punës të përcaktuara në preventivin e punimeve objekt prokurimi, konkretisht në Preventivin A (Punime Ndërtimi), Seksioni 1 (Punime gërmimi e transport dheu), zëri me nr. An. 2.37/5b, me emërtesë "Transport mbeturinash, dheu me auto deri në 10 km".

Referuar sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se ashtu si kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi edhe sasinë e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në preventivin e punimeve objekt kontrate, janë të detyrueshme dhe nuk mund të ndryshohen nga ofertuesit.

Në vijim të këtij arsyetimi, të gjithë ofertuesit duhet të paraqesin ofertën e tyre në përputhje me këto dokumenta. Theksojmë se, përsa kohë autoriteti kontraktor ka kërkuar dhe përcaktuar shprehimisht në formularin e ofertës sipas shtojcës përkatëse ofertimin për një sasi të përcaktuar atëherë, në këtë rast, operatori ekonomik duhet të plotësojë të gjithë dokumentacionin në përputhje me këtë përcaktim, pasi sasia është një element i rëndësishëm i preventivit të ofertës ekonomike për procedurën e prokurimit objekt kontrate. Theksojmë se sasia është një element i detyrueshëm i përcaktuar në DST nga autoriteti kontraktor, modifikimi i tij duke ulur/rritur sasinë e kërkuar përbën mospërgatitjen e ofertës sipas përcaktimeve të dhëna në dokumentat e tenderit, duke e kthyer ofertën ekonomike në një ofertë të pavlefshme. Gjithashtu, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se, operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, nuk jemi në kushtet e mospërrputhjes të cmimit për njësi me cmimin total, apo mospërrputhjes ndërmjet fjalëve dhe shifrave, të parashikuara në nenin 82, pika 3 e VKM nr.285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, por jemi në kushtet e ndërhyrjes në sasinë e preventivit. Neni 91 i ligjit të prokurimit publik, nuk e lejon modifikimin e ofertës, duke ndryshuar sasinë e zërave të preventivit.

Në rastin konkret, oferta e paraqitur nga operatori ekonomik "BE - IS" sh.p.k., me NUIS K71412003A, nuk përmbush kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, ndaj konsiderohet e pavlefshme.

Arsyetimi si më sipër bazohet edhe në vendimin e KPP 550/2020 dhe vendimin e KPP 241/2018.

**2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë "FLED" sh.p.k., me NUIS K17621104C dhe "DESARET COMPANY" sh.p.k., me NUIS K01816001.**

Për arsyet e mëposhtme:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë "FLED" sh.p.k., me NUIS K17621104C dhe "DESARET COMPANY" sh.p.k., me NUIS K01816001J, me dokumentacionin e paraqitur nuk arrin të vërtetojë plotësimin e të gjitha kërkesave për kualifikim të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Konkretisht, oferta është paraqitur si BOE midis dy shoqërive (“FLED” sh.p.k. & “DESARET COMPANY” sh.p.k.) dhe krahas kësaj referuar parashikimeve ligjore, BOE është mbështetur në kapacitetet e një shoqërie tjetër, “ZEQILLARI” sh.p.k., me NUIS L61912024O. Për shoqërinë mbështetëse janë përmbushur kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, pasi është paraqitur deklarata e angazhimit nga shoqëria “ZEQILLARI” sh.p.k. si dhe Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit të lidhur më datë 25.05.2023 midis dy shoqërive rezulton se ndarja e punimeve është bërë si vijon;

- shoqëria “FLED” sh.p.k., do të realizojë 55% të zërave dhe volumeve të preventivit dhe
- shoqëria “DESARET COMPANY” sh.p.k., do të realizojë 45 të zërave dhe volumeve të preventivit.

Vlerësimi/verifikimi i plotësimit të kërkesave për kualifikim për këtë ofertë është bërë duke patur parasysh përcaktimet e ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, konkretisht të nenit 88 të Rregullave të Prokurimit Publik, miratuar me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Në rastin e paraqitjes së ofertave si BOE, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

- Së pari, referuar sa më sipër, rezulton se BOE “FLED” sh.p.k., me NUIS K17621104C dhe “DESARET COMPANY” sh.p.k., me NUIS K01816001J, nuk plotëson kërkesat për kualifikim sipas pikës 2.3.3 / a, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit (Kapaciteti teknik), lidhur me disponimin e personelit kryesor drejtues teknik në licencën e shoqërisë. Vetëm një nga anëtarët e BOE ka deklaruar se disponon inxhinier elektronik (“DESARET COMPANY” sh.p.k.), i cili rezulton edhe si drejtues teknik në licencën e shoqërisë, ndërsa shoqëria tjetër anëtare e BOE (“FLED” sh.p.k.) edhe pse ka marrë përsipër të realizojë 55% të zërave dhe volumeve të preventivit ku përfshihen edhe punimet elektronike (sistemi LAN, CCTV) nuk ka vërtetuar se disponon inxhinierin elektronik drejtues teknik në licencën e shoqërisë Licencë NZ.2383/23, specialist ky që referuar proces verbalit të mbajtur nga NJP për argumentimin e kërkesave për kualifikim, është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektivit që do të ndërtohet për secilin nga zërat e punimeve elektronike të përfshira në projektin dhe preventivin objekt prokurimi.

- Së dyti, rezulton se BOE “FLED” sh.p.k., me NUIS K17621104C dhe “DESARET COMPANY” sh.p.k., me NUIS K01816001J, nuk plotëson kërkesat për kualifikim sipas pikës 2.3.3 / b, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit (Kapaciteti teknik), lidhur me disponimin e punonjësve të specializuar/kualifikuar, pasi asnjë nga anëtarët e BOE nuk ka paraqitur dokumente për të vërtetuar se disponon punonjës të kualifikuar si: Teknikë/Specialistë të inxhinierisë elektronike dhe/ose të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

- Së treti rezulton se BOE “FLED” sh.p.k., me NUIS K17621104C dhe “DESARET COMPANY” sh.p.k., me NUIS K01816001J, nuk plotëson kërkesat për kualifikim sipas pikës 2.3.2/b, për disponimin e licencës së lëshuar nga QKL, “Kodi III.2.B” (*Për grumbullim, ruajtje dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta*), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, pasi licenca me Kod III.2.B e lëshuar në emër “DESARET COMPANY”, nuk është shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar, si më sipër.



3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “LIQENI VII” sh.p.k., me NUIS K01730502W dhe “ONI” sh.p.k., me NUIS J66902008N.

Për arsyet e mëposhtme:

Oferta e ekonomike e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “LIQENI VII” sh.p.k., me NUIS K01730502W dhe “ONI” sh.p.k., me NUIS J66902008N, me vlerë 18,276,616 (tetëmbëdhjetë milionë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, nuk është plotësuar në përputhje me shtojcën 1 “Formulari i ofertës ekonomike” dhe shtojcën 2 “Lista e çmimeve të artikujve”, të dokumenteve të tenderit, pasi në ofertën e paraqitur nga ofertuesi nuk është ofertuar për një zë preventivi të kërkuar nga AK në preventivin e punimeve, konkretisht si më poshtë:

- Në seksionin 10 (Punime sistemimi jashtëm), të preventivirt A (Punime Ndërtimi), mungon zëri me nr. An. 3,620 me emërtesë “Trotuar, me pllaka betoni  $t=6\text{cm}$ , mbi shtrese llaçi çimentoje”, me sasi 49 m<sup>2</sup>.

Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se ashtu si kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi edhe lista e artikujve e përcaktuar në preventivin e punimeve, është e detyrueshme dhe s’mund të ndryshohen nga ofertuesit. Gjithashtu, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se, operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta refuzohen si të papranueshme. Në rastin konkret, oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “LIQENI VII” sh.p.k., me NUIS K01730502W dhe “ONI” sh.p.k., me NUIS J66902008N, me vlerë 18,276,616 (tetëmbëdhjetë milionë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, nuk përmbush kërkesat e vendosura në dokumentat e tenderit, ndaj konsiderohet e pavlefshme.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatori ekonomik “INA” sh.p.k., me NUIS J61814009W, me adresë “Rruga Besim Imami, Myslym Shyri, Mbrapa Karburantit, Tiranë”, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 18,339,233 (tetëmbëdhjetë milionë e treqind e tridhjetë e nëntë mijë e dyqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ministrisë së Mbrojtjes, me adresë: Rruga e Dibrës (ish shkolla e Bashkuar), Tiranë, me numër kontakti 042 226 601/2/3, 1320, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak):

PO

JO

**MINISTRIA E MBROJTJES**

Drejtuar : Operatorit ekonomik “INA” sh.p.k., me NUIS J61814009W, me adresë Rruga “Besim Imami”, Myslym Shyri, mbrapa Karburantit, Tiranë”.

\* \* \*

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur”, prokurim publik me mjete elektronike.

Numri i referencës së procedurës : REF-68727-05-09-2023.

Numri i referencës së Lotit nr. VI: REF-68746-05-09-2023.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Loti nr. VI, me objekt “Rikonstruksion i godinës njëkatëshe nr. 2 dhe të godinës së truprojes, Mengël, Elbasan”, me fond limit 17,855,980 (shtatëmbëdhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH, të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur” (prokurim publik me mjete elektronike), me objekt “Ndërtime dhe rikonstruksione objektsh”, për nevoja të Komandës Mbështetëse.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: Duke filluar nga data e fillimit të punimeve për të 2 (dy) objektet, me përfundim brenda 6 (gjashtë) muajve, detajuar sipas objekteve si më poshtë :

- Për objektin - “Rikonstruksion i godinës njëkatëshe nr. 2” : afati i zbatimit të kontratës është duke filluar nga data e fillimit të punimeve me përfundim brenda 6 (gjashtë) muajve.
- Për objektin - “Rikonstruksion i godinës së truprojes” : afati i zbatimit të kontratës është duke filluar nga data e fillimit të punimeve me përfundim brenda 3 (tre) muajve muajve.

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Nuk ka pasur.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto   
oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim X.

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “BE - IS” sh.p.k., me NUIS K71412003A, me ofertë ekonomike me vlerë 15,521,394 (pesëmbëdhjetë milionë e pesëqind e njëzet e një mijë e treqind e nëntëdhjetë e katër) lekë pa TVSH;
2. Operatori ekonomik “ERGI” sh.p.k., me NUIS K02727229P, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike;
3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “FLED” sh.p.k., me NUIS K17621104C dhe “DESARET COMPANY” sh.p.k., me NUIS K01816001J, me ofertë ekonomike me vlerë 11,422,778

- (njëmbëdhjetë milionë e katërqind e njëzet e dy mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH;
4. Operatori ekonomik "INA" sh.p.k., me NUIS J61814009W, me ofertë ekonomike me vlerë 16,896,640 (gjashtëmbëdhjetë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e dyzet) lekë pa TVSH;
  5. Bashkimi i operatorëve ekonomikë "NDREGJONI" sh.p.k., me NUIS K31329048I dhe "UDHA" sh.p.k., me NUIS K77524909Q, me ofertë ekonomike me vlerë 16,482,162 (gjashtëmbëdhjetë milionë e katërqind e tetëdhjetë e dy mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik "BE - IS" sh.p.k., me NUIS K71412003A.

Për arsyet e mëposhtme:

Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik "BE - IS" sh.p.k., me NUIS K71412003A, me vlerë 15,521,394 (pesëmbëdhjetë milionë e pesëqind e njëzet e një mijë e treqind e nëntëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, kishte gabime në sasinë e volumeve të punës të përcaktuara në preventivin e punimeve objekt prokurimi, konkretisht në Seksionin E të preventivit me emërtesë "Punime mekanike HVAC", zërat "F.V Tub PP e rakorderi kondesati Ø32 mm" dhe "F.V Elemente ndihmese dhe plotesues konsumi".

Referuar sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se ashtu si kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi edhe sasinë e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në preventivin e punimeve objekt kontrate, janë të detyrueshme dhe nuk mund të ndryshohen nga ofertuesit.

Në vijim të këtij arsyetimi, të gjithë ofertuesit duhet të paraqesin ofertën e tyre në përputhje me këto dokumente. Theksojmë se, për sa kohë autoriteti kontraktor ka kërkuar dhe përcaktuar shprehimisht në formularin e ofertës sipas shtojcës përkatëse ofertimin për një sasi të përcaktuar atëherë, në këtë rast, operatori ekonomik duhet të plotësojë të gjithë dokumentacionin në përputhje me këtë përcaktim, pasi sasia është një element i rëndësishëm i preventivit të ofertës ekonomike për procedurën e prokurimit objekt kontrate. Theksojmë se sasia është një element i detyrueshëm i përcaktuar në DST nga autoriteti kontraktor, modifikimi i tij duke ulur/rritur sasinë e kërkuar përbën mospërgatitjen e ofertës sipas përcaktimeve të dhëna në dokumentat e tenderit, duke e kthyer ofertën ekonomike në një ofertë të pavlefshme. Gjithashtu, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se, operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, nuk jemi në kushtet e mospërputhjes të çmimit për njësi me çmimin total, apo mospërputhjes ndërmjet fjalëve dhe shifrave, të parashikuara në nenin 82, pika 3 e VKM nr.285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, por jemi në kushtet e ndërhyrjes në sasinë e preventivit. Neni 91 i ligjit të prokurimit publik, nuk e lejon modifikimin e ofertës, duke ndryshuar sasinë e zërave të preventivit.

Në rastin konkret, oferta e paraqitur nga operatori ekonomik "BE - IS" sh.p.k., me NUIS K71412003A, nuk përmbush kërkesat e vendosura në dokumentat e tenderit, ndaj konsiderohet e pavlefshme.

Arsyetimi si më sipër bazohet edhe në vendimin e KPP 550/2020 dhe vendimin e KPP 241/2018.

**2. Operatori ekonomik "ERGI" sh.p.k., me NUIS K02727229P.**

Për arsyet e mëposhtme:

Operatori ekonomik "ERGI" sh.p.k. nuk ka paraqitur ofertë ekonomike dhe as preventivin e detajuar të punimeve.

**3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë "FLED" sh.p.k., me NUIS K17621104C dhe "DESARET COMPANY" sh.p.k., me NUIS K01816001J.**

Për arsyet e mëposhtme:

Operatorët ekonomikë "FLED" sh.p.k., me NUIS K17621104C dhe "DESARET COMPANY" sh.p.k., me NUIS K01816001J, në cilësinë e ofertuesit si BOE, me dokumentacionin e paraqitur nuk arrijnë të vërtetojnë plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Konkretisht, oferta është paraqitur si BOE midis dy shoqërive ("FLED" sh.p.k. & "DESARET COMPANY" sh.p.k.) dhe krahas kësaj referuar parashikimeve ligjore, BOE është mbështetur në kapacitetet e një shoqërie tjetër, "ZEQILLARI" sh.p.k., me NUIS L619120240". Për shoqërinë mbështetëse janë përmbushur kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, pasi është paraqitur deklarata e angazhimit nga shoqëria "ZEQILLARI" sh.p.k. si dhe Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit të lidhur më datë 25.05.2023 midis dy shoqërive rezulton se ndarja e punimeve është bërë si vijon;

- shoqëria "FLED" sh.p.k., do të realizojë 55% të zërave dhe volumeve të preventivit dhe
- shoqëria "DESARET COMPANY" sh.p.k., do të realizojë 45 të zërave dhe volumeve të preventivit.

Vlerësimi/verifikimi i plotësimit të kërkesave për kualifikim për këtë ofertë është bërë duke patur parasysh përcaktimet e ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, konkretisht të nenit 88 të Rregullave të Prokurimit Publik, miratuar me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar. Në rastin e paraqitjes së ofertave si BOE, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

- Së pari, referuar sa më sipër, rezulton se BOE "FLED" sh.p.k., me NUIS K17621104C dhe "DESARET COMPANY" sh.p.k., me NUIS K01816001J, nuk plotëson kërkesat për kualifikim sipas pikës 2.3.3 / a, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit (Kapaciteti teknik), lidhur me disponimin e personelit kryesor drejtues teknik në licencën e shoqërisë. Vetëm një nga anëtarët e BOE ka deklaruar se disponon inxhinier elektronik ("DESARET COMPANY" sh.p.k.), i cili rezulton edhe si drejtues teknik në licencën e shoqërisë, ndërsa shoqëria tjetër anëtare e BOE ("FLED" sh.p.k.) edhe pse ka marrë përsipër të realizojë 55% të zërave dhe volumeve të preventivit ku përfshihen edhe punimet elektronike (sistem CCTV, rrjeti LAN, sistemi i telefonisë, rrjeti televiziv dhe instalimi i pajisjeve përkatëse) nuk ka vërtetuar se disponon inxhinierin elektronik drejtues teknik në licencën e shoqërisë Licencë NZ.2383/23, specialist ky që referuar proces verbalit të mbajtur nga NJP për argumentimin e kërkesave për kualifikim, është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që do të ndërtohet për secilin nga zërat e punimeve elektronike të përfshira në projektin dhe preventivin objekt prokurimi. Personi i deklaruar në formular (znj. Eliana Bozi, nuk rezulton drejtuese teknike në licencën e shoqërisë Licencë NZ. 4048/20 dhe për rrejdhojë, BOE me dokumentacionin e

paraqitur nuk plotëson kërkesën për kualifikim sipas pikës 2.3.3 / a të KVK (Kapaciteti teknik).

- Së dyti, rezulton se BOE "FLED" sh.p.k., me NUIS K17621104C dhe "DESARET COMPANY" sh.p.k., me NUIS K01816001J, nuk plotëson kërkesat për kualifikim sipas pikës 2.3.3 / b, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit (Kapaciteti teknik), lidhur me disponimin e punonjësve të specializuar/kualifikuar. Mangësitë lidhur me specialistët janë si më poshtë vijon:

- Asnjë nga anëtarët e BOE nuk ka paraqitur dokumente për të vërtetuar se disponon teknikë/specialistë të inxhinierisë elektronike dhe/ose të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

- Shoqëria "DESARET COMPANY" sh.p.k., nuk ka paraqitur dokumentacion për të vërtetuar se disponon instalues dhe riparues të kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse, përgatitës të konstruksioneve metalike dhe të ngjashëm, hekurkthyes, hidroizolues dhe suvatues .

Shoqëria "DESARET COMPANY" sh.p.k., në cilësinë e anëtarit të BOE që ka marrë përsipër të realizojë 45% të zërave dhe volumeve të preventivit, ka detyrimin që të plotësojë kërkesat teknike për kualifikim në përputhje me përqindjen, natyrën e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

- Së treti rezulton se BOE "FLED" sh.p.k., me NUIS K17621104C dhe "DESARET COMPANY" sh.p.k., me NUIS K01816001J, nuk plotëson kërkesat për kualifikim sipas pikës 2.3.3 / d, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit (Kapaciteti teknik), për të patur të punësuar në stafin e tyre 1 (një) "Auditues energjie", i cili duhet të jetë i pajisur me "Çertifikatë për Auditues Energjistik në ndertesa", lëshuar nga Agjencia per Eficencën e Energjisë.
- Së katërti rezulton se BOE "FLED" sh.p.k., me NUIS K17621104C dhe "DESARET COMPANY" sh.p.k., me NUIS K01816001J, nuk plotëson kërkesat për kualifikim sipas pikës 2.3.2/b, për disponimin e licencës së lëshuar nga QKL, "Kodi III.2.B" (*Për grumbullim, ruajtje dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta*), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", i ndryshuar, pasi licenca me Kod III.2.B e lëshuar në emër "DESARET COMPANY", nuk është shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar, si më sipër.

4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë "NDREGJONI" sh.p.k., me NUIS K31329048I dhe "UDHA" sh.p.k., me NUIS K77524909Q.

Për arsye të mëposhtme:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë "NDREGJONI" sh.p.k., me NUIS K31329048I dhe "UDHA" sh.p.k., me NUIS K77524909Q, me dokumentacionin e paraqitur nuk arrijnë të vërtetojnë plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Konkretisht, oferta është paraqitur si BOE midis dy shoqërive ("NDREGJONI" sh.p.k. & "UDHA" sh.p.k.).

Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit të lidhur më datë 25.05.2023 midis dy shoqërive rezulton se ndarja e punimeve është bërë si vijon;

- shoqëria "NDREGJONI" sh.p.k., do të realizojë 87% të punimeve

- shoqëria “UDHA” sh.p.k., do të realizojë 13% të punimeve.

Vlerësimi/verifikimi i plotësimit të kërkesave për kualifikim për këtë ofertë është bërë duke pasur parasysh përcaktimet e ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, konkretisht të nenit 88 të Rregullave të Prokurimit Publik, miratuar me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Në rastin e paraqitjes së ofertave si BOE, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Referuar sa më sipër, rezulton se BOE (“NDREGJONI” sh.p.k. & “UDHA” sh.p.k.), nuk plotëson kërkesën për kualifikim sipas pikës 2.3.3 / b, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit (Kapaciteti teknik), lidhur me disponimin e punonjësve të specializuar/kualifikuar. Mangësitë lidhur me specialistët janë si më poshtë vijon:

Shoqëria “UDHA” sh.p.k., me NUIS K77524909Q, në cilësinë e anëtarit të BOE, që ka marrë përsipër të realizojë 13% të punimeve objekt kontrate dhe konkretisht punimet elektronike elektronike (sistem CCTV, rrjeti LAN, sistemi i telefonisë, rrjeti televiziv dhe instalimi i pajisjeve përkatëse) nuk ka vërtetuar se disponon dy Teknikë/Specialistë të inxhinierisë elektronike dhe/ose të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, të cilët janë të nevojshëm për realizimin e punimeve që ka marrë përsipër. Shoqëria ka deklaruar vetëm një nga këta specialistë, konkretisht z. K.K., por referuar DT kërkohen dy specialistë për të realizuar punimet sipas afatit dhe cilësisë së kërkuar.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatori ekonomik “INA” sh.p.k., me NUIS J61814009W, me adresë Rruga Besim Imami, Myslym Shyri, Mbrapa Karburantit, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 16,896,640 (gjashtëmbëdhjetë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e dyzet) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ministrisë së Mbrojtjes, me adresë: Rruga e Dibrës (ish shkolla e Bashkuar), Tiranë, me numër kontakti 042 226 601/2/3, 1320, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet siguri i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak) :

PO  JO



**SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME ELBASAN SH.A**

Drejtuar: Operatorit Ekonomik "METEO" sh.p.k, me NIPT: L26310801C, si përfaqësues i BOE "METEO" shpk – "TOTILA" shpk - "ALBA KONSTRUKSION" shpk

[Emri dhe adresa e Ofertuesit fitues]

Adresa: Fshati Çekin, Rruga Nacionale Gramsh-Elbasan, ndërtesë private, Zona Kadastrale Nr. 1362, nr. pasurie: 6/76, pranë Uzinës Çekin, Gramsh.

Procedura e prokurimit/loti: "Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar me mjete elektronike"

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-68415-05-05-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "Rikonstruksion dhe ndërtim i rrjetit të kanalizimeve të zonave informale, Harmës, pjesërisht Krasta e Vogël, pjesërisht Lagjja "Dyli Haxhire" dhe pjesërisht Lagjja "Katund i Ri".

Kohëzgjatja e kontratës: 24 muaj Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike: , Nr. 43, dt. 15. 05. 2023, f. 19/545 Nr. 61, datë: 10. 07. 2023 (Njoftimi i Fituesit Paraparak)

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. BOE

"CURRI" shpk

NIPT: J67902718S

"BE-IS" shpk

NIPT: K71412003A

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: 625 108 981, 77 (gjashtëqind e njëzet e pesë milion e njëqind e tetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e një presje shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. BOE

"METEO" shpk

NIPT: L26310801C

"TOTILA" shpk

NIPT: K13001010G

"ALBA KONSTRUKSION" shpk

NIPT: J61812013R

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: 697 149 643 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë milion e njëqind e dyzet e nëntë mijë e gjashtëqind e dyzet e tre) lekë pa TVSH. (e shprehur në shifra dhe fjalë)



Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. BOE  
"CURRI" shpk  
"BE-IS" shpk

NIPT: J67902718S  
NIPT: K71412003A

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-t*

Për arsyet si vijon:

1- Lidhur me verifikimin e gabimeve aritmetike nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, referuar Shtojcës 1, Formulari i Ofertës dhe Shtojcës 2 Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit, ka një gabim në mbledhjen e shumave, pasqyruar si më poshtë:

Shtojca 2  
LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT  
Data: 12. qershor 2023  
Numri i referencës së prokurimit/letës: REF-08415-05-05-2023  
Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik: BOE "CURRI" Sh.p.k. & "BE-IS" Sh.p.k.  
- "CURRI" Sh.p.k. me NIPT/INIS: J67902718S  
- "BE-IS" Sh.p.k. me NIPT/INIS: K71412003A

Monedha: LEKË.  
Në rast të mospërputhjes midis çimitit për njësi dhe totalit, këtu do të rregullohet në përputhje me Udhëzimet për Operatorin Ekonomik.  
Çmimet dhe moshatat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorin Ekonomik.  
Të gjithë zërat e Formularit e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikat të realimitit të punimeve duhet të lëshohen dhe të vendosen çmimi i ofruesit për secilin zë të preventivit. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të padefinuara dhe do të sigurojnë informacione shtesë.

Oferta ekonomike e detajuar

Nr	No. Analizë	Përshkrimi i Punëve	Njosi	Sasia	Cmimi Njosi (Më)	Cmimi total (Më)
1.	Shuma A2	Rëgj K.U.Z. -Zona Harinas		1	115,898,914.35	115,898,914.35
2.	Shuma A3	Rëgj K.U.Z. -Zona Kosta e Vogel		1	206,682,499.30	206,682,499.30
3.	Shuma A4	Rëgj K.U.Z. -Lagja "Dytë Hardshe"		1	52,403,559.45	52,403,559.45
4.	Shuma A5	Rëgj K.U.Z. -Lagja "Kandri R"		1	102,832,210.65	102,832,210.65
5.	Shuma A4.2	Rëgj K.U.Z. -Kolektori Rruga Nacionale - Kallmet me Mikromat Varianti 2		1	117,534,793.65	117,534,793.65

Shuma:	529,341,887.40
Fondi Rezervë (5%):	26,467,094.37
Shuma:	625,108,981.77
TVSH:	125,831,796.38
SHUMA TOTAL:	750,940,778.15

Shuma Totale pa TVSH nga mbledhja e Shumave 1-5 duhet të dalë 595,341,887.4 (pesëqind e nëntëdhjetë e pesë milion e treqind e dyzet e një mijë e tetëqind e tetëdhjetë e shtatë presje katër) LEKË dhe jo 529,341,887.4 (pesëqind e njëzet e nëntë milion e treqind e dyzet e një mijë e tetëqind e tetëdhjetë e shtatë) Lekë. Pra ka një mospërputhje midis shumave në preventiva dhe Tabelës tek Shtojca 2, pjesë e Shtojcave që duhet të plotësohen nga Operatori Ekonomik.

2- Lidhur me kriteret e përgjithshme të kualifikimit pika: Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

Operatori ekonomik "Curri" shpk sipas verifikimeve të kryera nga ana jonë, nuk ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit sipas nomenklaturës së kodeve të objekteve për shoqëritë tregtare dhe legjislacionit përkatës në fuqi. Ndërtimi i vepreve të tubacioneve e kanalizimeve – F4221.

3- Në pikën 2.3 3/c të kriterëve të veçanta në DST është kërkuar:

- 1 (një) teknik hidroteknik shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

• Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve, objekt kontrate.

• Diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”;

• Për specialistët e mësipërm të paraqiten Kartela personale të sigurimit teknik të vlefshme, të lëshuara nga Inspektoriat Shtetëror Teknik dhe Industrial, apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 8734 datë: 01.02.2001 dhe Ligjit Nr. 13/2013.

Operatori ekonomik Curri shpk për plotësimin e këtij kushti ka deklaruar se do të marr me mbështetje nga Shoqëria Xhengo shpk Specialist Hidroteknik Ing. Gjergji Skllavi. Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se Gjergji Skllavi është Inxhinier Ndërtimi me specialitet ndërtime Hidroteknike Rruge Ura, vërtetuar me diplomë nr. 793-b lëshuar nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, dhe jo Teknik Hidroteknik.

Kjo kërkesë nuk plotësohet.

4- Në pikën 2.3 3/c të kriterëve të veçanta në DST është kërkuar:

c. Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar stafin teknik të përbërë nga të paktën 42 (dyzet e dy) punonjës të specializuar dhe të certifikuar sipas profesionit që kryejnë, dhe të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për periudhën 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit, me profesione si më poshtë:

- 9 (nëntë) Hidraulikë, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

- 4 (katër) specialist ndërtimi, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”

- 4 (katër) saldatorë, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”;

- 4 (katër) specialistë elektrikistë, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” .

- 7 (shtatë) specialiste karpentier/muratore shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

- 2 (dy) specialistë hidroizolues, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

- 5 (pesë) hekurkthyes, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

- Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve, objekt kontrate.
- Diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”;
- Për specialistët e mësipërm të paraqiten Kartela personale të sigurimit teknik të vlefshme, të lëshuara nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 8734 datë: 01.02.2001 dhe Ligjit Nr. 13/2013.

Për punonjësit me profesionet si më sipër, Operatorët Ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:

Nr.	Emër mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni Publik/Privat, lëshues i certifikatës/diplomës	Nr. NIPT-i (në rast se lëshuesi është institucion privat)
1				
2				
3				
Etj.				

Operatori Ekonomik “Curri” shpk, ka paraqitur deklaratën si më poshtë, si dhe Formularin Përmbledhës të Vetë-deklarimit – Seksioni B Deklaratë – Informacion mbi subjektet mbi kapacitetet e të cilëve do të mbështetet Operatori Ekonomik:

#### DEKLARATË PËR PUNONJËSIT E SPECIALIZUAR

Deklaratë e operatorit ekonomik në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë 12. 06. 2023 nga Autoriteti Kontraktor Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Rajoni Elbasan sha, me objekt: “Rikonstruksion dhe ndërtim i rrjetit të kanalizimeve të zonave informale, Harmës, pjesërisht Krasta e Vogël, pjesërisht Lagjja “Dyli Haxhire” dhe pjesërisht Lagjja “Katund i Ri”, me fond limit: 703 790 028 (shtatëqind e tre milion e shtatëqind e nëntëdhjetë mijë e njëzet e tetë) Lekë pa TVSH”.

Nr.	Emër mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni Publik/Privat, lëshues i certifikatës/diplomës	Nr. NIPT-i (në rast se lëshuesi është institucion privat)
2	Ragip Curraj	Hidraulik	ASHP	L21410066G
7	Zef Preçetaj	Elektracist	ASHP	L21410066G
8	Vinçens Noga	Elektracist	ASHP	L21410066G
9	Albert Bushishta	Karpentier	ASHP	L21410066G
10	Isuf Buhaj	Karpentier	ASHP	L21410066G
11	Elion Uruçi	Karpentier	ASHP	L21410066G
12	Besnik Selçetaj	Karpentier	ASHP	L21410066G
13	Gramoz Rrepaj	Murator	ASHP	L21410066G
14	Gjon Matija	Murator	ASHP	L21410066G
15	Qemal Kacokaj	Murator	ASHP	L21410066G

16	Rrok Rroku	Murator	ASHP	L21410066G
17	Leonat Jaku	Hidroizolues	ASHP	L21410066G
18	Bajram Lugajaj	Hekurkthyes	ASHP	L21410066G
19	Kujtim Uruç	Hekurkthyes	ASHP	L21410066G
36	Jetnor Molla	Saldator	ASHP	L21410066G (mbështetje)
37	Gentjan Kadiu	Hidraulik	ASHP	L21410066G (mbështetje)
38	Elvis Muça	Hidraulik	ASHP	L21410066G (mbështetje)
39	Orest Joti	Hidraulik	ASHP	L21410066G (mbështetje)
40	Alban Valisi	Hidraulik	ASHP	L21410066G (mbështetje)

Nuk plotëson kriterin 2.3.3/c të “Kapacitetit teknik”, ku kërkohet paraqitja e certifikatave/diplomave, duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”. Nga OE janë deklaruar punonjësit sipas profesioneve të kërkuara, dhe më konkretisht: punonjësit e deklaruar më sipër me profesionet e kërkuara në DST.

Për këta punonjës, OE ka deklaruar se janë të pajisur me Diplomë/Certifikatë lëshuar nga “Agjencia Shqiptare e Punësimit” me NIUS L21410066G. Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare [www.qkb.gov.al](http://www.qkb.gov.al), në seksionin “Kërko për Licencë”, shoqëria si më sipër është licensuar me licensën me nr. LN-5883-11-2012 me Titull “Formim profesional”, për të cilën figurojnë dy miratime nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, dhe nga QKB:

- Me vendimin nr. 2471 prot., datë: 20. 11. 2012, i është miratuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

- Me proces-verbalin nr. 11467, datë: 22. 12. 2016, i është miratuar në heshtje kërkesa për shtimin e profesioneve. Në këto dy miratime, rezulton se shoqëria “Agjencia Shqiptare e Punësimit”, me NIUS L21410066G, është licensuar për formimin e kurseve profesionale të ndryshme, por jo për ofrimin e kurseve profesionale sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”, për personat e kërkuar në DST.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky ofertues rezulton se për punonjësit e kualifikuar ka deklaruar se janë të pajisur me dëshmi profesionale nga Agjencia Shqiptare e Punësimit, me NUIS L21410066G. Për sa i përket subjektit Agjencia Shqiptare e Punësimit (A.SH.P.), me NUIS L21410066G, rezulton se ky subjekt disponon licencën LN-5883-11-2012 datë 20.11.2012 (miratuar nga Ministria përgjegjëse ose miratim në heshtje) për kurset: Anglisht, Gjermanisht, Italisht, Spanjisht, Greqisht, Arabisht, TOELF, IELTS, CELI, Programe kompjuterike bazë, në Ekonomi/Financë dhe Grafikë, Menaxhim turizmi, Siguria dhe shëndeti në punë, Kuzhinier, Banakier, Kamerier, Parukier, Estetikë, Berber, Picajol, Kasap, Furrtrar, Saldator, Marangoz, Pastiçeri, Siguria në kantier, Montator për mjetet e rënda, Rrobaqepës, Elektro-shtëpiake si dhe shtimin e kurseve të formimit profesional: kuzhinë, banakier, kamerier, parukier, estetik, berber, picajol, menaxhim turizmi, kasap, furrtrar, saldator, marangoz, pastiçier, siguria në kantier, manovrator për mjetet e rënda, rrobaqepës, elektro-shtëpiake, siguria dhe shëndeti në punë, punës dekorative në gur.

Për sa më sipër rezulton se ky subjekt (ASHP) referuar Qendrës Kombëtare të Biznesit, rezulton se subjekti “Agjencia Shqiptare e Punësimit” SHPK me NUIS L21410066G dhe Licencë me Nr. LN-5883-11-2012, nuk është i licencuar të ofrojë kurse të formimit profesional dhe të lëshojë certifikata/diploma për profesionet “Hidraulikë”, “Elektricitist”, “Hekurkthyes”, “Karpentier” “Murator”, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” dhe nuk ka licencë aktive për kurse të formimit profesional për “Hidraulikë”, “Elektricitist”, “Hekurkthyes”, “Karpentier” “Murator” dhe për rrjedhojë, nuk përmbushet kërkesa për kualifikim që dëshmitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, të jenë të lëshuara nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”.

Këtë qëndrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin nr. 745/2022 në lidhje me dëshmitë e lëshuara nga subjekte të pa licensuara.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, bazuar në :

- nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”;
- nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar;
- ligjin nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R. Sh.” dhe në
- vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, vlerëson/gjykon se ofertuesi referuar Formularit Përmbledhës të Vetë-deklarimit dhe Deklaratës (tabela) me të dhënat e Institucionit lëshues të certifikatave/diplomave, të paraqitura në SPE, nuk vërteton se disponon të gjithë punonjësit e specializuar/të kualifikuar të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate dhe gjithashtu nuk kanë aftësinë e duhur/nevojshme profesionale për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie, të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Specialistët e paraqitur nga Kompania *BE - IS shpk*, janë sipas kërkesave të AK, por në total nuk e plotësojnë numrin e kërkuar në DST për këto profesione, ndaj ky kriter nuk plotësohet.

5- Në pikën 2.3.10 të kriterëve të veçanta në DST, është kërkuar 2.3.10 Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin kontratë furnizimi për tubo HDPE dhe PVC, plastike. Sipas preventivit, kontrata e tubove të jetë e shoqëruar me kontratë furnizimi, katalogun, ISO 9001-2015, të dhënat teknike, certifikata e cilësisë së provës, Kodi III.1.B (riciklim plastik), Kodi III.1.A (prodhimi i produkteve plastike), Kodi III.1.B (përpunimi i plastikës)

BOE CURRI DHE BE-IS shpk, nuk ka paraqitur dokumentacion të baraz-vlefshëm të lëshuar në vendin ku ushtron aktivitetin nga institucionet përkatëse ose Vetë-deklarim që përmbush pikat e kërkuara nga Furnitori “KONTIHIDROPLAST” për kriteret Kodi III.1.B (riciklim plastik), Kodi III.1.A (prodhimi i produkteve plastike), Kodi III.1.B (përpunimi i plastikës). Dokumentacioni i paraqitur nga OE është si më poshtë:

- Kontratë furnizimi dhe Autorizim Prodhuiesi
- Testet e raporteve sipas specifikimeve përkatëse të tubave të kërkuar në Projekt-Preventiv.
- Fragmente të katalogjeve dhe broshurat.
- Certifikatë konformiteti të miratuar nga MIRTEC SA

Si rrjedhojë, kjo kërkesë nuk përmbushet.

6- Lidhur me 2.3.3/e. Operatori Ekonomik duhet të ketë të paktën: - 1 (një) punonjës të certifikuar me dëshmi trajnimi si “Përgjegjës për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë”, të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare, akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, kërkesë kjo në përputhje me Ligjin Nr. 10327, datë. 18. 02. 2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, dhe VKM Nr. 312, datë. 05. 05.



2021 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, sipas nenit 88 të VKM Nr. 285, datë. 19. 05. 2021, secili prej operatorëve ekonomikë duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) “Përgjegjës për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë”, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë, sipas akt-marrëveshjes/kontratës së bashkëpunimit.

Operatori Ekonomik “BE-IS” shpk, nuk ka paraqitur dokumentacionin për 1 (një) punonjës të certifikuar me dëshmi trajnimi si “Përgjegjës për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë”.

Operatori Ekonomik “Curri” shpk, nuk ka paraqitur dokumentacionin për 1 (një) punonjës të certifikuar me dëshmi trajnimi si “Përgjegjës për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë”.

Operatori ka paraqitur për Ing. Berhan Dashi, me nr. certifikate AQS/T/S28242019 me kurs trajnimi si “Përgjegjës për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë”, lëshuar nga AQSCET, kompani e cila nuk është e Akredituar për Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë.

7- Në pikën 2.3.4 të kriterëve të veçanta në DST është kërkuar:

“Operatori Ekonomik të ketë Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III. 2. B “Për grumbullim ruajtje dhe transport i mbetjeve inerte”, I. 2. A “Mbrojtja kundër zjarrit”.

Nga dokumentacioni i paraqitur nga BOE CURRI shpk dhe BE-IS shpk, rezulton se për OE Curri shpk

referuar Akt Miratimit nr. 608 prot., me nr. identifikimi 301 datë 23.1.2019 rezulton se për këto mbetje ka

të miratuar në pikën 4/e, që mbetjet jo të rrezikshme të grumbullohen, transportohen, dhe transferohen në

bazë të rregullave të VKM nr. 229 date 23.04.2014, dhe për OE BE-IS shpk, referuar Akt Miratimit nr.

1615 prot., me nr. identifikimi 182 datë 04.09.2016, rezulton se për këto mbetje ka të miratuar në pikën 4.

c/d, që mbetjet jo të rrezikshme të grumbullohen dhe transportohen.

Të dyja këto kompani nuk kanë ruajtjen e mbetjeve në kushtet e Licensimit të tyre, dhe për këtë arsye kjo kërkesë nuk plotësohet.

8- Në pikën 2.3.9 të kriterëve të veçanta në DST, është kërkuar: OE, duhet të ketë kontratë noteriale

me një laborator të akredituar ku të jetë përcaktuar objekti i kontratës/procedurës, për kryerjen e testeve gjatë fazës së zbatimit si dhe përfundimit të objektit. Laboratori duhet të jetë i akredituar për testet e poshtë shënuar, të certifikuar në përputhje me S SH ISO/ICE 17025:2017:

- përbërja e përzierjes së betonit/formula e mix design
- përcaktimi i konsistencës së betonit nëpërmjet testit slump
- përcaktimi në shtypje i mostrave të testimit
- metoda e kryerjes së provave pa shkatërrim të betonit – përcaktimi i shpejtësisë ultrasonik
- metodikat e kryerjes së provave pa shkatërrim të shtresave rrugore – metoda e testimit

për përcaktimin e deformimeve me pajisjen Falling-Ëeight-Type Impulse Load Device

• metoda standard për testimin në tërësi të themeleve të thellë të betonit, me metodën ultrasonic cross hole

• metoda e provës standard për testimin e integritetit të themeleve të thellë, nëpërmjet impaktit të tensionit të ulët

- përcaktimi i pikës së zbutjes
- përcaktimi i densitetit vëllimor të mostrave të ngjeshura bituminoze
- kontrolli i përmasave

- rezistenca në tërheqje:  $\sigma_{rr}$ ,  $\sigma_k$
- përcaktimi i densitetit të korpusit
- përcaktimi i shpërndarjes granulometrike
- përcaktimi i treguesit të aftësisë mbajtëse (CBR)

Për plotësimin e këtij kushti operatori ekonomik BE IS shpk ka paraqitur Kontratë Shërbimi me shoqërinë

NORD COMAT shpk, Kontrata nr. 14492 , kol. 6299 datë 21.09.2022.

Nga verifikimi i certifikatës së Akreditimit të kësaj Kompanie dhe nga Lista e Analizave për të cilat është

i vlefshëm akreditimi rezulton se:

Nuk ka akreditim për:

- metoda standard për testimin në tërësi të themeleve të thellë të betonit, me metodën ultrasonic cross hole
- metodikat e kryerjes së provave pa shkatërrim të shtresave rrugore – metoda e testimit për përcaktimin e deformimeve me pajisjen Falling-Weight-Type Impulse Load Device

Për plotësimin e këtij kushti operatori ekonomik CURRI shpk ka paraqitur Kontratë Shërbimi me shoqërinë

SARP & LAB shpk, Kontrata nr. 3505 , kol. 1690 datë 12.06.2023

Nga verifikimi i certifikatës së Akreditimit të kësaj Kompanie dhe nga Lista e Analizave për të cilat është

i vlefshëm, rezulton se:

Nuk ka akreditim për:

- metoda standard për testimin në tërësi të themeleve të thellë të betonit, me metodën ultrasonic cross hole
- metodikat e kryerjes së provave pa shkatërrim të shtresave rrugore – metoda e testimit për përcaktimin e deformimeve me pajisjen Falling-Weight-Type Impulse Load Device

Nga verifikimet dhe dokumentat e paraqitur nga keto kompani rezulton se kontratat me laboratorët e testimit të materialeve nuk i përmbush kërkesat e kërkuara nga AK në pikën 2.3.9 të DST.

Ky kriter nuk plotësohet.

9- Në pikën 2.3.5 të kriterëve të veçanta në DST është kërkuar:

*Operatori Ekonomik duhet të paraqesë makineri dhe pajisje sipas tabelës së mëposhtme, të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira, të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës:*

Nr.	Emërtimi	Sasia	Statusi
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 15 ton	4	në pronësi ose me qira
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-12 ton	3	në pronësi ose me qira
3	Kamionçina me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton	4	në pronësi ose me qira
4	Kamionçina me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton	4	në pronësi ose me qira
5	Kamion me vinç me kapacitet mbajtës 3.5-7 ton	3	në pronësi ose me qira
6	Autovinç me kosh	1	në pronësi ose me qira
7	Ekskavator me goma	5	në pronësi ose me qira



8	Vinç vetëlëvizës me zinxhirë	1	në pronësi ose me qira
9	Makineri Prerëse/Asfalti Sharrë Betoni	2	në pronësi ose me qira
10	Fadromë me goma	3	në pronësi ose me qira
11	Autobot uji	3	në pronësi ose me qira
12	Greider	1	në pronësi ose me qira
13	Wellpoint	2	në pronësi ose me qira
14	Autobetonierë me kapacitet 2.5 -3 m3	1	në pronësi ose me qira
15	Autobitumatriçe	2	në pronësi ose me qira
16	Vibrator betoni	3	në pronësi ose me qira
17	Rul hekur gomë mbi 15 ton	1	në pronësi ose me qira
18	Rul asfalti mbi 7 ton	2	në pronësi ose me qira
19	Autobetonierë	2	në pronësi ose me qira
20	Autopompë betoni	1	në pronësi ose me qira
21	Minifadromë	1	në pronësi ose me qira
22	GPS	1	në pronësi ose me qira
23	Total station	1	në pronësi ose me qira
24	Mini damper	1	në pronësi ose me qira
25	Detektor për linja energjie në tokë	1	në pronësi ose me qira
26	Batipal	1	në pronësi ose me qira
27	Makineri vijëzimi	1	në pronësi ose me qira
28	Rimorkiator	2	në pronësi ose me qira
29	Kokë tërheqëse	2	në pronësi ose me qira
30	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	2	në pronësi ose me qira

31	Autofshesë	1	në pronësi ose me qira
32	Makineri ngjeshëse dheu tokmak	3	në pronësi ose me qira
33	Rul me peshë deri në 1 ton	2	në pronësi ose me qira
34	Sondë për shpime horizontale në rrugë	2	në pronësi ose me qira
35	Deflektometër	1	në pronësi ose me qira
36	Asfalto shtruese	1	në pronësi ose me qira
37	Kontenier stacioner zyre	2	në pronësi ose me qira
38	Autobot për pastrim kanali dhe puseta me vakum, me kapacitet min 18.000 lit.	1	në pronësi ose me qira

• Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë: 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier”, si më poshtë vijon:

*Kokore + Jelekë fosforeshentë, minimumi 210 copë*

*Fikse zjarri të lëvizshme, minimumi 10 copë*

*Prozhektorë ndriçimi për natën, minimumi 5 copë*

*Komplet i ndihmës së shpejtë, minimumi 10 copë*

*Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt, minimumi 10 copë*

• Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, duhet të paraqitet dokument që vërteton pronësinë e mjetit (certifikatë pronësie), dokument që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik SGS, leje transporti, si dhe siguracionin e mjetit (police sigurimi) të vlefshme, dhe foto përkatëse.

• Për mjetet e siguruar me qira, të paraqiten dokumentet që vërtetojnë regjistrimin e tij, plus certifikatën e kontrollit teknik (SGS) dhe, siguracionin e mjetit, të vlefshme. Këto dokumente duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qirasë, të noterizuar, të vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi.

• Për mjetet e tjera që nuk janë të shënuara në regjistra publike, duhet të paraqitet kontratë noteriale e blerjes/faturë tatimore/dokument zhdoganimi të mjetit dhe, foto të tyre.

Për pajisjet në pronësi shoqërohen me akt pronësie origjinal, ose fotokopje të noterizuar (kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi) të vlefshme.

• Për pajisjet me qira, të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt shoqëruar me akt pronësie origjinal, ose fotokopje të noterizuar (kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi) të vlefshme.

• Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik, duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve me targa, duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

• Për autobitumatriçet, duhet të paraqitet leje transporti për mallrat e rrezikshme.

\* Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës të deklarojë vendndodhjen e mjeteve të kërkuara në procedurën e prokurimit publik si dhe te pranoje verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti kontraktor.

\* *Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruar nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.*

\* *Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetë-deklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetë-deklarimit.*

Në datën 23.06.2023 me shkresën nr. 1204 prot., datë 23.06.2023, Autoriteti kontraktor i ka dërguar BOE *CURRI shpk & BE IS shpk* një kërkesë në lidhje për disa sqarime për deklaratimet e bëra nga BOE në Shtojcën 8, konkretisht për disa mjete.

Në datën 26.06.2023 me shkresën nr. 67 prot., BOE *CURRI shpk & BE IS shpk* ka kthyer përgjigje dhe ka dërguar sqarimet për Kërkesën e bërë nga AK, sqarime që janë reflektuar dhe në SPE.

Lidhur me pikën 38, mjeti i kërkuar nga AK *Autobot për pastrim kanali dhe puseta me vakum, me kapacitet min 18.000 lit. 1-në pronësi ose me qira*

- Në lidhje me Autobotin për pastrim kanali është paraqitur Kontrata Nr. 10487 rep, kol 4350 datë 10.06.2023 lidhur midis BE-IS shpk dhe Bledar Ismaili P.F. Nga dokumentacioni i paraqitur për autobotin me targë AA 544 VE, rezulton se ky mjet e ka certifikatën e Kontrollit Teknik të pavlefshme, pasi i ka përfunduar në datën 01. 11. 2022.

Gjithashtu ky mjet nuk plotëson kapacitetin e kërkuar, pasi është më i vogël. Kapaciteti i këtij mjeti sipas dokumentacionit është 9225 kg. Referuar dhe vendimit të KPP NR 739/2019 rezulton se kriteri për disponimin e mjetit të kërkuar nuk plotësohet.

Lidhur me pikën 31, mjeti i kërkuar nga AK *Autofshesë, 1- në pronësi ose me qira*

- Në lidhje me Autofshesën nga operatori ekonomik *Curri sh.p.k* është paraqitur një Minifadromë dhe një agregat tip fshesë asfalti, vërtetuar me deklaratë doganore. Referuar Kodit Rrugor dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, për të qarkulluar në rrugë, makinat vetëlëvizëse dhe ato që tërhiqen, duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje, leje qarkullimi, dhe gjithë dokumentacionin lidhur me to siç është certifikata e kontrollit teknik, siguracioni, taksa vjetore, certifikatë transporti etj. Ky automjet i kërkuar është vetëlëvizës dhe do të qarkullojë në rrugë për të bërë të mundur pastrimin e saj, pasi dhe objekti në fjalë konsiston në punime të tilla (kanale që hapen në rrugë, punime në rrugë, rehabilitim rrugësh etj.) Nga verifikimi ky automjet nuk disponohet sipas kërkesave nga AK pasi nuk ka dokumentacion siç janë targat, leje qarkullimi, kontroll teknik, siguracion.

Lidhur me pikën 14, mjeti i kërkuar nga AK *Autobetonierë me kapacitet 2.5 -3 m3 1-në pronësi ose me qira*

- Në lidhje me Autobetonierë me kapacitet 2.5 -3 m<sup>3</sup> nga operatori ekonomik *BE - IS shpk* është paraqitur autobetonierë vërtetuar me deklaratë Doganore. Referuar Kodit Rrugor dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, për të qarkulluar në rrugë, makinat vetëlëvizëse dhe ato që tërhiqen, duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje, leje qarkullimi, dhe gjithë dokumentacionin lidhur me to siç është certifikata e Kontrollit Teknik, siguracioni, taksa vjetore, certifikatë transporti etj. Ky automjet i kërkuar është vetëlëvizës dhe do të qarkullojë në rrugë për të bërë të mundur transportin e betonit në rrugët e ngushta ku manovrimi i autobetonierave të mëdha është i vështirë. Nga verifikimi ky automjet nuk disponohet sipas kërkesave nga AK pasi nuk ka dokumentacion siç janë targat, leje qarkullimi, kontroll teknik, siguracion.

Lidhur me pikën 12, mjeti i kërkuar nga AK *Greider 1 -në pronësi ose me qira*

- Në lidhje me *Greider* nga operatori ekonomik *BE- IS shpk* është paraqitur *Greider* vërtetuar me deklaratë Doganore tipi rydhs. Referuar Kodit Rrugor dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, për të qarkulluar në rrugë, makinat vetëlëvizëse dhe ato që tërhiqen, duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje, leje qarkullimi, dhe gjithë dokumentacionin lidhur me to siç është certifikata e Kontrollit Teknik, siguracioni, taksa vjetore, certifikatë transporti etj. Ky automjet i kërkuar është vetëlëvizës dhe do të qarkullojë në rrugë për të bërë të mundur transportin e betonit në rrugët e ngushta ku manovrimi i autobetonierave të mëdha është i vështirë.

Nga verifikimi ky automjet nuk disponohet sipas kërkesave nga AK pasi nuk ka dokumentacion siç janë targat, leje qarkullimi, kontroll teknik, siguracion.

Lidhur me pikën 24, mjeti i kërkuar nga AK *Mini damper, 1 - në pronësi ose me qira*

• Në lidhje me *Mini damper*, nga operatori ekonomik *BE - IS shpk* është paraqitur Mini damper tipi BAUMAX, vërtetuar me deklaratë Doganore. Referuar Kodit Rrugor dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, për të qarkulluar në rrugë, makinat vetëlëvizëse dhe ato që tërhiqen, duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje, leje qarkullimi, dhe gjithë dokumentacionin lidhur me to siç është certifikata e Kontrollit Teknik, siguracioni, taksa vjetore, certifikatë transporti etj. Ky automjet i kërkuar është vetëlëvizës dhe do të qarkullojë në rrugë për të bërë të mundur transportin e betonit në rrugët e ngushta ku manovrimi i autobetonierave të mëdha është i vështirë. Nga verifikimi ky automjet nuk disponohet sipas kërkesave nga AK pasi nuk ka dokumentacion siç janë targat, leje qarkullimi, kontroll teknik, siguracion.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informoj Operatorit Ekonomik “METEO” sh.p.k, me NIPT: L26310801C, si përfaqësues i BOE “METEO” shpk – “TOTILA” shpk - “ALBA KONSTRUKSION” shpk, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej: 697 149 643 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë milion e njëqind e dyzet e nëntë mijë e gjashtëqind e dyzet e tre) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ujësstellës Kanalizime Rajoni Elbasan sha, Lagjja: “Brigada XVII Sulmuese”, Rruga: “Petraq Popa” Elbasan, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentet e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraprak)

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të Procedurës:

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

**DREJTORIA E UJITJES DHE KULLIMIT FIER**

Drejtuar: MANE/S

me adrese: Lagja 2, P 46, Sarande

Procedura e prokurimit/lotit Procedure e hapur

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-71508-06-05-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Mbrojtje në Vrisin e Delvines, Sarandë  
Kohezgjatja e kontrates: brenda 3 muajve nga fillimi i punimeve.

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto 

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto

1. MANE/S J64103865K  
Vlera 11.312.392 (*njembdhjete milion e treqind e dymbdhjete mije e treqind e nentedhjete e dy)leke*
2. Caushi M L884198010  
Vlera 13.047.327 (*trembedhjete milion e dyzet e shtate mije e treqind e njezet e shtate)leke*
3. AVDULI J667033060  
Vlera 13.633.508 (*trembedhjete milion e gjashteqind e tridhjete e tre mije e peseqind e tete)leke*
4. INA J61814009W  
Vlera :14.351.565,87 (*katermbdhjete milion e treqind e pesedhjete e nje mije e peseqind e gjashtedhjete e pese presje tetedhjete e shtate ) leke*

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

Nuk ka te skualifikuar

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë informojmë MANE/S me adrese: Lagja 2, P 46, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 11.312.392 (*njembdhjete milion e treqind e dymbdhjete mije e treqind e nentedhjete e dy)lek /pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e suksesshme.*

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë DUK Fier.rruga Fier-Seman sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është

dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 13.047.327 (trembedhjetë milion e dyzet e shtatë mijë e treqind e njëzet e shtatë) lekë siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të Procedurës:

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

### **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTE OSSH SH.A**

Drejtuar: Operatorit Ekonomik: “EL-POWER” shpk me Numër NIPT: L12009008K dhe me adresë: TIRANË Nr Pas. 1/220+2-53, ZK nr. 8360, Bulevardi Zogu I Pare, Ndertesa Nr.6, SH/K 2, Ap.53.

Procedura e prokurimit: Procedurë e Hapur e Punë.

Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-73101-06-20-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Rikonstruksion i N.Stacionit Pogradec 110/35/10 kV në 110/35/10/20 kV” me fond limit në vlerë 349,974,026.27 (treqind e dyzet e nëntë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e njëzet e gjashtë pikë njëzet e shtatë) lekë pa TVSH me afat realizimi 12 (dymbëdhjetë) muaj nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit.

Publikimet e mëparshme: Nuk ka

Buletini i Njoftimeve Publike: 26.06.2023, Nr.57

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim



Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë ka marrë pjesë:  
Ofertuesit e mëposhtëm me vlera përkatëse të ofruara:

1. BOE: “Alko Impex General Construction” me Nr. Nipti K91326028I & “Rej” Shpk me Nr. Nipti J93711608Q.

Vlera 304,474,452.36 (treqind e katër milion e katërqind e shtatëdhjetë e katër mijë e katërqind e pesëdhjetë e dy pikë tridhjet e gjashtë) lekë pa TVSH.

2. BOE: “Kacdedja” Shpk me Nr. Nipti K51712017A & “Agri Construction” shpk me Nr. Nipti K01725001F.

Vlera 332,568,015.20 (Treqind e tridhjetë e dy milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëdhjetë pikë njëzet) lekë pa TVSH.

3. OE: “EL POWER” shpk me Nr. Nipti L12009008K.

Vlera 346,823,233.18 (Treqind e dyzet e gjashtë milion e tetëqind e njëzet e tre mijë e dyqind e tridhjetë e tre pikë tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

Nga pjesmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertes të paraqitur nga BOE: “Kacdedja” Shpk me Nr. Nipti K51712017A & “Agri Construction” shpk me Nr. Nipti K01725001F.

1. Sipas marreveshjes së bashkepunimit, OE Kacdedja do të realizojë 56.33 % të punimeve dhe OE Agri Konstruksion 43.67 % të tyre. Nderkohe, sipas vlerës së zerave të punimeve që ka marrë persiper OE Agri Konstruksion (vlerës në ofertën e paraqitur nga ky BOE) rezulton se ky OE do të realizojë 188.047.573,20 leke punime pa TVSh që përbejnë 56.54% të vlerës 332.568.015,2 se ofertuar nga ky BOE, në kundërshtim me nenin 88/1 të VKM 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, I ndryshuar, ku përcaktohet se: “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve”. Mospercaktimi i sakte i elementeve (përqindjes së punimeve) sjell pamundësi në vlerësimin e kapaciteteve që duhet të disponojë secili OE për të realizuar pjesën takuese të punimeve., në kundërshtim me pikën 3 të nenit të sipërcituar, ku përcaktohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje....”.

2. Në pikën 1. të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit është kërkuar: Ofertuesi deklaron se: e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në përmbushje të këtij kriteri OE Kacdedja Shpka ka paraqitur vertetimin e Debise OSHEE-2023-216262-VL, datë 29.06.2023 ku provohet shlyerja e detyrimeve të energjisë për 2 kontrata, nderkohe,



sipas ekstraktit të QKB, të paraqitur nga OE ne SPE rezulton se ky subjekt ushtron aktivitet ne 3 adresa:

- Tirane Tirane TIRANE Rruga Don Bosko, Pallati Meld, Kati i dyte;
- Tirane Farke FARKE Ndertim i tregut per shitjet me shumice dhe pakice te produkteve ushqimore (Tirana Agrikulture), Farke;
- Tirane Kamez KAMEZ Rruga Azem Hajdari, Lagjja Nr 5, Zona Kadastrale 2066, Nr pasurie 159/89.

Sa me siper OE ne fjale nuk ka plotesuar nenin 39/7/a te VKM 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku percaktohet se: “7. Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon, që: a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë”.

3. Ne piken 2.3.4 te kriterëve te vecanta te kualifikimit eshte kerkuar: “Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

*Operatori ekonomik ofertues për të provuar përvojën e mëparshme, duhet te ketë realizuar të paktën: punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 174,987,013 (njëqind e shtatëdhjetë e katër milion e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë pikë trembëdhjetë) lekë dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;*

*punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më të vogël se 699,948,052.54 (gjashtëqind e nentëdhjetë e nente milion e nentëqind e dyzet e tete mijë e pesëdhjetë e dy pike pesëdhjetë e kater) lekë....*

3.1 Asnje nga kontratat e realizuara nga OE “Agri Construction” Shpk nuk eshte e ngjashme me objektin e kontrates. Pjesa me e madhe e punimeve qe ka marre persiper te realizoje ky OE (149.500.000 leke nga 188.047.573,20 leke) jane punime per pajisje elektrike, por subjekti ne fjale nuk ka paraqitur asnje kontrate te ngjashme te kesaj natyre.

3.2 Nga kontratat e paraqitura nga OE “Kacdedja” Shpk, vetem ajo me objekt: “Ndertimi i dy fiderave te rinj.....” me AK Drejtoria Rajonale e OSHEE Tirane dhe vlere 68.350.658,9 leke me Tvsh eshte me natyre te ngjashme me objektin e kontrates qe prokurohet, por kjo kontrate nuk permbush vleren korresponduese sipas perqindjes se marre persiper, me vleren e kerkuar.

Konkretisht, sipas marreveshjes se bashkepunimit, OE Kacdedja do te realizoje 56.33 % te punimeve dhe duhet te kishte paraqitur kontrate te ngjashme ne vlere jo me te vogel se:  $0.5633 \times 174,987,013$  leke (vlera e kerkuar ne DT)= 98.570.184,42 leke.

Mosplotesimi i kriterit mbi eksperiencen e ngjashme eshte ne kundërshtim me nenin 39/5 te VKM Nr. 285 te sipercituar, ku parashikohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

*a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;*

*b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë vjetëve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

*Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.*

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve”.

4. Ne piken 2.3.8 te kriterëve te vecanta te kualifikimit eshte kerkuar: “Operatori Ekonomik duhet te kete fuqi minimale punetore te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit, me nje numer prej mesatarisht 25 punonjës per 3 muajt e fundit duke marre si reference daten e hapjes se tenderit; te paraqitura dhe te konfirmuara nepermjet formes elektronike nga organet tatimore per periudhen e mesiperme, nga te cilet duhet te kete specialistet si me poshte:

- 8 (tetë) elektrikist/specialist elektrik.
- 5 (pesë) punonjes të kenë kategorine, e IV ose më e lartë dhe pjesa tjetër te jene te pajisur me IQT per elektrikist.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8. Ndersa operatori ekonomik fitues, para lidhjes se kontrates, duhet te dorezoje dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhen MARS- MAJ 2023.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën MARS - MAJ 2023.”.

Asnje nga anetaret e BOE: “Kacdedja” Shpk & “Agri Konstruksion” Shpk nuk ka deklaruar ne formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Emrat e punonjesve qe disponojne IQT, sipas kerkeses ne kriterin e pranimi te sipercituar, ne kundershtim me nenin 39/6/c ku parashikohet se: “6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës”.

5. Ne piken 2.3.11 te kriterëve te vecanta te kualifikimit eshte kerkuar: “Per listen e meposhtme te mallrave:

- Transformatori i Fuqise
- Çelesi 110 kV
- Çelat TM
- Ndaresi 110 kV

- TR Rryme 110 kV
- TR Tensioni 110 kV

Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:

1. Autorizim te prodhuesit/ve/distributorit te autorizuar per listen e mesiperme te mallrave. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail,  ebsite, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.
2. Katalog/et ose fragmente te katalogut/eve te prodhuesit/per listen e materialeve te mesiperme qe do te ofrohen, ne te cilen te paraqiten te dhenat teknike baze te perkthyer ne gjuhen shqipe. Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet te tregojne lehtesisht dhe qarte qe jane pjese katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.
3. Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese deshmi te testimeve zyrtare te kryera, te leshuara nga institucione te autorizuar ose nga prodhuesi te kryera me pare, qe vertetojne pajtueshmerine e materialeve te prodhuara (lista e mesiperme ose te ngjashme) me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara.

Asnje nga anetaret e BOE: “Kacdedja” Shpk & “Agri construction” Shpk nuk paraqitur Autorizim te prodhuesit/ve/distributorit te autorizuar per listen e mesiperme te mallrave.

Kataloget dhe testimet e pajisjeve nuk jane te perkthyer ne gjuhen shqipe dhe te noterizuara.

6. Ne piken 2.3.12 te kritereve te vecanta te kualifikimit eshte kerkuar: “Operatori ekonomik duhet te kete n  stafin e tij ose te punesuar me kontrate sherbimi t  pakt n 1 (Nj ) Inxhinier t   ertifikuar nga prodhuesi per instalimin dhe komisionimin pajisjeve monitoruese DGA ose ekuivalente (Monitorimi i Gazrave te Transformatorit), i cili do t  realizoje k t  sh rbim.

P r t  provuar plotesimin e k tij kushti duhet t  paraqitet:

- Kontrata e pun s/ose sherbimi;
-  ertifikata perkatese e Inxhinierit te  ertifikuar nga prodhuesi i pajisjeve monitoruese DGA ose ekuivalente (Monitorimi i Gazrave te Transformatorit), i cili do t  realizoje k t  sh rbim.

P r pik n si m  sip r operator t ekonomik ofertues duhet t  paraqesin formularin e vet deklarimit sipas shtojc s Nr. 8.

Nd rsa operatori ekonomik fitues duhet t  dor zoj  pran  AK, p rpara publikimit t  njoftimit t  fituesit dhe nisjes s  afateve t  ankimit, t  gjith  dokumentacionin provues t  k rkuar si m  sip r”.

Asnje nga anetaret e BOE “Kacdedja” Shpk & “Agri construction” Shpk nuk paraqitur dokumentacion (si dhe nuk kane bere deklarim ne formularin e nr. 8) ne permbushje te ketij kriteri, ne kundarshtim me piken 6/c te nenit 39 te VKm Nr. 285.

Sipas marreveshjes se bashkepunimit, punimet qe kane lidhje me inxhinierin ne fjale (zeri me nr .1.3 ne preventiv) do te realizohen nga OE “Agri construction” Shpk dhe ky subjekt duhet te dispononte kete inxhinier te certifikuar.

7. Ne piken 2.3.15 te kritereve te vecanta te kualifikimit eshte kerkuar: “Operatori ekonomik duhet te kete n  dispozicion apo mund t’i vihen n  dispozicion mjetet e pajisjet teknike te nevojshme per ekzekutimin e kontrates, si me poshte (sipas formularit permbledhes te vetedeklarimit):

Nr.	Pershkrimi i mjetit	Sasia	Gjendja
-----	---------------------	-------	---------

1.	Autobetoniere 3.5m3 per punime ne kantier	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
2.	Betoniere 0.5m3 per punime ne kantier	2(dy)copë	Pronësi ose me qera
3.	Kamion transportues vete shkarkues me Vinc mbi 5 Ton	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
4.	Eskavator	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
5.	Kamion transporti	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
6.	Kamioncine	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
7.	Terameter	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
8.	Megaohmeter 1000 volt	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
9.	Pajisje GPS per matje topografike	1(nje) copë	Pronësi ose me qera

Verehet se, referuar ndarjes se punimeve ne marreveshjen e bashkepunimit, te gjitha punimet e betonimit (te gjitha punimet ndertimore) jane marre persiper te realizohen nga OE: “Agri Construction” Shpk dhe ky subjekt duhet te dispononte *Betoniere 0.5m3 per punime ne kantier 2 cope*, por ka deklaruar disponimin e vetem nje mjete te tille.

Gjithashtu, OE “Agri Construction” Shpk referuar ndarjes se punimeve ne marreveshjen e bashkepunimit do te realizoje te gjitha punimet, per te cilat nevojitet *Pajisje GPS per matje topografike*, por nuk ka deklaruar disponimin e nje pajisje te tille.

OE “Agri Construction” Shpk referuar ndarjes se punimeve ne marreveshjen e bashkepunimit do te realizoje edhe punime per te cilat jane kerkuar pajisjet: “Terameter” dhe “Megaohmeter 1000 volt” por nuk ka deklarua disponimin e pajisjeve te tilla.

Mosdisponimi i mjeteve dhe pajisjeve ne fjale eshte ne kundërshtim me nenin 88/3 te VKM Nr. 285 te sipercituar, ku percaktohet se: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje....”*

Sa me siper, referuar nenit 82/2 te VKM nr. 285, ku parashikohet se: *“Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme”*, BOE “Kacdedja” Shpk & “Agri Construction” Shpk skualifikohen per mospermbushje te kriterëve per kualifikim.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te ofertes te paraqitur nga BOE: “Alko Impex General Construction” me Nr. Nipti K91326028I & “Rej” Shpk me Nr. Nipti J93711608Q.

1. Ne piken 1.e te kriterëve te pergjthshme te kualifikimit eshte kerkuar: *Ofertuesi deklaron se: e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.*

Ne permbushje te ketij kriteri OE REJ Shpk ka paraqitur vertetimin e Debise OSHEE-2023-3918064-NU, date 12.06.2023 ku provohet shlyerja e detyrimeve te energjise per 3 kontrata, nderkohe, sipas ekstraktit te QKB, te paraqitur nga OE ne SPE rezulton se ky subjekt ushtron aktivitet ne 7 adresa:

- Tirane Tirane TIRANE Zogu i Zi, Qatar Center, kati 2;
- Elbasan Prrenjas PRRENJAS Lagjja nr 2, rruga Nationale,objekt privat me nr 16 Prrenjas;
- Durres Xhafzota XHAFZOTAJ Xhafzotaj,Durres Zona kadastrale Nr 3052, numer pasurie 15/37;
- Korce Pogradec POGRADEC Lagja Nr.2 rruga Teuta nr pasurie 4/262-N2 Zona Kadastrale nr 8582, Bashkia Pogradec;
- Vlore Lukove PIQERAS Njesia Administrative Sarande me nr pasurie 983, zona kadastrale 2963, Piqeras, Sarande;
- Korce Proptisht PROPTISHT Njesia Adm Proptisht, Nr pasurie 47/721, Zona Kadastrale 3059, bashkia Pogradec.
- Korce Udenisht UDENISHT Korçe-Pogradec,fshati Udenisht,ambjent me nr pasurie 203/1, zona kadastrale 3665.

Gjithashtu, ne vertetimin e debise te paraqitur nga ky subjekt cilesohet se, detyrimet e shlyerja jane “pa perfshire faturen koherente te muajit Maj 2023”. Duke qene se, procedura e prokurimit ne fjale zhvillohet ne Korrik, 2023: duhet te ishin paguar edhe faturat e muajit Qershor 2023, referuar vendimit te ERE.

Sa me siper OE ne fjale nuk ka plotesuar nenin 39/7/a te VKM 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, I ndryshuar, ku percaktohet se: “7. Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon, që: a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë”.

Nderkohe, OE “Alko Impex...” shpk nuk ka deklaruar ne formularin e Shtojces nr.8 , si dhe nuk ka paraqitur dokumentacion ne lidhje me shlyerjen e detyrimeve te energjise elektrike, duke mos permbushur kriterin ne fjale si dhe ne kundershtim me dispoziten e sipercituar.

2. Ne piken 2.3.3 te kriteve te vecanta te kualifikimit eshte kerkuar: “Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit te QKB, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër”.



Asnje nga anetaret e BOE “REJ” Shpk & “Alko Impex...” Shpk nuk deklaruar ne formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8, shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore, si dhe asnje prej tyre nuk ka paraqitur dokumentacion per te provuar shlyerjen e detyrimeve ne fjale, duke mos permbushur kriterin perkates te pranimit.

3. Ne piken 2.3.4 te kriterëve te vecanta te kualifikimit eshte kerkuar: “Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

*Operatori ekonomik ofertues për të provuar përvojën e mëparshme, duhet te ketë realizuar të paktën: punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 174,987,013 (njëqind e shtatëdhjetë e katër milion e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë pikë trembëdhjetë) lekë dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;*

*punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më të vogël se 699,948,052.54 (gjashtëqind e nentëdhjetë e nente milion e nentëqind e dyzet e tete mije e pesëdhjetë e dy pike pesëdhjetë e kater) lekë....*

*Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.*

*Si dëshmi për përvojën e mëparshme, OE Ofertues duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, OE Ofertues duhet të paraqesë si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.*

*Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën oferten të kualifikueshme.*

*Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:*

1. *Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve:*

1. *Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9, shoqëruar me:*
2. *Kontratën/at e Sipërmarrjes;*
3. *Situacionin përfundimtar të objektit;*
4. *Aktin e kolaudimit;*
5. *Çertifikaten e marrjes në dorëzim;*

*Formulari i vlerësimit duhet të përcaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.*

3.1 Asnje nga kontratat e realizuara nga OE “Alko impex General Construction” Shpk, te paraqitura ne SPE, nuk eshte e ngjashme me natyren e objektin te kontrates qe prokurohet.

3.2 Kontrata e paraqitura nga OE “Rej” Shpk me objekt “Nenstacioni levizes 110/20 KV Fushe Kruje” me AK OSHEE dhe vlere 173.193.598 leke me Tvsh nuk permbush vleren korresponduese sipas perqindjes se marre persiper, me vleren e kerkuar. Konkretisht, sipas kontrates, subjekti OE “Rej” Shpk, ka realizuar 50% te vleres se saj, pra vlera e realizuar nga ky subjekt eshte 0.5 x 173.193.598 = 86.596.799 leke me Tvsh

Nderkohe, sipas marreveshjes se bashkepunimit me OE: "Alko impex General Construction" Shpk, OE "Rej" Shpk do te realizoje 70 % te punimeve dhe duhet te kishte paraqitur kontrate te ngjashme ne vlere jo me te vogel se:  $0.7 \times 174,987,013$  leke (vlere e kerkuar ne DT)= 122.490.909 leke.

Gjithashtu, per kontraten e sipercituar, OE "REJ" Shpk nuk ka paraqitur *Formularin e vleresimit per realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9*, të kërkuar ne kriterin perkates ne DT.

Mosplotesimi i kriterit mbi eksperiencen e ngjashme eshte ne kundërshtim me nenin 39/5 te VKM Nr. 285 te sipercituar, ku parashikohet se: "*Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

*a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;*

*b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlere monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë vjetëve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

*Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlere, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlere, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve".*

4. Ne piken 2.3.11 te kriterëve te vecanta te kualifikimit eshte kerkuar: "*Per listen e meposhtme te mallrave:*

- *Transformatori i Fuqise*
- *Çelesi 110 kV*
- *Çelat TM*
- *Ndaresi 110 kV*
- *TR Rryme 110 kV*
- *TR Tensioni 110 kV*

*Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:*

4. *Autorizim te prodhuesit/ve/distributorit te autorizuar per listen e mesiperme te mallrave. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.*

5. *Katalog/et ose fragmente te katalogut/eve te prodhuesit/per listen e materialeve te mesiperme qe do te ofrohen, ne te cilen te paraqiten te dhenat teknike baze te perkthyer ne gjuhen shqipe.*

*Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet te tregojne lehtesisht dhe qarte qe jane pjese katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.*



6. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese deshmi të testimeve zyrtare të kryera, të leshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi të kryera me pare, që vertetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara (lista e mesiperme ose të ngjashme) me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara.

Asnje nga anetaret e BOE “REJ” Shpk & “Alko impex General Construction” Shpk nuk paraqitur Autorizim të prodhuesit/ve/distributorit të autorizuar për listën e mesiperme të mallrave. Kataloget dhe testimet e pajisjeve nuk janë të perkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

5. Në pikën 2.3.12 të kriterëve të vecanta të kualifikimit është kërkuar: “Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij ose të punësuar me kontratë shërbimi të paktën 1 (Një) Inxhinier të çertifikuar nga prodhuesi për instalimin dhe komisionimin pajisjeve monitoruese DGA ose ekuivalente (Monitorimi i Gazrave të Transformatorit), i cili do të realizojë këtë shërbim.

Për të provuar plotësimin e këtij kushti duhet të paraqitet:

- Kontrata e punës/ose shërbimi

- Çertifikata perkatese e Inxhinierit të çertifikuar nga prodhuesi i pajisjeve monitoruese DGA ose ekuivalente (Monitorimi i Gazrave të Transformatorit), i cili do të realizojë këtë shërbim.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër”.

Asnje nga anetaret e BOE “REJ” Shpk & “Alko impex General Construction” Shpk nuk paraqitur dokumentacion (si dhe nuk kanë bërë deklarament në formularin e nr. 8) në përmbushje të këtij kriteri, në kundërshtim me pikën 6/c të nenit 39 të VKM Nr. 285.

Sipas marrëveshjes së bashkëpunimit, punimet që kanë lidhje me inxhinierin në fjalë (zeri me nr 1.3 në preventiv) do të realizohen nga OE: “REJ” Shpk dhe ky subjekt duhet të dispononte këtë inxhinier të çertifikuar.

6. Në pikën 2.3.15 të kriterëve të vecanta të kualifikimit është kërkuar: “Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit):

Nr.	Pershkrimi i mjetit	Sasia	Gjendja
1.	Autobetoniere 3.5m <sup>3</sup> për punime në kantiere	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
2.	Betoniere 0.5m <sup>3</sup> për punime në kantiere	2(dy)copë	Pronësi ose me qera
3.	Kamion transportues vetë shkarkues me Vinc mbi 5 Ton	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
4.	Eskavator	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
5.	Kamion transporti	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
6.	Kamioncine	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
7.	Terameter	1(nje) copë	Pronësi ose me qera

8.	Megaohmeter 1000 volt	1(nje) cope	Pronësi ose me qera
9.	Pajisje GPS per matje topografike	1(nje) cope	Pronësi ose me qera

Verehet se, referuar ndarjes se punimeve ne marreveshjen e bashkepunimit, te gjitha punimet ndertimore jane marre persiper te realizohen nga OE "ALKO IMPEX." Shpk dhe ky subjekt duhet te dispononte edhe mjetet:

- *Betoniere 0.5m3 per punime ne kantier- 2 cope;*
- *Eskavator – 1 cope,*
- *Kamioncine – 1 cope,*
- 

por nuk a deklaruar disponimin e tyre.

Gjithashtu, referuar ndarjes se punimeve ne marreveshjen e bashkepunimit, OE "REJ" Shpk do te realizoje dhe punime per te cilat jane kerkuar pajisjet: "Terameter- 1 cope" dhe "Megaohmeter 1000 volt- 1 cope" por nuk ka deklaruar disponimin e pajisjeve te tilla.

Mosdisponimi i mjeteve dhe pajisjeve ne fjale eshte ne kundërshtim me nenin 88/3 te VKM Nr. 285 te sipercituar, ku percaktohet se: "*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje....*".

Sa me siper, referuar nenit 82/2 te VKM nr. 285, ku parashikohet se: "*Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme*", BOE "REJ" Shpk & "Alko impex General Construction" Shpk skualifikohen per mospermbushje te kritereve per kualifikim.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë OE: "EL-POWER" shpk me Nr. Nipti L12009008K dhe me adresë: TIRANË Nr Pas. 1/220+2-53, ZK nr. 8360, Bulevardi Zogu I Pare, Ndertesa Nr.6, SH/K 2, Ap.53, se oferta e paraqitur me vlerë totale 346,823,233.18 (*Treqind e dyzet e gjashtë milion e tetëqind e njëzet e tre mijë e dyqind e tridhjetë e tre pikë tetëmbëdhjetë lekë*) lekë pa TVSH/totali i pikëve të marra 100 është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Tensionit të Lartë/ Njesia e Prokurimit me adresë Rruga: "Gramoz Pashko Vila Gri", Tiranë, Shqipëri, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraprak)

PO  JO X

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*).

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të Procedurës:

PO  JO X

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*).

**AGJENCIA SHETËRORE E PROGRAMIMIT STRATEGJIK DHE**  
**KOORDINIMIT TË NDIHMËS**

Drejtuar: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të suksesshëm]

1. "ALGreen" - Rr. Donika Kastrioti, Kati 1, Apt 4, Njësia Administrative 5, Tiranë
2. A.R.S Legal & Financial Services Legal & Financial Services- Rruga Kavajës, Qendra Sun Tower, Kati 8, Ap. 30, Tiranë
3. ABKONS - Rruga Themistokli Gërmenji, përballë RTSH, kati i dytë, Tiranë
4. ADM - Advanced Data Management Data Management - Rruga Pjetër Bogdani, Njësia administrative nr. 5, Ndërtesa nr. 17; Nr 2. 1001, Tiranë
5. Adriatica RC - Njësia bashkiake nr. 5, Rruga Abdyl Frashëri, Kulla EGT, kati 6, Tiranë
6. ARDIAN BILIBASHI - Rr. Skerdilajd Llagami, Ndërtesa 2, H1/Ap 19, Tiranë
7. Aulona Hazbiu - Rruga "Shyqyri Bërxolli", Pallati 18, Shkalla 1, Nr. 3, Tiranë
8. Bjona Ziaj - Pallati EdallT, rruga Elbasanit, Tiranë
9. Brunilda Liçaj - Lagjja nr. 5, Rruga M. Muço, Objekt me nr. Pasurie 7/749-ND+1-5, Zona Kadastrale 8513, Durrës
10. DAAM - Rruga Bardhok Biba, Kati 4, Nr. 12, Tiranë
11. Endri Bala - Rruga Him Kolli Pall 45, nr 6 ZK 8380, nr 4/83 ND- N6, Tiranë
12. EPDC ( Europartners Development Consulting ) – Rruga "Ismail Qemali", pall.18, Nr.25, Tiranë
13. UET - Rruga Xhanfize Keko, Ndërtesa 56, Tiranë
14. Future University of Tirana - Rruga Sotir Kolea, pallati i ri (i firmës ferari), Tiranë
15. Hill International NV - Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla nr. 2, Kati i katërt, kodi 1001, Tiranë
16. I RI – Njësia Bashkiake nr. 2, Rruga "Dervish Hima", Tiranë
17. IDRA - Rruga Siri Kodra, Ndërtesa 94, Apartamenti 49, Kodi Postar 1017, Tiranë
18. iGreen Partners (iGP) - Rruga Mujo Ulqinaku, H1, Ap 10, Tiranë
19. Ilir Ciko - Rr nr. 4, Velipojë Shkodër

20. INNOVA - Rezidenca "Kodra e Diellit", Rruga Jasemine, B. 22, n. 170, Tiranë
21. INST. I ING. FINANCIARE PER BANKE & SIG. - Bulevardi Zogu I, Pallati Nr. 57, Shkalla 1, Njësia administrative 9, 1001, Tiranë
22. Instituti per Politika Publike dhe Private (IP3) - Rruga Donika Kastrioti, Pallati 14, Ap. 6 /B Tiranë
23. INSTITUTI DEKLIADA – ALB - Rruga Donika Kastrioti, pallati Teknoprojekt, Apartamenti 9/1, Tiranë 1001
24. Kreston Albania - Rruga Muhamet Gjollësia, Qendra Tregtare Ring, Shkalla 2, Kati 6, Apartamenti 6, Tiranë
25. METRO\_POLIS - Autostrada Tiranë-Durrës, km 5, Tiranë
26. NG STRUCTURES - Lagjja "Selam Musai", Rruga Dule Dalani, Nr. pasurie 14/324, Zona Kadastrale 3574, Kati i dytë, Tepelenë
27. OPTIMA COMMUNICATION - Rruga Vaso Pasha, P. 2, Shk. 2, Ap. 7/1 Tiranë
28. PCM CONSULTING - Rruga Kostandin Kristoforidhi, pallati 17 Katësh, Kati 1, Ap. 4, Tiranë
29. Qendra Kombëtare Burimore e Trajnimit dhe Asistencës Teknike - Rruga Reshit Çollaku, Pallati i borës, sh.1, apt. 20, Tiranë
30. QENDRA "OFIÇINA" - Rr. Qemal Stafa, Nr. 120/2, Tiranë
31. S&L STUDIO - Rruga e Barrikadave, Nd. 11, Shkalla B, Kati 5, Hyrja 8, Tiranë
32. SEA Consulting - Farkë Selitë, Rr. Shyqyri Brari, Nd. 3, H. 7, Apt. 21, Tiranë
33. SHOQATA "LIBURNETIK" - Rruga Siri Kodra, 332 H1, Tiranë
34. Shoqata e Kerkimeve Urbane - Rr. "Asim Vokshi", Nd. 14, Hyrja 11, Ap. 56, 1057 Tiranë
35. Ufficio Mio - Rruga Ukraina e Lirë, Kati 1, Përballë Ambasadës së Kosovës, Tiranë.

\* \* \*

Procedura e prokurimit: Shërbim konsulence

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [shuma, objekti, kohëzgjatja e kontratës, etj.]

Loti 1 – Shërbim konsulence për hartimin e projekt propozimeve në vijim të shpalljeve të thirrjeve nga donatorët për projekte me financim të huaj

Nr. REF LOTI 1: REF-55213-12-28-2022

Fondi limit për Lotin 1: 83,875,000 (tetëdhjetë e tre milion e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë pa TVSH;

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 3 vjet

